

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 415 • QERSHOR 2025



HAXHI
UDHËTIMI I UNITETIT

KURBANI - NORMAT DHE
SYNIMET E TIJ FISNIKE NË ISLAM

LIGJËRATA E IMAMIT TË QABESË:
UNITETI I MUSLIMANËVE

MOMENTE NGA CEREMONIA E PËRMBYLLJES SË GARAVE TË KURANIT



EDITORIAL

- 4 Madhështia e një thirrjeje që s'u shua asnjëherë

FETARE

- 5 Kryereferati i Myftiut të Kosovës:
Hoxhë Ali Jakup Kosova – një dijetar i madh
dhe një emër i heshtur
- 9 Tri duatë e Pejgamberit a.s., prej të cilave Zoti
iu përgjigj vetëm dy
- 11 Haxhi – Kongresi i zgjimit nga kllapia e
individualizmit drejt kthjelltësisë së përqafimit
të ymetit
Mr. Evzal Sinani
- 15 Haxhi - udhëtimi i unitetit dhe njohjes ndër
vete
Dr. Zenel Hajdini
- 19 Ihrami dhe kundërvajtjet e haxhilerëve
Nehat Shehu
- 23 Lehtësimet e haxhit për gratë
Dr. Violeta Smajlaj
- 28 Flijimi i hz. Ismailit ndërmjet sprovës,
besnikërisë dhe miqësisë hyjnore
Prof. ass. dr. Valmire Batatina – Krasniqi
- 31 Bajrami që bie në ditën e premtë (e xhuma)
Myfti Ibrahim Desai el Hanefi
- 33 Miliona ndjenja, një zemër – rrugëtimi im në
tokën e shenjtë
Mihana Goga
- 35 Kurhani – normat dhe synimet e tij fisnike në
Islam
Enes Koshi
- 38 Ndikimi i hytbes dhe i vazit si medime të
edukimit islam (2)
Muhammed Sytari

FAMILJE & EDUKIM

- 42 Fëmija i fundit që u ngjit në një pemë
Imer Topanica
- 45 "Tëhuajësimi i Islamit" në epokën e
teknologjisë
Abdullah el Amadi
- 48 Çorientimi edukativ i fëmijëve dhe mungesa e
shembullit të prindërit
Hatixhe Sefa

KULTURË

- 50 Islami burimor, një urë ndërlidhëse midis
islamofobisë dhe westofobisë
Prof. Fadil Maloku

HISTORI & CIVILIZIM

- 54 Kontributi i El Vezzanit (Leo Africanus)
(1485/94– 1554) në zhvillimin e shkencave të
gjeografisë dhe historisë
M.sc. Artan S. Mehmeti
- 57 Kur fjala e një shqiptari ndryshon historinë –
Beteja e Fushë Kosovës
Xhafer Sadiku

REPORTAZH

- 61 Kosova shkëlqeu në arenën ndërkombëtare
– Garat e Kuranit me organizimin më të mirë
deri më tani
- 64 Imami i Qabesë, shejh dr. Bandar Baleela,
vizitoi Kosovën

AKTIVITETE

- 67 U hap ekspozita "Urat"



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore

Nr. 415 • viti 38 • Qershor 2025
• Dhul-Hixhxe 1446
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavi,
Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



Madhështia e një thirrjeje që s'u shua asnjëherë

“Dhe (ti o Ibrahim) thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura, që vijnë prej rrugëve të largëta. (Vijnë) Për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin Allahun në ato ditë të caktuara...”.

(El Haxh, 27-28)

Për secilin njeri, pa dallim, rrugëtimi për në Mekë mbetet rrugëtimi më i këndshëm dhe më drithërues, detajet e të cilit mbesin të gravura në kujtesë gjer në vdekje. Takimi i parë i besimtarit me Qabenë, ia lidhë gjuhën atij, dhe e lë pa fjalë, duke mpiksur në shpirtin e tij aso përjetime të thella shpirtërore, të cilat pastaj shndërrohen në kujtime të paharruara në jetë. Ato kujtime i rezistojnë pluhurit historik, nuk ikin nga kujtesa, dhe nuk lëshojnë vend dot as për ngjarjet më të mëdha që në një epokë mbase edhe e kanë rënduar jetën tonë. Pranë saj, secili njeri mbetet i magjepsur dhe gojëhapur. Sigurisht, nga madhështia e modestisë së faltorese së parë në tokë që është ngritur për t'u adhuruar Allahu.

Asaj, natyrisht se i mungon glamura, delikatesa, dekor i stërholluar, kubet madhështore që mund t'i gjesh kudo gjetiu, por kurrë dhe asnjëherë asaj nuk i ka munguar madhështia, hyjniteti. Si mund t'i mungojnë ato, kur ajo është “*Bejtullah - Shtëpi e Zotit*”?!

Andaj, rrugëtimi për në Mekë dhe vetë haxhi si adhurim jetësor, është ngritur në nivel të shtyllës së Islamit dhe doemos ai përbën pastaj edhe detyrë e obligim për besimtarët myslimanë që kanë mundësi të marrin këtë rrugë. Mësymja e vendeve të shenjta gjithnjë është përshkruar si një rrugë e mundimshme fizikisht, por që mirësitë, e bekimet e fituara s'lejnë vend për hezitime e as për kalkulime të gjata nga asnjëri besimtar i denjë. Allahu në Kuran e riktheu në kujtesën tonë, ftesën për Ibrahimin a.s. që t'iu drejtohej njerëzve për t'ua kumtuar këtë detyrë. Ai tha: “*Dhe (ti o Ibrahim) thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura, që vijnë prej rrugëve të largëta. (Vijnë) Për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin Allahun në ato ditë të caktuara...*” (El Haxh, 27-28). Dobitë e pritshme dhe lënia e gjurmëve të këmbëve tona në ato vende ku lanë gjurmë një pjesë e madhe e të dërguarave të Allahut, e çështë më e rëndësishmja, aty ku la gjurmë i Dërguari ynë – Muhamedi a.s., e bëjnë njeriun gjithnjë që të harrojë vuajtjen e udhëtimit edhe nëse ai paska arritur atje me deve të rraskapitura.

Ishin të shumtë ata që përshkruan në formë magjepsë rrugëtimin e tyre drejt vendeve të shenjta, sidomos dalin interesante nga ata që nuk ishin besimtarë, por e pranuan Islamin e pastaj morën këtë rrugë. Ndër përshkrimet më të bukura mbesin ndoshta libri “*Journey to Makkah*” (Udhëtim për në Mekë), nga Wilfried-Murad Hofmann, pastaj edhe më herët, ai i Muhamad Asad (Leopold Weiss), me librin e tij “*The Road to Mecca*” (Rruga për në Mekë). Ky i fundit bartë për lexuesit e tij një përshkrim mahnitës, që në fakt duket se flet me gjuhën e secilit haxhi, që për herë të parë e sheh Qabenë e shenjtë me sytë e tij. Ai pamjen e tij të parë për Shtëpinë e Zotit e cilëson kështu: “Kjo pra është Qabeja, ai vendi i përmallimit shpirtëror e etjes së zjarrtë, për miliona njerëz që kanë bërë sakrifica të larta për të arritur deri tek ajo. Në rrugë për tek ajo, kanë vdekur njerëz të shumtë, ndërsa shumë prej atyre që ndoshta kanë vuajtur nga privimi jetësor e varfëria e skajshme, kanë pasur aspiratën e tyre më të çmueshme, rrugëtimin drejt kësaj Shtëpie-Faltoreje në formë kubi, dhe arritja deri tek ajo për ta mbetet plotësimi më sublim në jetë. Ja kjo është Qabeja, mu aty në mes, si një kub i plotë. E mbuluar e tëra me mbulojë të zezë, që qëndron sikur një ishull i qetë në oborrin e vet të gjerë. Ajo është më e qetë se cilado godinë tjetër... Ai që e ndërtoi për herë të parë, dëshiroi që si e tillë ajo të ishte një simbolizim i modestisë para Allahut.” (M. Asad, 541).

Rrugën për në Mekë dhe Medinë, shumë prej shkollarëve myslimanë në të kaluarën e shihnin si mundësi të vetme për t'u takuar me dijetarët eminentë të botës islame që në pamundësi për t'u takuar me ta në vendet e tyre, i gjenin të grumbulluar aty në Mekë e në Medinë. Andaj aty, dhe nga ata mund të dilyn diskutimet më rezultuese shkencore islame dhe pas atyre takimeve mund të kishte njohje të ndërsjellë me gjithë ato sfida, preokupime e vuajtje që ndonjë prej viseve islame i kishte përjetuar. Për të tilla synime, pritshmëritë e myslimanëve janë edhe sot.

Mr. Driton Arifi



Kryereferati i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë në tryezën shkencore “Ali ef. Jakupi (1913–1988) - Jeta dhe vepra e një eruditi në mërgim

Hoxhë Ali Jakup Kosova – një dijetar i madh dhe një emër i heshtur

Të nderuar të pranishëm, profesorë, studiues, përfaqësues të institucioneve fetare dhe shkencore, miq të dijes!

Të nderuar vëllezër dhe motra!

Në historinë tonë kombëtare dhe fetare, ne ndriçojmë figura që me jetën dhe veprën e tyre dëshmuar idealët më të larta të dijes, përkushtimit dhe shërbimit ndaj fesë dhe atdheut. Një ndër këto figura të ndritura është edhe imami ynë, efendi Ali Jakupi, një imam, mësues, shkencëtar, përkthyes dhe dijetar i shquar i Kosovës, i cili tërë jetën e tij ia kushtoi përhapjes së diturisë së fesë islame dhe forcimit të identitetit islam. Anë pse ishte njëri ndër personalitetet më të njohura islame të shekullit të kaluar, personaliteti i tij, fatkeqësisht, ka mbetur në harresë ndër shqiptarët.

Formimi fetar dhe shkencor i dijetarit të shquar shqiptar, Ali efendi Jakupit, u brumos që në moshë të hershme, në vendlindje, në gjirin e një familjeje të njohur për trashëgiminë e saj arsimore dhe fetare. Familja e tij rridhte nga një trung me traditë të theksuar në dijet islame dhe në përkushtimin ndaj arsimit. Gjyshi i tij, haxhi Jakupi, kishte kryer studimet në Medresenë e Nishit të asaj kohe, ndërsa babai i tij, hafëz Hyseni, kishte ndjekur studimet në Medresenë e famshme “Fatih” në Stamboll.

Formimi fillestar i Ali efendi Jakupit përfshinte njëkohësisht ndjekjen e shkollës fillore në Gjilan dhe mësimin e Kuranit dhe të shkencave fetare nga i ati i tij. Përgjatë viteve -1924-1927, ai vazhdoi studimet në Medresenë “Atik” në Gjilan, ku krahas programit zyrtar, mori mësim edhe nga dijetarë të njohur lokal, si: mulla Kadri Efendiu dhe myderriz Abdurrahman Efendiu.

Pas përfundimit të Medresesë “Atik”, ai vazhdoi mësimet në Medresenë e Shkupit “Medah”, në të cilën mësues kishte hoxhën, arsimdashësin dhe patriotin e mirënjohur shqiptar,



efendiun Ataullah Kurtishin. Pas përfundimit të mësimëve në Medresenë “Medah”, ai u kthye në Gjilan.

Në vitin 1930, Ali Jakup Efendiu, u regjistrua në “Mektebi Nuvvab” në Sarajevë – një institucion i profilizuar për përgatitjen e gjykatësve të Sheriatit dhe ku studiohej në një nivel të lartë teologjik dhe juridik. Megjithatë, pas ndërrimit jetë të babait të tij në vitin 1932, ai u detyrua t’i ndërpriste studimet dhe të kthehej në vendlindje.

Një fakt me rëndësi që duhet përmendur është edhe ajo se, në kohën kur halifi i fundit i Perandorisë Osmane, Sulltan Mehmed Reshadi, vizitoi Kosovën më 1911, gjyshi i Ali Jakupit, shërbente si myfti i Gjilanit.

Ai, në emër të qytetarëve të Gjilanit përshëndeti zyrtarisht Sulltanin, i cili, i impresionuar nga pritja e ngrohtë dhe madhështore, mori përsipër që me mjete personale, ta financonte përfundimin e xhamisë së papërfunduar të “Sheh Zades” në Gjilan. Kjo xhami më pas u bë një ndër objektet fetare më të mëdha në Kosovë, duke mbetur simbol i trashëgimisë islame në rajon.

Të nderuar të pranishëm!

Nga ajo që thamë më parë, shihet se efendi Ali Jakupi, ende pa shkuar për studime në Universitetin “Al Az’har” të Kajros, kishte njohuri të shumta fetare dhe shkencore, të marra nga ulema dhe pedagogë të shumtë nëpër medresetë tona të asaj kohe, dhe mësimëve të marra nga dijetarë islam të shumtë të trojeve shqiptare.

Në një epokë sfidash të mëdha për shqiptarët, efendi Ali Jakupi, në moshën 23-vjeçare me këshillat, sugjerimet, mbështetjen dhe propozimin e familjes niset nga Kosova për në Shkup, nga ku shkoi më pas në Selanik për ta marrë vizën, për të udhëtuar më vonë drejt qendrës së famshme të dijes islame, Kajros, për të vazhduar studimet në Universitetin më të vjetër në botë “Al Az’har”, për ta kërkuar atë që Zoti xh.sh., e ka ngritur lart mbi shumë të tjera – dijen.

Derisa priste vizën për në Kajro, hoxhë Ali Jakupi, shërbeu si imam Ramazani në Trakinë Perëndimore të Greqisë.

Besimtarët e Trakisë, duke parë zotësinë, dijen dhe sinqeritetin e lartë që posedonte hoxhë Ali Jakupi, e ftuan që për muajin Ramazan të vitit të ardhshëm, t’ju vinte sërish. Hoxhë Ali Jakupi mbajti premtimin e dhënë, dhe me anije, nga Aleksandria u kthye në Greqi për t’i shërbyer xhematit të Trakisë, të cilëve iu kishte premtuar se do të kthehej për Ramazan.

Formimi fetar dhe intelektual i hoxhë Ali Jakupit, i nisur që në vendlindje, mori një trajtë më të thelluar dhe profesionale pas arritjes së tij në Egjipt, ku në vitin 1936 filloi studimet në Universitetin prestigjioz “Al Az’har”, në një nga qendrat më të njohura të shkencave islame në botë.

Hoxhë Ali Jakupi, bashkë me studentët shqiptarë, shejh Tevfik Islam – Nahin, imam Vehbi ef. Ismailin, Hysen ef. Latifin etj., të cilët kishin shkuar për t’i ndjekur mësimet në “Al Az’har”, patën fatin që për mësues të tyre ta kishin shejhul islamin e fundit të Perandorisë Osmane, Mustafa Sabriun, i cili pas shpërbërjes së halifatit më 1924, ishte shpërngulur në Kajro. Më vonë, hoxhë Ali Jakupi u bë shoqëruar i pandarë i shejhul islamit, Mustafa Sabriut, i cili shpeshherë e prezantonte atë si këshilltar të tij.

“Mua,
hoxhallarët e
mi kurrë nuk
më kanë marrë
para, dijet
fetare nuk
mësohen me
para.”

Hoxhë Ali Jakupi

Pas përfundimit të studimeve në “Al Az’har”, Ali Jakupi u angazhua në Bibliotekën Qendrore të Universitetit të Kajros, e më vonë edhe si lektor në Universitetin e Kajros.

Pozita që mbante i krijoi mundësinë e kontakteve të drejtpërdrejta me literaturën e pasur islame, enciklopedinë ndërkombëtare dhe me personalitete të shquara të dijes nga vende të ndryshme të botës. Kjo ngase hoxhë Ali Jakupi njihje shtatë gjuhë të huaja: arabishten, persishten, frëngjishten, anglishten, turqishten, serbishten dhe osmanishten. Pra, duke qenë një poliglot, u bë urë lidhëse ndërmjet kulturave dhe dijetarëve, e në këtë mënyrë, ai përmbushi edhe një tjetër porosi islame, ofrimin e njohurive për të gjithë ata që ishin të interesuar. Kjo përvojë u shndërrua në një burim të rëndësishëm të zhvillimit të tij akademik të një dijetari të karakterit hulumtues shkencor, duke i dhënë një dimension ndërkombëtar dijes së tij.

Pas kësaj përvoje të madhe të fituar në Kajro, si dhe duke e parë se Kosova ishte aneksuar nga Serbia, efendi Ali Jakupi, vendosi të mos kthehej më në Kosovë, por ta lë Kajron e të udhëtojë në drejtim të Stambollit, nga ku ai do të kontribuonte për fenë dhe arsimimin e gjeneratave të reja.

Efendi Ali Jakupi me t’u vendosur në Stamboll, në një tjetër vatër të rëndësishme të dijes islame, u bë një ndër figurat më të njohura aty dhe në tërë Turqinë, në edukimin e brezave të rinj për dekada me radhë. Afër shtëpisë ku banonte kishte një xhami të vogël, në të cilën mbante ligjërata të rregullta. Përveç kësaj, ai mbante ligjërata edhe në xhami dhe shtëpi të tjera, duke shndërruar kështu edhe shtëpinë e tij pothuajse në një mësonjëtorë.

Nëpër të gjitha ato hapësira, ai ligjëronte nga lënda e Kelamit, Tefsirit, Fikhut dhe shkencave të tjera islame. Ai lexonte dhe shpjegonte para të interesuarve dhe studiuesve edhe veprat e një rëndësie të veçantë siç ishin “*Ihja Ulumu Din*”, “*Edebu Dunja ve Din*” etj..

Përmes ligjëratave të tij, efendi Ali Jakupi, për një kohë të shkurtër u bë adresë e njohur për hulumtuesit dhe studiuesit shkencor. Hallkat mësimore të efendi Ali Jakupit, tërhiqnin jo vetëm studentët e shkencave islame, por edhe të rinjtë dhe të rriturit, të angazhuar në shkencat humane, sociale dhe inxhinierike. Një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve në këto mësimë u angazhuan më vonë në institucionet akademike dhe arsimore, si fakultetet teologjike, institutet për mësimin përmendsh të Kuranit, si dhe fakultetet e letërsisë dhe të historisë.

Ali Jakupi përmes komunikimit, kontakteve dhe ligjëratave të tij, kontribuoi me përkushtim në formimin shpirtëror dhe intelektual të qindra nxënësve dhe studentëve, duke jetësuar porosinë e Zotit të Madhëruar, i Cili në Kuranin fisnik thotë:

يَرْفَعُ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا مِنْكُمْ وَالَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ دَرَجَاتٍ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ

“Allahu do t'i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija. Allahu di çdo gjë që punoni.” (El Muxhadele, 11).

Ky vlerësim dhe kjo ngritje e dijetarëve prej Zotit, është një afirmim i lartë i pozitës së dijetarëve, të cilët gjithmonë kanë qenë dritë dhe udhëzime për shoqëritë islame, në çdo kohë dhe vend. Një ndër këto drita ishte edhe hoxhë Ali Jakupi, një personalitet, që nuk ishte vetëm një bartës i dijes, por edhe një shpirt modest në shërbim të fesë, kombit dhe njerëzimit.

Të gjithë ata – e që janë të shumtë – të cilët unë personalisht i kam takuar dhe kam biseduar me ta nga ish-nxënësit, studentët, imamët apo shokët e tij, qofshin ata turq, kurdë, shqiptarë etj., gjatë rrëfimit për personalitetin e tij, që të gjithë janë përlotur kur përkujtonin hoxhën, mësuesin dhe pedagogun e tyre, në shenjë falënderimi dhe respekti për dijen, personalitetin dhe mbresat që kishte lënë tek ata efendi Ali Jakupi.

Është me rëndësi të theksohet se efendi Ali Jakupi, në përputhje me parimet e tij të thella etike dhe shpirtërore, nuk pranoi kurrë pagesë apo kompensim për përpjekjet e tij arsimore. Në këtë frymë, qëndrimi i tij parimor u përmblohdh qartë në një nga thëniet e tij më të njohura: “Mua, hoxhallarët e mi kurrë nuk më kanë marrë para, dijet fetare nuk mësohen me para.”

Ai i përkiste asaj plejade të dijetarëve, që sipas fjalëve të Muhamedit a.s.:

إِنَّ الْعُلَمَاءَ وَرَثَةُ الْأَنْبِيَاءِ، إِنَّ الْأَنْبِيَاءَ لَمْ يُوْرثُوا دِينَارًا وَلَا دِرْهَمًا، إِنَّمَا وَرَثُوا الْعِلْمَ، فَمَنْ أَخَذَهُ أَخَذَ بِحِطِّ وَافِرٍ.

“Vërtet dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgim as dinarë e as dërhëmë (para), por kanë lënë trashëgim dijen. Ai që e merr atë (dijen), ka marrë një pjesë të madhe (të trashëgimisë).”

Hoxhë Ali Jakupi ishte mishërim i këtij ideali. Ai, jo vetëm që mësonte, por edhe edukonte; jo vetëm që transmetonte dije; por edhe formonte karakter.

Të nderuar dashamirë të dijes!

Ndonëse Ali Jakupi ishte shpërngulur përgjithmonë në Turqi, ai asnjëherë nuk e harroi vendin e tij të lindjes. Në çdo mes që ndodhej, ai ishte i njohur si *hoxhë Ali Jakupi nga Kosova*. Kjo nuk ishte vetëm një nofkë, por ishte një dëshmi se identiteti i tij kombëtar dhe ai fetar ishin të pandashëm. Ai e ruajti krenarinë e origjinës, duke përfaqësuar me nder popullin dhe traditën islame të Kosovës në një arenë më të gjerë ndërkombëtare.

Largimi i detyruar me dhunë nga atdheu i qindra mijëra shqiptarëve, nuk ishte vetëm ndarje nga vatani, por çarje e dhimbshme nga gjuha, kujtesa, shpirti, rrënjët dhe nderi. Ishte një plagë që nuk e shëron as koha dhe as largësia.

Ai që e lë vendin e vet, i shtyrë nga dhuna, bart me vete dhembjen si hije dhe peshë të pandarë, ndërsa mallin për vatanin si një shqetësim dhe brengë të përhershme, duke kuptuar se në heshtjen e tij rëndon historia, e në qëndresën e tij jeton dinjiteti.

Shembulli i hoxhë Ali Jakup Kosova, siç e thërrisnin nxënësit dhe shokët e tij, është një mishërim i kësaj dhimbjeje, por edhe i krenarisë që nuk përkulet. Ndonëse ai migroi i shtyrë nga dhuna, ai asnjëherë nuk u dorëzua. U largua nga toka, por jo nga ideali, dhe kështu, dëshmia e tij jeton si kujtim dhe frymëzim për brezat që e kuptojnë se migrimi i detyruar është një dëshmi e një padrejtësie themelore, por edhe një vullë e një qëndrese të pashoqe.

Mendoj se duhet rifreskuar memorien shqiptare me të vërtetat reale që ekzistojnë, pa hezituar se kush janë, duke ju bërë me dije se në periudhat e vështira për kombin dhe fenë, ishin dijetarët ata që qëndruan në ballë, duke i ruajtur dhe mbrojtur popujt me urtësi dhe përkushtim. Një prej tyre ishte hoxhë Ali Jakupi, i cili veproi në Stamboll, dhe nga aty, kontribuoi në mbajtjen gjallë të ndërgjegjes kombëtare dhe shpirtërore edhe të shqiptarëve, si në Turqi, ashtu edhe në vendet e tjera. Ai përçoi vlera fetare dhe atdhetare, duke i shërbyer popullit shqiptar edhe në largësi, me fjalën, dijen dhe qëndrimin e tij të palëkundur dhe burrëror.

Ai nuk u ligështua dhe nuk u zmbraps në mërgim, por qëndroi i palëkundur, duke e kthyer dhembjen në forcë shtytëse.

Mërgimin e bëri një tribunë për përhapjen e dijes, duke u bërë zë i fuqishëm në mbrojtje të dinjitetit dhe identitetit të besimtarëve, e në veçanti të atyre shqiptarë. Ai dha aq shumë nga mendja, koha dhe përkushtimi i tij, sa që edhe pa dashje të disave, emri i tij është gdhendur në kujtesën e mirënjohjes dhe librat e pavdekësisë.

I lindur dhe i rritur në Kosovë, por i kalitur me dije në horizontet e diturisë universale islame, si në Kajro dhe Stamboll, efendi Ali Jakupi, mbetet një nga figurat që mishëroi në mënyrë të rrallë simbiozën ndërmjet besimit dhe identitetit kombëtar. Ai i dha fjalës autoritet dhe mendimit peshë, duke folur për udhëzimin dhe vetëdijesimin e masës së gjerë. Nga katedrat e mërgatës, ai artikuloi një vizion të kthjellët të Islamit si kulturë, si frymë dhe si përgjegjësi ndaj shoqërisë. Ai dëshmoi se shërbimi ndaj fesë dhe kombit nuk është çështje territori, por çështje përkushtimi i palëkundur ndaj një vizioni të qartë.

Kontributi i dijetarëve islamë, kudo që gjendeshin, si në Kajro, Damask, Aman, Stamboll etj., ka qenë burim i pashtershëm i ruajtjes së identitetit kombëtar dhe fetar të shqiptarëve në mesin ku ata jetonin, por edhe më gjerë.

Hoxhë Ali Jakupi, i cili jetoi dhe veproi në Stamboll, ishte një prej figurave të ndritura që përmes dijes dhe përkushtimit të tij ndikoi në formimin e shumë personaliteteve me ndikim brenda shoqërive të tyre dhe në përmasa botërore, siç ishte edhe vetëm Ekmeludin Ihsan Ogly, sekretar i përgjithshëm i Konferencës Islamike.

Të nderuar të pranishëm!

Për dijetarin e madh shqiptar, i cili jetoi në Turqi mbi tri dekada, ku edhe më pas vdiq, mund të themi se ishte një dijetar i madh i shekullit të kaluar, i cili kishte një formim fetar dhe kulturë të lartë, i njohur, i respektuar dhe shumë i çmuar nëpër botë, por çuditërisht i harruar te shqiptarët.

Siç po shihet, në mesin e shumë dijetarëve shqiptarë, që kanë kontribuar në botën islame dhe janë anashkaluar dhe harruar nga vetë hapësira shqiptare, veçohet edhe figura e hoxhë Ali Jakupit nga Gjilani. Edhe pse kishte përgatitje të nivelit të lartë dhe përkushtim të sinqertë ndaj dijes dhe kombit, ai mbeti jashtë rrëfimeve tona institucionale, jashtë teksteve tona dhe jashtë vetëdijes sonë kolektive.

Pikërisht për këtë arsye jemi sot këtu – për të korrigjuar një harresë, për të nderuar një vlerë dhe për t'i dhënë brezave të rinj një shembull të dijetarit që nuk jetoi për famë, por për të vërtetën dhe në shërbim të të tjerëve.

Hoxha Ali Jakupi përfaqëson modelin e një dijetari klasik dhe shumë modest, por me një autoritet shpirtëror dhe intelektual të pakrahasueshëm. Ai ishte edhe një figurë e ndërgjegjes kombëtare, që e lidhi dijen islame me realitetin dhe nevojat e shoqërisë shqiptare.

Por, pavarësisht këtij formimi të jashtëzakonshëm dhe ndikimit të tij në rrethin e nxënësve dhe bashkëkohësve, ai mbeti jashtë vëmendjes institucionale në Kosovë. Asnjë institut nuk e ka trajtuar e as dokumentuar siç duhet kontributin e tij, e kjo është një padrejtësi e qartë kulturore ndaj një dijetari që sot do të mund të shërbente si model për harmoninë ndërmjet dijes fetare dhe identitetit kombëtar.

Ajo që e bën këtë figurë edhe më të veçantë sot, është kontrasti i dhimbshëm mes njohjes që gëzon ky dijetar i kalibrit të lartë në botën islame dhe harresës së emrit dhe kontributit të tij në trojet shqiptare.

Prandaj, themi se ndriçimi i figurave fetare dhe kombëtare nga harresa kolektive, është një detyrë me rëndësi të veçantë për vetëdijen kombëtare, ruajtjen e identitetit dhe forcimin e lidhjes me rrënjët historike shpirtërore të një populli; është një amanet i heshtur, i cili vazhdimisht troket në ndërgjegjen tonë si shqiptarë. Roli i kujtesës historike në identitetin kombëtar dhe kujtesa kolektive janë themeli mbi të cilin ndërtohet vetëdija kombëtare. Kur harrojmë figurat që sakrifikuuan për lirinë, fenë dhe kulturën tonë, ne në fakt rrezikojmë të humbasim orientimin tonë si popull.

Andaj, të ndriçosh figurat e mohuara, të burgosura, të anashkaluara, apo edhe të shtrembëruara nga regjimet e kaluara, është një akt drejtësie jo vetëm për ta, por edhe për shoqërinë.

Është thënë shumë herë se kur vdes një dijetar “çahen shtyllat e ymetit”, por kur kujtojmë dhe nderojmë këta dijetarë, siç ne po bëjmë sot me hoxhën tonë efendi Ali Jakupin, ne i forcojmë ato shtylla, duke e mbajtur gjallë amanetin e tyre.

Efendi Ali Jakup Kosova – siç e njihnin të gjithë në Turqi, pas një sëmundje të gjatë, vdes më 1988 në Stamboll, ku edhe u varros në varrezat Edirne Kapi në Stamboll.

Krejt në fund: Edhe sot kur e kujtojmë hoxhën, mësuesin, shkencëtarin dhe patriotin tonë, efendi Ali Jakup Kosovën, mund të themi se, me vdekjen e dijetarëve të kalibrit të efendi Ali Jakup Kosovës, shuhet një pjesë e trashëgimisë profetike, ngase dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Andaj me të drejtë mund të themi se Ali Jakupi nuk ishte thjesht një dijetar i rëndomtë, por ishte një institucion i gjallë i dijes, devotshmërisë, edukimit, arsimimit dhe përkushtimit ndaj së vërtetës, një zë i urtësisë, të cilin e përbironte nëpër vrimën e gjilpërës, në atë kohë të zhurmshme e përplot sfida. Në kohën e persekutimeve me metodat më të vrazhda për besimtarët myslimanë, si në Kosovë, ashtu edhe në Turqi, ai ishte një zë i urtë që dinte si të arrinte te veshi i atyre që kishin aq shumë nevojë për ta dëgjuar atë në ato kohë trazirash.

Ishte shembulli më i mirë i një dijetari, i cili çdo gjë që posedonte, kohën, shëndetin, shtëpinë, dijen, por edhe gjumin në shumicën e rasteve, ia fali shërbimit për Islamin, duke e ditur se dija është ushqim i shpirtit, derisa dijetarët janë fanarë që ndriçojnë mendjet e njerëzve, ngase ata janë sikurse yjet në qiell, nëpërmjet të cilëve udhëhiqen njerëzit në errësirë; janë forca më e madhe edukative e brezave; janë në vazhdimësi shembuj model të përkushtimit dhe sakrificës.

Le të jetë kjo Tryezë një zgjim i ri për institucionet tona shkencore dhe fetare, që të nxjerrim nga harresa ato figura të mëdha dhe t'i kthejmë brenda shoqërisë sonë, që të jenë burim reflektimi, frymëzimi dhe përkushtimi brenda kombit tonë për brezat e rinj.

Zoti e mëshiroftë dhe e shpërbleftë për dijen që ka përhapur dhe për kontributin e madh që ka dhënë!

Zoti xh.sh. e bashkoftë hoxhën tonë me pejgamberët dhe dëshmorët në Xhenetul Firdevs!

Po e përmbylli fjalën time me një thënie të Imam Aliut r.a., i cili ka thënë: “Dijetarët jetojnë edhe kur trupat e tyre prehen në varr. Injorantët janë të vdekur, edhe pse ecin mbi tokë.”

*Myftiu Naim ef. Tërnavë
Prishtinë, më 27 maj 2025*

Tri duatë e Pejgamberit a.s., prej të cilave Zoti iu përgjigj vetëm dy

LIGJËRATA E IMAMIT TË QABESË, DR. BANDAR BELEELA, E MBAJTUR NË XHAMINË “PAVARËSIA” NË PRISHTINË

Falënderimi dhe lavdërimi i takon vetëm Allahut të Plotfuqishëm! Vetëm Atë e falënderojmë dhe vetëm Atë e madhërojmë! Salavatet tona ia dërgojmë të dashurit tonë, Pejgamberit Muhamed a.s., ndjekësve të tij dhe të gjithë atyre që ecin në rrugën e tij, të cilët do të arrijnë shpërblimin përfundimtar nga Allahu xh.sh.. Paqja dhe salavatet qofshin mbi të gjithë shokët e tij dhe ata që e pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Të nderuar vëllezër, falënderojmë Allahun që ma mundësoi të jem sot në mesin tuaj! E falënderoj Atë që më gëzoi e më nderoi me vizitën në vendin tuaj dhe me mundësinë të jem në mesin e vëllezërve të mi në Kosovë.



Nga ky vend i bekuar, falënderojmë gjithashtu kujdestarin e dy vendeve të shenjta, Mbretin e Arabisë Saudite, Salman bin Abdulaziz al Saud dhe trashëgimtarin e fronit, Muhamed bin Salman, të cilët dhanë pëlqimin dhe mbështetjen e tyre që të realizohej kjo vizitë në këtë vend të dashur. Mbretëria e Arabisë Saudite shtron ura dashurie, vëllazërie, miqësie dhe forcon marrëdhëniet mes shteteve të ndryshme. Ajo punon dhe angazhohet për të përhapur bashkëpunimin me të gjitha vendet e botës.

Gjithashtu falënderojmë kryetarin e Autoritetit për Kujdesin e Dy Haremeve të Shenjta, shejh dr. Abdulrahman al Sudais, për kontributin e tij të jashtëzakonshëm që kjo vizitë të realizohej. Falënderojmë edhe Ministrinë e Çështjeve Islame të Arabisë Saudite, në krye të së cilës është dr. Abdulatif bin Abdulaziz al Sheikh, i cili shtrin urat e bashkëpunimit me vende të ndryshme, dhe në veçanti me Kosovën. Një falënderim i veçantë edhe për Ambasadën e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, e cila na shoqëroi gjatë kësaj vizite.

Falënderoj edhe kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun e nderuar Naim ef. Tërnavë, për angazhimin dhe mundin e tij në shërbim të Islamit, Kuranit dhe të qytetarëve të Kosovës.

Allahu i shpërbleftë të gjithë me të mirat e Tij, në veçanti juve që sonte jeni këtu me ne, ku së bashku falëm namazin dhe po dëgjoni këtë ligjëratë. Do ta titulloja fjalimin tim: “Vërtet, besimtarët janë vëllezër.”



Ajo që e hidhëron më së shumti shejtanin është se besimtarët janë vëllezër, e kanë një Zot, një Pejgamber, një fe, një Kuran. Bashkimi i tyre është një bekim i madh. Shejtani nuk ka arritur kurrë t'i ndajë besimtarët kur ata janë të bashkuar. Por kur shkakton fitne (përçarje) mes tyre, ai arrin qëllimet e tij.

Në “Musnedin” e Imam Ahmedit, Pejgamberi a.s. në hytben e tij gjatë haxhit ka thënë: “Pas meje, mos u përçani duke luftuar njëri-tjetrin e duke u armiqësuar mes jush.”

Shejtani e ka humbur shpresën që njerëzit të adhurojnë dikë tjetër përveç Allahut, por përmes përçarjes ai e arrin kënaqësinë e tij. Feja e Allahut është e fortë dhe nuk mund të shkatërrohet, por shejtani përpiket ta dobësojë ymetin përmes urrejtjes, përçarjes dhe fitneve.

Në një hadith që transmetohet nga Muslimi, nga Xhabiri r.a., Pejgamberi a.s. ka thënë: “Iblisi e vendos fronin e tij mbi ujë dhe dërgon ushtarët e vet. Ai që bën më shumë përçarje është më i dashuri i tij.” Kur njëri prej tyre vjen dhe thotë se e ka ndarë një burrë nga gruaja, Iblisi i thotë: “Ti e meriton të rrish afër meje.” Në një transmetim tjetër, thuhet se Iblisi e përqafton dhe i thotë: “Ti je punëtori im më i mirë.”

Ky është qëllimi i shejtanit: përçarja mes çiftit, e pastaj përçarja të përhapet edhe më gjerë, mes familjes, shoqërisë dhe krejt ymetit. Allahu në Kuran thotë: “Vërtet, ymeti juaj është një ymet i vetëm.” Dhe më tej thotë: “Ata që u përçanë e u bënë grupe të ndryshme, ti (o Muhamed) nuk je prej tyre.”

PËRÇARJA ËSHTË NDËR RREZIQET MË TË MËDHA QË I KANOSËN KËTIJ YMETI.

Në një hadith tjetër të gjatë, Pejgamberi a.s., ka bërë tri lutje para Allahut: Të mos e shkatërrojë ymetin e tij me thatësi, e këtë dua Zoti ia pranoi; Të mos e shkatërrojë me vërshime, edhe këtë dua Zoti ia pranoi; Të mos ketë përçarje mes ymetit të tij, këtë dua Zoti nuk ia pranoi.

Kjo e fundit mbetet sprovë për ne. Armiqtë e fesë, jobesimtarët dhe ateistët duan që t'i përçajnë myslimanët dhe të

hedhin dyshime mbi fenë, besimin dhe identitetin e tyre. Ata duan ta njollosin imazhin e Islamit dhe të krijojnë fitne në mesin e myslimanëve.

Në Kuran, Allahu thotë: “Shumë nga ithtarët e Librit do të donin t’ju kthenin në mosbesim pasi keni besuar, për shkak të zilisë që kanë në shpirtin e tyre, edhe pasi e vërteta u është bërë e qartë.”

Andaj, vëllezër të nderuar, një besimtar i sinqertë duhet të luftojë përçarjen, egon dhe nefsin që nxit për mëkate.

Jo me fanatizëm, sepse Allahu na porositi të mos i ngjasojmë jobesimtarëve, të cilët krenohen me përçarjen. Myslimani i devotshëm mbrohet me përkushtim, jo me urrejtje. Allahu thotë: “O ju që besuat, binduni Allahut dhe Pejgamberit dhe udhëheqësve nga mesi juaj. Nëse keni mosmarrëveshje, atëherë drejtoju Allahut dhe Pejgamberit.”

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ymeti im do të përçahet në 72 grupe. Vetëm njëri do të shpëtojë.” Kur e pyetën cili është ai grup, tha: “Ai që ndjek rrugën time dhe të shokëve të mi.”

Andaj, shpëtimi qëndron në mbështetjen të Kurani dhe Suneti, në ndjekjen e dijetarëve të dijes së saktë dhe në shmangien e ekstremizmit, përjashtimit dhe paragjykitimit ndaj të tjerëve.


Në fund, ju ftoj që ta lusni Allahun që t’ju forcojë në fenë islame. Pejgamberi a.s. ka bërë shpesh këtë dua: “O Ti që i rrotullon zemrat, bëje zemrën time të palëkundur në fenë Tënde!” Kur e pyetën pse e përsëriste këtë dua, ai tha: “Zemrat janë në dorën e Allahut. Ai i rrotullon ato si të dojë: nga e vërteta tek e pavërteta dhe anasjelltas.”

E lusim Allahun që të na forcojë në të vërtetën dhe të na bashkojë me Pejgamberin a.s. në botën tjetër, pranë kroit të tij të bekuar!

O Zot, na forco në fenë Tënde deri në vdekje!

Ju falënderoj shumë për praninë tuaj, për namazin e falur së bashku dhe për durimin që më dëgjuat!

Allahu ju shpërbleftë dhe ju ruajt të gjithëve!



Haxhi – Kongresi i zgjimit nga kllapia e individualizmit drejt kthjelltësisë së përqafimit të ymetit

Mr. Evzal Sinani


GJETJA E VETES NËPËRMJET GJETJES SË TJETRIT

Ingarkuar nga kërkesat e një bote dinamike, që tenton të shndërron suksesin individual në qëllimin përfundimtar të ekzistencës, njeriu bashkëkohor endet në kërkim të një jete të garantuar nga hyrjet pasive. Ai glorifikon arritje që, në thelb, nuk i japin ngjyrë botës përveçse egos së vet, dhe përfundon i frustruar në një realitet ku çdo përgjegjësi është barrë, çdo kërkesë është një torturë, duke e tëhuajësuar kështu njeriun në kërkim të çnjerëzores, të paarritshmes, asaj për të cilën nuk është i krijuar.

I zhytur thellë në këtë dalldi, në kërkim të devijimit të qëllimit të tij të ekzistencës, për t'iu bindur plotësisht kësaj kërkesë paradoksale, ose thënë më drejt, për të vazhduar sorollatjen në kllapinë e fantazisë dehëse, ai mundohet të zëvendësojë nevojën e prezencës së tjetrit në realitetin e vet me prezencë virtuale që, të thuhet se përfaqëson hijen e realitetit të prezencës së tjetrit – nuk do ishte e vërtetë – ngase ky reflektim është vetëm një përthyerje e dritës së çasteve të gëzueshme që përjetojmë në jetë.

Kjo pseudo-prezencë virtuale vjen si një reagim i natyrshëm instiktiv që tenton ta përmbushë nevojën për tjetrin në të njëjtën kohë në të cilën ai do të vazhdojë të endet mjegullnajave

të imagjinatës që nuk mbaron për të arritur destinacionin fiktiv, i cili sa më shumë që udhëtojmë drejt tij, aq më shumë largohet. Si shembulli i të eturit në shkretëtirë që sillet sa andej e këtej në kërkim të ujit në mirazhet që i sheh në horizont, derisa një ditë arrin mirazhin, për mos ta gjetur aty ujin, por për ta gjetur të vërtetën, zgjimin nga kllapia.



Krijuesi i njeriut, Allahu Fuqplotë, njohës i kësaj krijese edhe në përmasën më të imët të ekzistencës, shpalljen e Tij e shpalli në përputhje me natyrën e të adresuarit. Prandaj, në shumë adhurime, si te namazi, te zeqati, po edhe te ramazani që parimisht është një lloj trajtimi shpirtëror individual, përfshiu elementin shoqëror për të theksuar nevojën dhe rëndësinë e interaksionit dhe ndërveprimit me tjetrin.

Nëse në adhurimet e tjera shfaqet përfshirja sociale si një pjesë e natyrshme e adhurimit individual, atëherë haxhi e vendos këtë përfshirje si themel. Nëse do të parafytyronim etapat e ndërveprimit të njeriut me tjetrin si një vijë kohore, mund të themi se haxhi fillon edhe më herët. Udhëtimi i njeriut për në haxh, në epiqendrën e planetit ku filloi jeta dhe buroi drita, është rrugëtim i zgjimit, tronditje që e nxjerr njeriun nga kllapia e jetës virtuale që e ka ngërthyer me kthetrat e sorollatjes pa qëllim, me synimin kryesor që ta kuptojë se nevoja për tjetrin është reale dhe nuk mjafton imitimi i kësaj prezence.

Individi që sot shmang prezencën e tjetrit në përditshmëri, nga frika se mund ta zgjojë nga kllapia për t'u kthyer në realitet, në haxh është krah për krah me tjetrin, pavarësisht të gjitha cilësive dhe mbiemrave që tjetri mund të ketë. Është me tjetrin, pranë tjetrit, fizikisht, pa pasur nevojë për asnjë përshkrim tjetër. Haxhi fillon duke e bindur njeriun se nuk mjafton prezenca virtuale, prandaj, të gjithë, në të njëjtën ditë, në të njëjtën kohë duhet të qëndrojnë në të njëjtin vend, aty ku Zoti takoi për herë të parë Ademin me Havanë pasi u larguan nga Xheneti, që ta kujtojnë se jeta e njerëzimit në Tokë filloi në atë çast kur ata të dy u takuan, aty ku të dy plotësuan veten kur gjetën tjetrin.

Njeriu gjen veten, vetëm në prezencën reale të tjetrit. Ashtu është i krijuar dhe mbijetesa e individit mund të sigurohet vetëm nëse ndërvepron me grupin. Konkluzat e Ibën Haldunit janë vërtetuese të asaj që themi: "Çdo individ është i pafuqishëm të përballojë vetë natyrën dhe rreziqet e saj. Ai ka nevojë për të tjerët për të mbijetuar."¹ "Njeriu është shoqëror për nga natyra. Ai nuk mund të jetojë dhe të ruajë jetën pa bashkëpunimin me të tjerët."² Këtë natyrshmëri të krijuar të

njeriut, Krijuesi i tij e ka marrë parasysh, e ka ruajtur dhe e ka zhvilluar nëpërmjet shumë adhurimeve, me theks të veçantë nëpërmjet haxhit.

PËRGATITJA SHPIRTËRORE E ANËTARIT TË YMETIT

Pasi që haxhiu e kupton nëpërmjet haxhit nevojën e tij reale për njerëzit tjerë, Allahu, nëpërmjet këtij adhurimi shtyllë të Islamit, e përgatit atë shpirtërisht për të bashkëjetuar me shoqërinë duke e stolitur me virtyte dhe duke e pastruar nga cilësitë e këqija. Gazaliu, duke u thelluar në këtë këndvështrim elaboron se haxhi është një udhëtim për në botën tjetër dhe një ndarje e përkohshme nga dynjaja, që i mëson njeriut durimin, sakrificën dhe përlësinë.³

Trajtimi i personalitetit të haxhiut është i ndërlidhur ngushtë me aspektin historik, ngaqë ky ibadet është i lidhur ngushtë me historinë e besimit monoteist. Ai rikujton sakrificën e Ibrahimit a.s., dorëzimin e tij të plotë ndaj urdhrit hyjnor, si dhe qëndrimin e nënshtruar të Haxheres a.s. dhe Ismailit a.s.. Dijetari i famshëm Fahrudin er Razi konkludon se "simbolika e haxhit përfshin të gjithë fazat e rrugëtimit shpirtëror të njeriut: kërkimin, vetëflimin dhe takimin me Zotin." Ai i interpreton ritualet e haxhit si simbolika që përfaqësojnë faza të ndryshme të rrugëtimit shpirtëror të njeriut: *Kërkimi*: Udhëtimi drejt Qabesë simbolizon kërkimin e së vërtetës dhe përkushtimin ndaj Allahut; *Vetëflimi*: Ritualet si hedhja e gurëve në xhemerate përfaqësojnë refuzimin e tundimeve dhe përkushtimin ndaj rrugës së drejtë; *Takimi me Zotin*: Qëndrimi në Arafat dhe ritualet e tjera përfaqësojnë momentet e afrimit të besimtarit me Zotin dhe përjetimin e një lidhjeje të thellë shpirtërore.⁴

Në dritën e këtyre përmasave shpirtërore, haxhi shndërrohet në një shkollë gjithëpërfshirëse të edukimit të besimtarit, në të cilën ndërtohet personaliteti i tij mbi bazat e përlësisë, durimit, vetëkontrollit dhe ndërgjegjësimit për përgjegjësinë që ai ka si pjesë e një bashkësie më të gjerë. Përmes këtij udhëtimi të jashtëzakonshëm, ai del i pastruar shpirtërisht, më i vetëdijshëm për rolin dhe detyrat e tij si anëtar i ymetit islam, i gatshëm

Haxhi shërben si ura që bashkon këtë komunitet, duke tejkaluar kufijtë gjeografik, kulturor e gjuhësor dhe duke krijuar një hapësirë takimi ku identiteti i përbashkët fetar e shndërron diversitetin në një forcë unike.



për të jetuar vlerat që i ka përjetuar gjatë haxhit dhe për t'i reflektuar ato në jetën e përditshme dhe në marrëdhëniet me të tjerët.

HAXHI DHE NDJENJA E PÛRKATËSISË - YMETI

Pas përgatitjes shpirtërore individuale, haxhi merr kuptimin e një dimensionit kolektiv dhe shoqëror, që manifeston domethënien e ymetit – bashkësisë së besimtarëve të lidhur nga besimi dhe vlerat e përbashkëta. Ymeti nuk është një entitet abstrakt, por një realitet organik, ku secili individ është një pjesë e pandashme e një komuniteti më të gjerë. Në këtë kuadër, haxhi shërben si ura që bashkon këtë komunitet, duke tejkaluar kufijtë geografik, kulturor e gjuhësor dhe duke krijuar një hapësirë takimi ku identiteti i përbashkët fetar e shndërron diversitetin në një forcë unike.

Përmes haxhit myslimanët përjetojnë rikthimin të bashkëjetesës, që është një eksperiencë ku çdo besimtar ndjehet pjesë e një trupi të vetëm shpirtëror, ku solidariteti dhe bashkëpunimi bëhen jetik për funksionimin e komunitetit. Ndjenja e përkatësisë rishfaqet fuqishëm me ç'rast secili pjesëmarrës gjen në bashkësinë e ymetit mbështetje, forcë dhe kuptim, duke ecur larg egos individualiste dhe duke theksuar rëndësinë e përgjegjësisë

Haxhi nuk është vetëm një udhëtim personal shpirtëror, por një përjetim kolektiv që simbolizon fuqinë dhe unitetin e ymetit – bashkësisë islame.

kolektive. Në haxh zbatohen parimet universale të Islamit, që reflektojnë drejtësinë dhe idealen që do ta shohë Krijuesi Absolut: toleranca, barazia dhe drejtësia sociale, parime këto që haxhi i shfaq si një institucion unik, ku pasuria, gjuha, etnia dhe pozicioni social humbin çdo rëndësi përballë besimit të përbashkët.

Kështu, haxhi nuk është thjesht një akt ritual, por një laborator shoqëror që demonstroi se ymeti, si komunitet fetar dhe shoqëror, ka një dimension të thellë jetik dhe funksional, i cili garanton mbijetesën dhe përparimin e besimtarëve në këtë botë.

KONGRESI MË I MADH QË BASHKON MYSLIMANËT DHE JEP MESAZHIN E UNITETIT TË YMETIT

Një nga veçoritë thelbësore të haxhit është se ai simbolizon dhe kultivon idenë e “ymetit”, që në terminologjinë klasike islame nënkupton një bashkësi besimi, që udhëhiqet nga parimet hyjnore dhe që synon të sjellë mirësi për njerëzimin. Haxhi është një edukatë praktike për ta ngritur njeriun nga përkatësia lokale në përkatësinë globale të ymetit.

Haxhi është takimi më i madh dhe gjithëpërfshirës i njerëzve në Tokë, ku uniteti, përlësia dhe përkatësia ndaj një ideali të

përbashkët, zëvendësojnë ndarjet sociale dhe egon individuale. Është një kongres me agjendë të ditur dhe me numrin më të madh të aplikuesve në botë. Të gjithë marrin pjesë vullnetarisht dhe ndajnë të njëjtin vizion që tejkalon çdo ndasi. Prandaj, mund të thuhet se haxhi është kongresi më i madh shpirtëror dhe shoqëror që mban të gjallë lidhjen e ymetit islam, një ngjarje unike dhe e papërsëritshme në botë, që mbledh myslimanë nga të gjitha anët e globit. Ky kongres madhështor, i zhvilluar në hapësirat e shenjta të Arafatit, Muzdelifes, Minas dhe rreth Qabesë – qendrës së botës, është një dëshmi e fuqishme se myslimanët mund të kapërcejnë çdo ndarje, duke bashkuar zemrat dhe shpirtin në adhurim të vetëm ndaj Allahut.

Kjo përvojë e përbashkët sfidon ndarjet sociale dhe gjeopolitike duke bashkuar myslimanët pavarësisht racës, shtetësisë, pozitës sociale, apo kulturës; përkthen në një realitet praktik idenë e unitetit, duke e kthyer ymetin në një trup të vetëm ku çdo qelizë është e ndjeshme dhe e rëndësishme për funksionimin e tërësisë; rifiton dhe përforcon shpirtin e bashkëpunimit, solidaritetit dhe paqes, që janë vlera thelbësore për ekzistencën e një shoqërie islame të suksesshme dhe të drejtë. Në një kohë kur polarizimet dhe fragmentimi social po përkeqësojnë marrëdhëniet ndërmjet myslimanëve, haxhi ngrihet si një model i gjallë i bashkëjetesës harmonike dhe një kujtesë e përhershme e thirrjes për unitet në ymet. Përmes këtij kongresi të madh, myslimanët jo vetëm që ripërtërijnë lidhjet e tyre shpirtërore dhe shoqërore, por edhe afirmojnë angazhimin për një botë më të drejtë dhe të bashkuar, ku solidariteti dhe dashuria ndërmjet besimtarëve janë baza e jetës së përbashkët.

Në këtë kuptim, haxhi nuk është vetëm një manifestim shpirtëror, por edhe një platformë reale për ngritjen e vetëdijes së përbashkët islame. Në një epokë ku shumë komunitete myslimane janë të marginalizuara apo në krizë identitare, ky tubim global është një rikujtim se Islami është një fe universale, me potencial për të ndërtuar drejtësi, solidaritet dhe paqe.

Mesazhi i haxhit është se problemi i ndarjes së ymetit nuk është as te gjuha, as te kultura, por te mungesa e ndërgjegjes së përbashkët dhe e prioriteteve të qarta. Prandaj, haxhi është një mundësi e artë për ri zgjimin e kësaj ndërgjegjeje.

FUQIA E HAXHIT NË NDËRTIMIN E NDËRGJEGJES SË YMETIT

Duke filluar me ndërgjegjësimin se nevoja për tjetrin për mbarëvajtjen e jetës së njeriut në Tokë është reale dhe fizike, për të vazhduar më pas në edukimin shpirtëror e moral të haxhiut, që përfaqëson një përgatitje për anëtarin e denjë të ymetit, haxhi me të gjitha adhurimet e tija ku zbatohen vlerat që karakterizojnë ymetin, e kalit haxhiun për të qenë bartës i thirrjes për tek Allahu, ai bashkë me çdo pjesëtar tjetër të bashkësisë së tij.

Ndër të tjera, ky adhurim shtyllë, me persistencë tenton të na mësojë se bashkimi nuk nënkupton shkrirjen në një mendim unik, por përkundrazi, për bashkimin përreth qëllimeve dhe vlerave të përbashkëta. Mesazhi i haxhit është se problemi i ndarjes së ymetit nuk është as te gjuha, as te kultura, por te mungesa e ndërgjegjes së përbashkët dhe e prioriteteve të qarta. Prandaj, haxhi është një mundësi e artë për ri zgjimin e kësaj ndërgjegjeje.

Haxhi mbetet institucioni më i gjallë dhe më domethënës që përfaqëson unitetin real të ymetit islam. Ai është kongres global, por pa hierarki politike; është manifestim solidariteti, por pa ndarje klasore; është udhëtim shpirtëror, por me ndikim konkret në vetëdijen e përbashkët. Në një botë ku ndarjet janë të thella dhe ku identiteti mysliman sfidohet vazhdimisht, haxhi mbetet burimi më i fuqishëm i rigjallërimit të lidhjes së ymetit me Allahun dhe me vetveten dhe do vazhdojë të mbetet kongresi më i madh i gjallë i njerëzimit, ku myslimanët nga çdo anë e globit, përtej racës, gjuhës, etnisë dhe statusit shoqëror, i përgjigjen thirrjes së zgjimit nga kllapia e individualizmit drejt kthjelltësisë së përqafimit të ymetit, rreth një qëllimi të përbashkët: bindjes ndaj Allahut dhe ruajtjes së identitetit të përbashkët të ymetit islam.

1 Muhamed Munir Mursij, *El Terbijeh el Islamiyeh*. (Alem al Kutub, 2005), fq. 241.

2 *Ibid*.

3 Ebu Hamid el Gazali, *Ihja Ulum el Diin*, (Bejrut, Marifah Publishing), v.1, f. 261-266.

4 Fahrudin er Razi, *Et Tefsirul Kebir - Mefatihul Gajb*, (Bejrut, Dar Ihja el Turath el Arabij), v. 5, f. 296-314.

Haxhi - udhëtimi i unitetit dhe njohjes ndër vete


Dr. Zenel Hajdini

Historikisht, haxhi dhe ritet e tij janë urdhëruar për herë të parë nga Allahu xh.sh. në kohën e Ibrahimit a.s.. Ai, së bashku me të birin, Ismailin ngritën themelet e Qabesë dhe thirrën njerëzit për ta kryer haxhin. Ky akt përfaqësonte një formë adhurimi të pastër dhe monoteist ndaj Allahut xh.sh..

Megjithatë, gradualisht, me kalimin e kohës, forma dhe qëllimi i haxhit pësoi devijime. Me përhapjen e idhujtarisë në gadishullin arabik, Qabeja humbi pastërtinë dhe brenda saj u vendosën idhuj dhe u bë qendër e adhurimit politeist. Ritet u shtrembëruan, burra dhe gra rrotulloheshin të zhve-

shur rreth Qabesë, me argumentin se duhet të dilnin përpara Allahut xh.sh., ashtu siç kishin lindur.

Në këtë gjendje, kur njerëzit i kishin braktisur mësimet e prijësit dhe stërgjyshit të tyre, Ibrahimit a.s., shtëpia që ai kishte ndërtuar për adhurimin e Allahut, ishte përdhosur nga paganët dhe ritet që ai kishte vendosur ishin shtrembëruar, lutja e Ibrahimit a.s. mori përgjigje: *“Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre të dërguar që t’u lexojë atyre ajetet Tua, t’u mësojë atyre librin dhe urtësinë, e t’i pastrojë (prej ndyrësisë së idhujtarisë) ata. S’ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijsmi.”* (El Bekare, 129).



Një njeri me emrin Muhamed lindi pikërisht në vendin ku Ibrahim i a.s. ishte lutur shekuj më parë. Për 23 vjet, Muhamedi a.s., përhap mesazhin e njëshmërisë, të njëjtin mesazh për të cilin u dërguan Ibrahim i a.s. dhe pejgamberët e tjerë, si dhe arriti të vendosë ligjin e Allahut në tokë. Ai kreu çdo përpjekje për ta lartësuar fjalën e Allahut xh.sh., dhe fitorja e tij ndaj idhujtarisë kulmoi në shkatërrimin e idhujve brenda Qabesë, çka e ktheu atë sërish në epiqendrën e adhuruesve të Zotit të vërtetë.

Ai a.s., rivendosi të gjitha ritet e haxhit që ishin urdhëruar nga Allahu në kohën e Ibrahimit a.s.. Urdhëresa të posaçme kuranore zbritën për të shfuqizuar ritet e rreme që ishin shpikur gjatë periudhës paraislame.

Haxhi është udhëtim i jashtëzakonshëm jetësor, është thirrje që Allahu ua bëri njerëzve që nga koha e Ibrahimit a.s., për të ardhur në Shtëpinë e Shenjtë me zemra të përlura dhe shpirta të bashkuar në adhurim. Është një thirrje për t'u bërë pjesë e një bashkësie që frymon njësoj, që lutet njësoj, që shpreson njësoj.

Kur Allahu xh.sh. i ftoi njerëzit për haxh, Ai nuk i ftoi për një udhëtim thjesht fizik drejt një vendi të shenjtë, por për një përjetim që shkund shpirtin dhe ngrit ndërgjegjen, ngase Ibrahim i a.s., nuk i thirri njerëzit që mund ta dëgjonin zërin e tij me veshët e tyre, por ata që do ta dëgjojnë dhe do t'i përgjigjen nga thellësia e zemrës, në thellësitë kohore që çojnë deri te njeriu i fundit që do të jetojë në këtë botë. Ai tha: *“Dhe thirr ndër njerëz për haxh, ata do të vijnë në këmbë e mbi deve, që vijnë prej të gjitha viseve të largëta.”* (Haxh, 27).

Ky udhëtim nuk është një shëtitje turistike, por një thirrje që e zhvesh njeriun nga e përkohshmja dhe preokupimi ditor, duke e sjellë përballë të përjetshmes-shpirtërores. Është shkollë për shpirtin, ku njeriu mëson se si të jetë rob i vërtetë dhe vëlla i të gjithë njerëzve që ndajnë me të këtë rrugë drejt Zotit.

Është një udhëtim i shpirtit, një thirrje hyjnore për bashkim, përlurje dhe vëllazëri. Çdo hap që haxhiu bën drejt Qabesë, çdo rrotullim rreth saj, çdo grimcë lodhjeje, është një gurë i vendosur në ndërtimin e një shpirti

Ky udhëtim
nuk është një
shëtitje
turistike, por
një thirrje që e
zhvesh njeriun
nga e përkoh-
shmja dhe
preokupimi
ditor, duke e
sjellë përballë
të përjet-
shmes-shpir-
tërores. Është
shkollë për
shpirtin, ku
njeriu mëson
se si të jetë rob
i vërtetë dhe
vëlla i të gjithë
njerëzve që
ndajnë me të
këtë rrugë
drejt Zotit.

më të pastër dhe të një shoqërie më të bashkuar.

Në mesin e miliona haxhilerëve, zhduken titujt dhe pozitat, ngjyrat dhe pasuritë; nuk ka mbret e nuk ka shërbëtor, nuk ka të pasur e nuk ka të varfër. Të gjithë qëndrojnë njësoj, të mbështjellë me dy copa të bardha, që simbolizojnë jo vetëm ihramin e ritualit, por edhe qefinin. Duket sikur Allahu xh.sh. na thotë: “Kështu do të qëndroni para Meje në Ditën e Gjykimit – të zhveshur nga dynjaja, por të mbështjellë me përlusësi.”

Në këtë pelegrinazh të shenjtë, miliona zemra rrahin njësoj, duke shpalosur para syve të botës mozaikun e unitetit islam. Shpirtat mësojnë barazinë e vërtetë dhe ndërtojnë ura njohjeje dhe dashurie, me përjetimin e fjalës së Allahut: *“Vërtet, më i nderuari ndër ju tek Allahu është ai që ka më shumë devotshmëri.”* (El Huxhurat, 13).

Ndërsa, Pejgamberi a.s., në hytben e lamtumirës drejtuar sahabëve, e theksoi thelbin e këtij adhurimi: “O njerëz, Zoti juaj është Një, babai juaj është një. Nuk ka asnjë epërsi arabi ndaj jo arabit, as i bardhi ndaj të ziut, përveçse me devotshmëri.”¹

Ky mesazh nuk është vetëm një deklaratë morale, por është thelbi i haxhit. Sepse aty ku ka barazi para Zotit, nuk ka vend për krenari ndaj njëri-tjetrit.

Në çdo hap të këtij pelegrinazhi, besimtarët thonë me një zë të bashkuar: *“Lebbejke Allahumme lebbejke!”* – “Të përgjigjemi o Allah, të përgjigjemi!” Kjo është një shprehje e nënshtrimit dhe përlurjes totale ndaj Krijuesit, një thirrje që vjen nga zemra e secilit besimtar, pa dallim race, gjuhe apo kombësie. Ajo simbolizon një bashkim të thellë shpirtëror mes miliona njerëzve, që vijnë për të përmbushur një nga detyrat më të shenjta të Islamit.

Në këtë thirrje, besimtarët jo vetëm që përgjigjen me fjalë, por gjithashtu me zemra të hapura dhe shpirta të përkushtuar, duke i dhënë përgjigje thirrjes hyjnore. Çdo *“Lebbejke”* është një dëshmi e përkushtimit të paepur ndaj Allahut, një angazhim për t'u pastruar dhe përsosur, një ndjenjë falënderimi dhe një lutje që shprehet me lot në sy.



Ky bashkim nuk është vetëm simbolik. Haxhi është mësim i njohjes. Një njeri nga Kosova, një tjetër nga Shqipëria, një tjetër nga Indonezia, nga Palestina, nga Turqia, nga Egjipti, nga Pakistani, nga Nigeria, nga Bosnja, nga Arabia Saudite, nga Maroku, nga Malajzia, nga Sudani, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Franca, nga Gjermania, nga Australia, nga Japonia apo nga Kina, të gjithë përqafohen, ndajnë një gotë ujë, presin në radhë, falen krah për krah. Për këtë, Pejgamberi a.s., ka thënë: “Do t’i shohësh besimtarët në mëshirën, dashurinë dhe bashkimin e tyre, si një trup të vetëm. Kur një pjesë e trupit ndjen dhimbje, e gjithë trupi reagon me ethe dhe pagjumësi.”²²

Pra, në haxh, haxhilerët mësojnë ta shohin njëri-tjetrin jo vetëm përmes syve të racës, kombësisë apo pasurisë, por edhe përmes syve të dashurisë për Allahun xh.sh..

Malcom X, është njëri nga liderët më të mëdhenj të afro-amerikanëve, i cili pasi pranoi Islamin, u angazhua shumë në përhapjen e tij në Amerikë. Duke parë numrin e madh të njerëzve që shkonin pas tij, ku me mijëra njerëz kishin filluar ta përqaфонin Islamin si rezultat i ligjëratave të tij të mrekullueshme, ai vritet. Për përvojën e tij gjatë haxhit, pati thënë: “Atje, në Qabe, kishin ardhur qindra mijëra myslimanë, nga të gjitha anët e botës. Ata i përkisnin të gjitha racave dhe ngjyrave, duke filluar nga flokëverdhet me sy të kaltër, e deri tek afrikanët, me lëkurë të zezë. Por, që të gjithë, morën pjesë në të njëjtat dispozita, duke shprehur një frymë bashkimi, gjë që përvoja ime në Amerikë, më kishte bërë të besoj se një gjë e tillë, në mes të bardhëve e zezakëve, s’mund të ndodhte kurrë. Ndoshta njerëzit do të çuditen nga këto fjalë. Por, atë që pashë dhe përjetova gjatë haxhit, më bënë t’i ndryshoj

mendimet e mia të mëparshme dhe të braktisja disa nga qëndrimet, në të cilat këmbëngulja në të kaluarën, gjë, e cila, s’që shumë e vështirë për mua. Me gjithë bindjet e mia të paluhatshme, unë, gjithmonë, kam qenë i gatshëm të ballafaqohem me faktet dhe të pranoj të vërtetën e zbuluar përmes dijes dhe përvojave të reja. Gjatë njëmbëdhjetë ditëve të fundit, që kalova në botën myslimane, i jam lutur të njëjtit Zot, kam ngrënë nga e njëjta pjatë, kam pirë ujë prej të njëjtës gotë dhe jam shtrirë në të njëjtin shtrat, apo qilim, me myslimanët me sy nga më të kaltrit, me flokë ndër më të verdhat dhe me lëkurë ndër më të bardhat. Në fjalët, sjelljet dhe veprat e myslimanëve të bardhë, unë pashë e ndjeva të njëjtën përzemërsi, që e ndjeva në mes të zinjve afrikanë të Nigerisë, Sudanit ose Ganës. Ne ishim, vërtet, të gjithë njësoj, vëllazër!”²³

Gjithashtu, janë disa obligime apo rituale të haxhit, të cilat na mësojnë se çështje uniteti dhe njohja. Është kodra e Arafatit, vendi ku në ditën kulmore të haxhit mbledhen mijëra besimtarë nga të gjitha anët e botës, duke krijuar një pamje madhështore të njohjes, bashkimit dhe përlujes para Allahut xh.sh.. Ky vend i shenjtë quhet Arafat, pikërisht sepse aty njerëzit takohen, njihen me njëri-tjetrin dhe me veten, duke përjetuar një nga momentet më të fuqishme të unitetit dhe vëllazërisë islame.⁴

Pastaj, është tavafi, i cili si një nga ritet themelore të haxhit dhe umres, paraqet një unitet të dukshëm ndërmjet myslimanëve. Kryerja e këtij riti nga miliona pelegrinë nga mbarë bota, që rrotullohen rreth Qabesë në të njëjtin drejtim, në të njëjtin mënyrë dhe pa dallim statusi apo kombësie, shpreh unitetin e umetit islam në adhurimin e



Pra, ky udhëtim i shenjtë nuk është vetëm një akt adhurimi personal, por edhe një shkollë njohjeje dhe vëllazërimi ndërmjet myslimanëve, një dëshmi e gjallë e fjalëve të Allahut: “Ne ju kemi krijuar prej një mashkulli dhe një femre dhe ju kemi bërë popuj e fise që të njiheni me njëri-tjetrin.”

një Zoti të Vetëm. Pra, në bindjen ndaj rendit hyjnor: “...dhe le të kryejnë tavafin rreth shtëpisë së lashtë (Qabesë).” (El Haxh, 29).

Më pas edhe saji në mes kodrave Safa dhe Merva rikujton përpjekjen e singertë të Haxheres, nënës së Ismailit a.s.. Kjo ecje është kthyer në një rit të përbashkët për të gjithë myslimanët, duke vendosur një figurë femërore besimtare si simbol të përkushtimit dhe sakrificës njerëzore. Në këtë rit, përjetimi i së njëjtës përpjekje, pavarësisht gjinisë, racës apo gjuhës, përforcon ndjenjën e bashkimit shpirtëror dhe se ndihma hyjnore vjen përmes përpjekjes. Allahu xh.sh. thotë: “Safa dhe Merva janë nga shenjat (argumentet) e Allahut...” (El Bekare, 158).

Nëpërmjet këtyre riteve, Islami edukon besimtarin në një unitet të plotë; në adhurim, në histori, në vlerë dhe qëllim. Myslmanët bashkohen jo vetëm rreth një shtëpie të shenjtë, por edhe rreth një përvoje dhe kujtese të përbashkët.

Pra, ky udhëtim i shenjtë nuk është vetëm një akt adhurimi personal, por edhe një shkollë njohjeje dhe vëllazërimi ndërmjet myslimanëve, një dëshmi e

gjallë e fjalëve të Allahut: “Ne ju kemi krijuar prej një mashkulli dhe një femre dhe ju kemi bërë popuj e fise që të njiheni me njëri-tjetrin.” (El Huxhurat, 13).

Në këtë tubim madhështor, besimtari kujton se jeta është një udhëtim i përbashkët drejt Allahut. Ne të gjithë jemi udhëtarë, të gjithë të varur nga mëshira e Tij dhe të ndihmuar nga njëri-tjetri.

Aty besimtarët mësojnë durimin, faljen, mëshirën dhe përkujdesjen ndaj njëri-tjetrit, duke e parë veten si pjesë e një trupi të vetëm që pulson me dashuri për Allahun xh.sh. dhe për krijesat e Tij, e që quhet ymet. Në mesin e miliona njerëzve, një buzëqeshje, një dorë ndihme, një fjalë e mirë, bëhen adhurime të vlefshme, siç na porositi Pejgamberi a.s., kur tha: “Allahu është në ndihmën e robit derisa rob i jetë në ndihmën e vëllait të tij.”⁵

Haxhi nuk është thjesht ritual, por veprim konkret që mishëron vlera të mëdha njerëzore, si: ndihmën, durimin, faljen, unitetin dhe njohjen. Është një betim i heshtur për vëllazëri, për paqe dhe përlujtje. Nëse e kupton këtë, atëherë kur kthehesh nga haxhi, nuk je thjesht një njeri që ke vizituar një vend të shenjtë, por je një njeri i ri që ke përjetuar dhe reflekton ndaj një “shpallje të gjallë”.

Të reflektosh pas haxhit, do të thotë që çdo vepër jotja të bëhet sinonim i dashurisë për Allahun xh.sh. dhe shërbimit ndaj krijesave të Tij, sepse Allahu nuk të ftoi në haxh që të lodhesh, por që të mësohesh. Nuk të thirri që të tregohesh, por që të ndryshohesh. Dhe nëse ai ndryshim ndodh, atëherë haxhi yt ka qenë i pranuar, dhe shpërbllimi yt është Xheneti, ashtu siç thotë Pejgamberi a.s.: “Haxhi i pranuar nuk ka shpërbllim tjetër përveç Xhenetit.”⁶

Nga ky këndvështrim, haxhi është një mësim i madh i jetës; një thirrje për të ndërtuar një shoqëri mbi dashurinë, barazinë dhe mëshirën. Një stërvitje vjetore që ia kujton ymetit se forca e tij qëndron në unitet dhe në mbështetjen ndaj njëri-tjetrit.

Kur haxhiu kthehet në vendin e tij, ai nuk duhet të jetë më i njëjti njeri. Ai tani duhet të ndërgjegjësohet si një njeri që ka parë botën në një tjetër dritë: si një udhëtim i përbashkët me besimtarët e tjerë drejt Zotit, ku vetëm besimi, dashuria dhe vepra e mirë kanë vlera të përjetshme.

- 1 Ahmed ibën Hanbel esh Shejbanij, *Musned Imam Ahmed*, (Mueseseh er Risaleh, Lubnan, 2001), v. 38, hadithi nr. 23489, f. 474.
- 2 Muhamed ibën Ismail el Buharij, *Sahihul Buharij*, (Dar es Selam Riad, 2000), v. 8, hadithi nr. 6011, f.01. Muslim el Haxhaxh en Nisaburi, *Sahihu Muslim*, (Bejrut, Lubnan), v.4, hadithi nr. 2586, f. 1999.
- 3 Malcom X dhe Alex Haley, *The Autobiography of Malcolm X*, (Ballantine Books, 1992) f. 346-347.
- 4 Imam Er Razij, Fahrudin er Razij, *Mefatihul Gajb*, (Dar Ihjau Turath, Bejrut, 1420h), v. 5, f. 325.
- 5 Muslim, *Sahihu Muslim*, v. 4, hadithi nr. 2699, f. 4702.
- 6 Muslim, *Sahihu Muslim*, v. 2, hadithi nr. 1349, f. 983.

Ihrami dhe kundërvajtjet e haxhilerëve

Nehat Shehu

Haxhi është një nga pesë shtyllat themelore të Islamit dhe një detyrim i domosdoshëm për çdo mysliman, që plotëson kushtet për ta kryer atë. Ky ritual nuk është thjesht një akt fizik, por një udhëtim shpirtëror, përmes së cilit besimtari forcon lidhjen e tij me Zotin, pastron shpirtin dhe rikonfirmon devotshmërinë. Kur flasim për haxhin, gjithmonë na vjen në mendje ihrami, një gjendje tejet e veçantë që besimtari e përjeton për të kryer ritualet e haxhit apo umres.

Ihrami është kusht për vlefshmërinë e haxhit. Atë, haxhiu duhet ta ketë gjatë kryerjes së ritualeve të haxhit dhe si i tillë përfaqëson një transformim të brendshëm shpirtëror. Ai është një kalim në një gjendje të shenjtë, ku besimtari hyn për të kryer ritualet e haxhit dhe umres, dhe ku çdo veprim, fjalë

dhe qëndrim duhet të maten me kujdes dhe përkushtim. Në këtë gjendje, besimtari largohet nga dertet e jetës dhe bën përpjekje maksimale në forcimin shpirtëror. Ihrami për të nënkupton largimin nga dynjaja dhe përgatitjen e një takimi bujar mes tij dhe Krijuesit të tij në botën tjetër, takim që pozita, pasuria dhe petku atë ditë nuk kanë vlerë. Respektimi i rregullave të ihramit është më shumë se një detyrim ligjor, ai është edhe një lloj testi për sinqeritetin dhe përkushtimin e besimtarit ndaj Allahut. Shkelja e ndonjë prej rregullave të tij nuk është vetëm një humbje e mundësisë për t'u afruar me Zotin, por gjithashtu një dëm shpirtëror që ndikon në vlerën e këtij udhëtimi shpirtëror.

Ky punim ka për qëllim ta trajtojë konceptin e ihramit nga një perspektivë juridiko-fetare islame, duke sqaruar dispozitat që lidhen me të, si dhe duke shqyrtuar kundërvajtjet që mund të ndodhin gjatë kësaj gjendjeje të shenjtë dhe pasojat që burojnë nga këto shkelje.

Fjala “*ihram*” rrjedh nga rrënja arabe “*h-r-m*” (حرم), që ka kuptimin e “*ndalimit*” ose “*ndalimit të diçkaje*”. Ihrami është një veshje e cila përbëhet nga dy copa petku, pjesa e sipërme (err rida) dhe pjesa e poshtme (el izar), pjesë këto që duhet të jenë të pa qepura (të ndara). Kur përdoret në kontekstin e haxhit dhe umres, “*ihram*” do të thotë gjendja e ndalimit dhe shenjë të hyrjes në një periudhë të shenjtë, ku individët ndalohen nga disa veprime që janë të lejueshme në jetën e përditshme.¹ Pra, ihrami është një gjendje shpirtërore dhe fizike, ku besimtari i përkushtohet Zotit dhe përgatitet për t'i kryer ritualet e haxhit ose umres, duke përmbushur kërkesat e tij shpirtërore dhe fizike. Ndërsa në aspektin terminologjik



kemi definicione të ndryshme, ndër to mund të përmendim definicionin e Ibën Abidinit, i cili thotë: “Ihrami është një periudhë që kërkon një nivel të lartë të kujdesit shpirtëror dhe përkushtimit, duke përmbushur një numër kërkesash dhe ndalimesh që janë pjesë e këtij udhëtimi shpirtëror.”²

Në këtë kontekst, ihrami kërkon që individi të përmbahet ndaj disa veprimeve, të cilat në parim janë të lejuara, përfshirë përdorimin e parfumit, prerjen e flokëve, dhe disa akte, por që gjatë ihramit janë të ndaluara. Shkeljet e këtyre rregullave mund të kërkojnë një kompensim, siç është një sakrificë, dhe shpesh ndodhin ndëshkime të ndryshme për ata që nuk i respektojnë ato.³ Në përfundim, ihrami në gjuhën arabe lidhet me konceptin e ndalimit të veprimeve të zakonshme, duke krijuar një ndarje midis jetës së përditshme dhe periudhës së shenjtë të haxhit, dhe ka një rëndësi juridike dhe shpirtërore që e bën këtë periudhë të veçantë dhe thelbësore për besimtarët.

RREGULLAT DHE DISPOZITAT E IHRAMIT

Ihrami, si gjendje fetare e caktuar, mbart me vete një sërë dispozitash të bazuara në tekste themelore islame dhe në ixhtihadin e dijetarëve. Në momentin kur personi hyn në ihram, ai e ka bërë nijet dhe ka vendosur që t’ia filloj këtij adhurimi madhështor, kështu duke nisur nga ai çast haxhiu fillon me shqiptimin e telbijes - lutjes se përgjigjes ndaj ftesës së Allahut (Lebejke Allahumme lebbejk...)⁴ Ai e ka obligim të përmbahet nga një sërë veprimesh që janë të ndaluara për shkak të shenjtërisë së kësaj gjendjeje.⁵

SUNETET E IHRAMIT

Në këtë gjendje, besimtari largohet nga deret e jetës dhe bën përpjekje maksimale në forcimin shpirtëror. Ihrami për të nënkupton largimin nga dynjaja dhe përgatitjen e një takimi bujar mes tij dhe Krijuesit të tij në botën tjetër, takim që pozita, pasuria dhe petku atë ditë nuk kanë vlerë. Vazhdueshmëria e këndimit të telbijes, preferohet që të përsëritet tri herë, burrat të këndojnë telbijen me zë të lart, ndërsa gratë nuk e ngrenë zërin e tyre, falja e dy rekateve sunet pas veshjes së ihrameve, ihramat të jenë të ri, veshja e

ihramit nga vendlindja, nëse vendi i lindjes është përtej vendveshjes – mikateve etj..⁶

NDALLESAT QË VLEJNË PËR HAXHIUN DERISA AI ËSHTË ME IHRAM

Dijetarët kanë identifikuar një numër veprimesh që janë të ndaluara për personin që ndodhet në ihram. Disa nga më të rëndësishmet përfshijnë:

- Marrëdhëniet intime dhe gjithçka që i paraprinë atyre;
- Veshja e rrobave të qepura, si këmisha, pantallonat, çorapet apo rrobat e brendshme, vlen të theksohet se kjo ndalesë vlen vetëm për meshkujt dhe assesit për femrat;
- Mbulesa e kokës të meshkujt (qoftë me kapelë, shall apo të ngjashme), si dhe mbulimi i fytyrës të femrat, vlen të theksohet që mbajtja e çadrës nuk është e ndaluar;
- Parfumoja me çfarëdo lloji të parfumeve;
- Rruaja, ndukja apo shkurtimi i qimeve qoftë në kokë, apo kudo tjetër në trup;
- Prerja e thonjve;
- Përleshja apo fjalosja;
- Gjuetia ose mbytyja e kafshëve, qoftë atyre që iu hahet mishi, apo edhe atyre që nuk iu hahet;
- Prerja, thyerja apo shkulja e pemëve, bimëve apo barit në territorin e Haremit (këtu nuk bëjnë pjesë ato pemë që janë mbjellë nga dora e njeriut).^{7 8}
- Shkelja e këtyre ndalesave sjell pasoja të caktuara, që variojnë nga sadakaja, fidja, apo anulimi i haxhit në rastet më të rënda.⁹ Kjo do të shtjellohet më vonë.

Për veshjen e ihramit e kemi vendin dhe kohën e caktuar. Sa i përket kohës së veshjes së tij, ajo fillon dhe mund të realizohet brenda muajve të haxhit e të cilët janë: muaji sheval, dhulkade dhe dhjetë ditët e para të muajit dhulhixhe, të cilët janë theksuar na Kuranin famëlartë: “Haxhi është në muajt e caktuar.”¹⁰

Ndërsa sa u përket vendeve të veshjes së tij, po ashtu ato janë të përcaktuara, dhe të tillat quhen Mikate - vende ku vishen ihramet, të cilat haxhiu nuk lejohet t’i tejkalojë pa veshjen e ihramit.

Në momentin kur personi hyn në ihram, ai e ka bërë nijet dhe ka vendosur që t’ia filloj këtij adhurimi madhështor, kështu duke nisur nga ai çast haxhiu fillon me shqiptimin e telbijes - lutjes se përgjigjes ndaj ftesës së Allahut (Lebejke Allahumme lebbejk...).



Rëndësi të veçantë mikateve-vendveshjeve të ihrameve u dha vetë Pejgamberi a.s., i cili i caktoi ato në të gjitha anët e Mekës. Ato janë në distancë të ndryshme nga Meka e shenjtë, varësisht se nga cila rrugë vjen haxhiu.¹¹

Mikatat-vendveshjet ku haxhilerët duhet t'i veshin ihramet janë:

- Dhul Hulejfeh është mikati i banorëve të Medinës dhe atyre që kalojnë nëpër Medinë;
- El Xhuhfeh është mikati i banorëve të Shamit, Egjiptit, Marokut dhe vendeve të tjera rreth tyre;
- Karnul Menazil është mikati i banorëve të Nexhdit;
- Jelemlen është mikati i banorëve të Jemenit;
- Dhatul Irk është mikati i banorëve të Irakut.^{12 13}

Është obligim për secilin njeri që dëshiron ta kryejë haxhin ose umren që të mos i tejkalojë këto vende-mikate, përveçse me ihram, pa marrë parasysh a vjen nga toka, deti apo ajri-përmes fluturimeve. E nëse i kalon vendet e lartpërmendura pa ihram, duhet të kthehet përsëri aty dhe ta veshë ihramin, përndryshe nëse vazhdon rrugëtimin pa e veshur ihramin, obligohet me therje të kurbanit. Ndërsa banorët e Mekës ose rrethinës së saj, të cilët jetojnë më afër sesa mikatat, i veshin ihramet e tyre nga shtëpitë e tyre.^{14 15}

GJATËSIA E QËNDRIMIT NË IHRAM

Zgjatja e qëndrimit në ihram varet nga lloji i haxhit që kryen personi:

- Në haxhin kiran, ku haxhiu synon ta kryej haxhin dhe umren bashkë, ihrami nuk hiqet nga fillimi deri në ditën e therjes së kurbanit, ditën e 10-të të dhulhixhes.
- Në haxhin temettu, në të cilin kryhet umreja së pari pastaj haxhi, ihrami hiqet pas përfundimit të umres, dhe haxhiu hyn sërish në ihram për haxhin më 8 dhulhixhe.
- Në haxhin ifrad, në të cilin bëhet nijet vetëm haxhi, haxhiu hyn në ihram vetëm për haxh dhe qëndron në të deri në ditën e 10-të të dhulhixhes.¹⁶

LIRIMI NGA IHRAMI

Lirimi nga ihrami nënkupton heqjen e tij, veshjen e rrobave të rëndomta, si dhe lejimin e ndalesave që i kishte gjatë kohës që ishte me ihram, e gjitha kjo pas kryerjes së disa ritualeve të caktuara. Lirimin nga ihrami dijetarët tanë të ndershëm e kanë ndarë në dy kategori, të cilat janë si në vijim:

Lirimi i vogël apo i parë, ky lirim bëhet pasi haxhiu të ketë kryer të paktën dy nga ritualet e haxhit, e ato janë: gjuajtja e guralecëve në ditën e parë, therja e kurbanit ose rruaja apo shkurtimi i flokëve. Me këtë haxhiu lirohet nga të gjitha ndalesat e ihramit, me përjashtim të intimitetit bashkëshortor.

Lirimi i plotë apo përfundimtar nga ihrami. Ky lirim realizohet kur haxhiu kryen veprat e lartcekura të lirimit i vogël, dhe përveç kësaj kryen edhe tavafin e haxhit, Ez Zijarah, nga ky moment haxhiut i lejohen të gjitha ndalesat që i kishte sa ishte në ihram, duke përfshirë këtu edhe kontaktin apo intimitetin bashkëshortor, dispozitë kjo për të cilën janë pajtuar dijetarët, pra është me konsensus të tyre.¹⁷

KUNDËRVAJTJET – GABIMET E HAXHIUT

Në terminologjinë fikhore, kundërvajtjet në ihram nënkuptojnë veprimet që janë të ndaluara gjatë kohës së ihramit, e që ishin të lejuara para hyrjes në ihram, ku çdo shkelje e tyre kërkon kompensim. Kundërvajtjet në ihram ndahen sipas natyrës së tyre dhe sipas pasojave që ato shkaktojnë në vlefshmërinë e haxhit. Jurisprudenca islame i trajton këto me kujdes, duke i shtjelluar këto kundërvajtje apo gabime, duke treguar për pasojat e tyre, si dhe si mund të shpaguehen ato në varësi të veprës dhe rrethanave në të cilat haxhiu ka gabuar.

Sipas medhhebit hanefi, kundërvajtjet klasifikohen në këto kategori:

Shkeljet ligjore që bëhen gjatë kohës që haxhiu është në ihram, dhe

Shkeljet ligjore që i përkasin vendeve të shenjta në Mekë, përkatësisht Haremit.

Fillimisht do të shtjellojmë shkeljet që bëhen gjatë kohës sa haxhiu është në ihram. Këto shkelje mund të themi që kategorizohen si në vijim:

Shkeljet që e bëjnë haxhin të pavlefshëm në tërësi dhe obligojnë therjen si shpagim. Në këtë kategori hyn kontakti intim bashkëshortor, kontakt ky që ka ndodhur pas veshjes së ihramit dhe para daljes në Arafat, këtu nuk merret parasysh a ka ndodhur qëllimisht, apo nga harresa. Në këtë rast, haxhi është i pavlefshëm, dhe si masë ndëshkuese ata vazhdojnë ritualet e këtij haxhi, duhet të presin një dele apo dash, si dhe obligohen që vitin vijues të vijnë ta kryejnë haxhin, sigurisht duke pasur parasysh veprën e bërë dhe duke qëndruar larg njëri-tjetrit sipas mundësisë.¹⁸

Shkeljet për të cilat haxhiu obligohet të therë një kafshë të trashë si shpagim për gabimin e bërë. Në këtë kategori hynë

intimiteti bashkëshortorë, i cili ka ndodhur pas daljes në Arafat duke qenë i veshur me ihram. Këtu haxhiu obligohet me prerjen e një kafshe të trashë si lopa apo deveja etj.. Në këtë kategori bën pjesë edhe rasti nëse haxhiu e kryen tavafin e vizitës së haxhit (tavafu-zijares) duke qenë xhunub – i papastër me papastërti të rëndë.

Shkeljet për të cilat haxhiu obligohet të therë një kurban të vogël, si dele apo dash.¹⁹ Në këtë kategori bëjnë pjesë veprimet vijuese: prerja e flokëve – nëse haxhiu pret më shumë sesa 4\1 e flokëve, apo mjekrës, ose heq qimet nga njëra nënsqetull; prerja e thonjve – nëse haxhiu pret thonjtë e njëres dorë në tërësi; Parfumoja – nëse haxhiu e parfumo një pjesë të tij në tërësi cilado qoftë ajo; veshja e rrobave të qepura apo petkut të rëndomtë – nëse haxhiu bën këtë veprim, atëherë obligohet me therje të kurbanit, qoftë nëse e ka veshur më ihram, qoftë pa të, me kusht që ta ketë mbajtur një ditë të plotë.²⁰

Vlen të theksohet që nëse veprimet e përmendura bëhen më pak sesa ajo që u sqarua ka shpagim me sadaka, rrjedhimisht nëse ka prerë më pak sesa 1\4 e flokëve apo mjekrës, ose ka prerë një apo dy thonj, ose ka parfumuar më pak sesa një gjymtyrë e plotë, ose e ka mbajtur rrobën më pak sesa një ditë të plotë etj..²¹

SHPAGIMET NË RAST TË MOSKRYERJES SË NDOJË PREJ VAXHIBEVE TË HAXHIT

Nëse haxhiu bën njërën nga veprimet vijuese, atëherë obligohet me therjen e një kurbanit, ndër to përmendim: kryerja e tavafit të arritjes ose atij të lamtumirës duke qenë xhunub – i papastër, kryerja e tavafu-zijares duke qenë pa abdes në katër rrotullimet e para, moskryerja e tavafit të lamtumirës, moskryerja e sajit, vrapimit mes Safasë dhe Mervës, largimi nga Arafati pa perënduar dielli, mos qëndrimi në Muzdelife, qoftë dhe një pjesë të natës, mos gjuajtja e gurëve në tri ditët e Bajramit, mos qethja e flokëve etj..

Shkeljet ligjore që i përkasin vendeve të shenjta në Mekë, përkatësisht Haremit – Kur treguam gjërat që ndalohen për haxhiun sa është në ihram përmendëm edhe gjuajtjen apo mbytjen e kafshës, prerjen e pemëve, thyerjen apo edhe shkuljen e tyre, andaj nëse haxhiu bën njërën nga këto veprime në Harem duhet t'i kompensoj si vijon: Për gjuajtjen apo mbytjen e kafshës së tokës çfarëdo qoftë ajo, pavarësisht a i hahet mishi apo jo, haxhiu obligohet ta paguaj të njëjtën kafshë apo vlerën e saj dhe kjo përderisa ai është në haxh, nëse haxhiu pret ndonjë degë peme, apo të ngjashme nga ato të cilat kanë mbirë vetvetiu, atëherë ai duhet të japë sadaka në vlerën e saj te ndonjë i varfër i asaj zone. Vlen të theksohet që nëse haxhiu vret ndonjë gjë më të vogël e cila nuk konsiderohet madje as gjueti, si ndonjë insekt apo buburrec, atëherë ai jep sadaka modeste akoma më e vogël se gjysma e sa'it.²²

Mund të themi se këto janë disa rregulla lidhur me kundërvajtjet apo gabimet e haxhiut gjatë kohës së haxhit.

Nga ajo që u trajtua deri më tani, mund të konkludohet se respektimi i kufijve të ihramit nuk përbën vetëm një zbatim formal të rregullave të Sheriatit, por paraqet një përpjekje të ndërgjegjshme për të ruajtur thelbin e devotshmërisë dhe ndershmërisë së besimtarit gjatë kësaj udhe të shenjtë. Ihrami është gjendje që e zhvendos myslimanin nga përditshmëria drejt një dimensionit të lartë shpirtëror, ku çdo veprim dhe qëndrim matet me përgjegjësi para Allahut.

Kundërvajtjet në ihram, të trajtuara me kujdes nga dijetarët e fikhut, e në veçanti nga juristët e medhhebit hanefi, dëshmojnë se Islami nuk mjaftohet vetëm me qëllimin, por i kushton rëndësi edhe mënyrës dhe rregullave që shoqërojnë adhurimin. Dispozitat juridike që lidhen me kundërvajtjet dhe ndëshkimet përkatëse shërbejnë për të mbrojtur pastërtinë dhe vlerën e ibadetit, duke i rikujtuar haxhiut rëndësinë e disiplinës, përkushtimit dhe respektit ndaj shenjtërisë së riteve.

Në përmbyllje, kujdesi në respektimin e ihramit dhe shmangia e kundërvajtjeve janë pjesë përbërëse e suksesit të haxhit. Ato pasqyrojnë nivelin e vetëdijes fetare të haxhiut dhe gatishmërinë e tij për ta përjetuar këtë adhurim si një udhëtim të thellë shpirtëror dhe për ta fituar kënaqësinë dhe pranimin e Allahut të Madhëruar.

1 Firuzabadi, *El Kamus el Muhit*, f. 131.

2 Ibën Abidin, *Reddul Muhtar ala'd-Durrit-Muhtar*, f. 185.

3 Jusuf el Karadavi, *Fikhu'l-Haxh*, f. 143.

4 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, 1474.

5 Hasen bin Ammar esh Shurunbulali, *Nurul Idah ve nexhatul ervah*, f. 328.

6 Mustafa el Buga, *El Fikh el Hanefij bi ediletihi*, f. 683.

7 Burhanudin el Merginani el Hanefij, *El Hidaje*, f. 146.

8 El Kasani, *Bedaiu Sanai*, f. 182–183.

9 Muhamed ibën Abdullah ibën Mesud, Ibnul-Humam, *Fethu el Kadir*, f. 475–480.

10 Mustafa el Buga, *El Fikh el Hanefij bi ediletihi*, f. 697.

11 Muhamed ibën Abdullah ibën Mesud, Ibnul-Humam, *Fethu el Kadir*, f. 434.

12 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, 1688.

13 Muslimi bin el Haxhaxh, *Sahih el Muslim*, 1181.

14 Abdulganij el Gunejmi el Hanefij, *El Lubab fi sherh el kitab*, f. 180.

15 Burhanudin el Merginani el Hanefij, *El Hidaje*, f. 163.

16 Mustafa el Buga, *El Fikh el Hanefij bi ediletihi*, f. 694.

17 Po aty.

18 Kemaluddin Muhamed ibën Abdullah ibën Mesud, Ibnul-Humam, *Fethu el Kadir*, f. 480.

19 Burhanudin el Merginani el Hanefij, *El Hidaje*, f. 146.

20 El Kasani, *Bedaiu Sanai*, f.183.

21 Po aty.

22 Burhanudin el Merginani el Hanefij, *El Hidaje*, f. 208.

Lehtësimet e haxhit për gratë

Dr. Violeta Smajlaj

HYRJE

Haxhi është një ndër shtyllat themelore të Islamit, me një dimension të thellë shpirtëror dhe etik, që kërkon përgatitje fizike, financiare dhe shpirtërore. Për gratë myslimane, ky adhurim merr një karakteristike të veçantë, për shkak të natyrës së tyre, përgjegjësiwe sociale, si dhe rregullimeve ligjore që i përfshijnë. Sheriati islam ka parashikuar lehtësime të posaçme për gratë në lidhje me haxhin, të cilat bazohen në parimin e lehtësimit (tejsir), shmangies së vështirësive (ref’ul harexh), dhe mbrojtjes së nderit, dinjitetit dhe sigurisë së tyre.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë dispozitat që lidhen me haxhin për gratë sipas medhhebit hanefi në dritën e objektivave të sheriatit (mekasid esh sheria), të vëzhgojë lehtësimet e parashikuara nga juristët, si dhe të shqyrtojë aplikueshmërinë e tyre në realitetin bashkëkohor.



Ky studim përqendrohet te disa aspekte kryesore si: haxhi si një formë e xhihadit shpirtëror për gratë, roli i mahremit, ndikimi i menstruacioneve, gjendja shëndetësore, aspektet sociale, si dhe mënyrat e udhëtimit në realizimin e obligimit të haxhit.

Studimi synon të përgjigjet në pyetjen: cilat janë lehtësimet që Islami parashikon për gratë gjatë kryerjes së haxhit? Për këtë qëllim, përdoret një qasje cilësore dhe analitike, e mbështetur në analizën e burimeve islame si Kurani, Suneti dhe veprat klasike të fikhut hanefi.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI HAXHIN

Në aspektin gjuhësor, fjala “haxh” nënkupton “udhëtim me qëllim vizite”, ndërsa në terminologjinë juridike islame përkufizohet si: Udhëtimi drejt Shtëpisë së Shenjtë (Qabesë) për t’i kryer ritualet e veçanta në kohë të caktuar, sipas një mënyre të rregulluar nga Sheriati.¹

Haxhi në Qabe është një nga ritet më madhore të Islamit dhe një nga pesë shtyllat themelore të fesë. Ai është detyrë individuale (farz ajn) për çdo mysliman dhe myslimane që përmbushë kushtet përkatëse – një herë në jetë – dhe pas kësaj është adhurim vullnetar (nafile).

Obligueshmëria e këtij adhurimi buron nga ajeti kuranor: “Për hir të Allahut, vizita e Shtëpisë (Qabesë) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimiti tek ajo.” (El Maide, 97).

HAXHI ËSHTË FORMA MË E LEHTËSUAR E XHIHADIT PËR GRATË

Për gruan myslimane, haxhi nuk është vetëm një detyrë rituale, por një udhëtim shpirtëror i thellë, ku trupi, pasuria dhe zemra bashkohen në një akt sublim përkushtimi ndaj

Allahut. Në një shoqëri ku gratë nuk mbajnë barrën e luftës fizike, Islami, me mëshirë dhe urtësi, u ka caktuar atyre një formë të veçantë përpjekjeje – një xhihad pa armë, që kërkon përkushtim dhe sakrificë - haxhin.

Aisheja, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmeton se pyeti të Dërguarin a.s.: “O i Dërguar i Allahut, a kanë gratë detyrë për xhihad?” Ai u përgjigj: “Po, ato kanë një xhihad ku nuk ka luftë: haxhi dhe umreja.”² Ndërsa në një transmetim tjetër nga Buhariu, Aisheja tregon: “Ne e konsiderojmë xhihadin si veprën më të madhe. A të mos bëjmë edhe ne xhihad?” I Dërguari a.s. tha: “Xhihadi më i mirë është një haxh i pranuar.”³

Ky pohim profetik e vendos haxhin në qendër të përkushtimit të gruas ndaj Zotit, duke e trajtuar atë si një formë të ndritshme të sakrificës, durimit dhe adhurimit. Është një përvojë që kërkon përgatitje fizike, përballje me sfida biologjike, menaxhim të kushteve sociale dhe ligjore, por e gjitha në një atmosferë devocioni.

LEHTËSIMI NË OBLIGIMIN E HAXHIT PËR GRATË

E drejta islame është e ndërtuar mbi parime thelbësore që synojnë t’u mundësojnë besimtarëve të praktikojnë fenë e tyre pa vështirësi të panevojshme. Një prej këtyre parimeve është pikërisht lehtësimi (tejsir), i cili përbën jo vetëm një normë juridike, por edhe një qasje gjithëpërfshirëse në legjislacionin islam. Kjo qasje reflekton mëshirën dhe urtësinë hyjnore, duke e përshkruar fenë si të mesme, të drejtë dhe të realizueshme për çdo individ, sipas mundësive dhe kapaciteteve reale të tij. Në këtë kuadër, Kurani thotë me qartësi: “Allahu nuk e ngarkon asnjë shpirt përtej mundësisë së tij.” (El Bekare, 286).

Obligimi i haxhit është i përcaktuar qartë për çdo mysliman dhe myslimane që plotëson kushtet themelore: të jetë mysliman, menderishtë i shëndoshë, i rritur, të ketë aftësi financiare dhe fizike, si dhe siguri gjatë rrugëtimit.⁴ Këto kushte vlejnë për të dy gjinitë, por për gratë, Sheriati ka shtuar një kusht specifik që lidhet me praninë e një mahremi – mashkull i afërt, me të cilin martesë është e ndaluar përgjithmonë.

Sot, me zhvillimet e mëdha në transport, sigurinë dhe organizimin e haxhit, shumë dijetarë bashkëkohorë kanë theksuar se qëllimi i Sheriatit nuk është vetë mahremi si figurë, por garantimi i sigurisë dhe mbrojtjes së gruas gjatë rrugëtimit, nëse këto kushte realizohen përmes bashkësisë fetare përkatëse dhe shoqërimit me gra të tjera fisnike sikurse vetë ajo. Ky interpretim përforcon faktin se lehtësimi është norma, jo përjashtimi.

Sipas shumicës së dijetarëve, nuk lejohet që gruaja të udhëtojë për haxh përveçse me një mahrem ose me gra të besueshme, ndërsa hanefitë e kushtëzuan mahremin dhe e konsideruan atë si një nga kushtet për obligueshmërinë e haxhit.⁵

Sipas këtij qëndrimi, nëse një grua nuk ka mahrem për ta shoqëruar në udhëtim, atëherë haxhi nuk është i obligueshëm për të, edhe nëse ajo i plotëson kushtet e tjera si gjendja financiare dhe fizike. Ky kusht synon të mbrojë sigurinë, nderin dhe dinjitetin e gruas, veçanërisht gjatë një udhëtimi të gjatë dhe të vështirë, i cili shpesh përfshin sfida fizike, kontakte me njerëz të panjohur dhe situata publike të ndryshme.

Sot, me zhvillimet e mëdha në transport, sigurinë dhe organizimin e haxhit, shumë dijetarë bashkëkohorë kanë theksuar se qëllimi i Sheriatit nuk është vetë mahremi si figurë, por garantimi i sigurisë dhe mbrojtjes së gruas gjatë rrugëtimit, nëse këto kushte realizohen përmes bashkësisë fetare përkatëse dhe shoqërimit me gra të tjera fisnike sikurse vetë ajo. Ky interpretim përforcon faktin se lehtësimi është norma, jo përjashtimi.

LEHTËSIMI NË PËRGATITJEN SHËNDETËSORE

Para se të niset për haxh, gruaja rekomandohet që të konsultohet me mjekun për të vlerësuar gjendjen e saj të përgjithshme shëndetësore dhe për të marrë udhëzimet e nevojshme në lidhje me mbrojtjen e shëndetit gjatë udhëtimit. Një vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet ruajtjes së higjienës personale dhe menaxhimit të ciklit menstrual, përfshirë këtu përdorimin e barnave të lejuara në Islam, vetëm me këshillimin dhe miratimin e mjekut specialist.

Stërvitja shpirtërore, fuqizimi i durimit dhe ndjenja e përkushtimit janë elemente kyçe për ta përjetuar këtë udhëtim me qetësi dhe përkushtim.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh)⁶, në bashkëpunim me Ministrinë Saudite të Shëndetësisë⁷, ka publikuar udhëzime të veçanta për haxhilerët, duke përfshirë aspektet e higjienës, vaksinimeve dhe kujdesit për gratë në gjendje të veçanta shëndetësore. Po ashtu, shumë dijetarë islamë e konsiderojnë të



lejuar përdorimin e barnave për të shtyrë menstruacionet gjatë haxhit, me kushtin që ato të mos shkaktojnë dëm për shëndetin e gruas dhe të jenë të miratuara nga specialistët, gjë që përputhet me parimin e lehtësimit në Sheriat.

LEHTËSIMI NË VESHJEN E IHRAMIT

Mikat është kufiri hapësinor përreth Mekës ku çdo person që ka për qëllim të kryejë haxhin ose umren duhet të hyjë në gjendjen e ihramit. Ky është një kufizim i qartë fetar që ndan gjendjen e zakonshme nga ajo rituale. Për gratë, sikurse për burrat, është e detyrueshme që të hyjnë në ihram para se të kalojnë mikatin, nëse vijnë nga jashtë këtyre kufijve. Në rastet e udhëtimit me aeroplan, praktika më e përhapur është që ihrami të fillojë pak para se aeroplani të kalojë mbi mikatin ose në vendin e nisjes, duke marrë parasysh që distanca ajrore mund të mos përputhet saktësisht me mikatin tokësor.

Sidoqoftë, Sheriati, në përputhje me parimin e lehtësimit, ofron rregulla të veçanta për gratë në çështjen e veshjes gjatë ihramit. Ndërsa burrave u ndalohet kategorikisht veshja e rrobave të qepura (të formësuara për trupin), grave u lejohe të veshin çdo lloj veshjeje që është e pastër dhe e përshtatshme që përmbush kriteret islame të mbulimit të trupit. Ky lehtësim i veçantë tregon qartë se Islami e ka marrë në konsideratë diversitetin e natyrshëm gjinor dhe ka paraparë dispozita të përshtatshme për secilin.

Megjithatë, grave u ndalohet të përdorin rroba specifike që mbulojnë fytyrën dhe duart gjatë qëndrimit në ihram, si nikabi dhe dorëzat. Kjo dispozitë rituale është mbështetur në hadithin e transmetuar nga Pejgamberi a.s., ku ai ka thënë: “Gruaja që është në ihram nuk duhet të mbulojë fytyrën me nikab dhe as të veshë doreza.”⁸

Në këtë mënyrë, dispozitat për veshjen e ihramit për gratë nuk janë kufizuese apo penguese, por përkundrazi, janë të ndërtuara mbi parimin e lehtësimit dhe përshtatjes me rrethanat dhe natyrën e veçantë të gruas. Ato ruajnë balancën midis kërkesave rituale dhe respektit për dinjitetin, duke e bërë përvojën e haxhit më të qasshme dhe më të përjetueshme për gratë.

LEHTËSIMI NË SHQIPTIMIN E TELBIJES

Para se të fillojë kryerja e riteve të haxhit apo umres, gruaja hyn në gjendjen e ihramit duke formuluar nijetin – qëllimin e adhurimit – me vetëdije të qartë në zemër, siç është kërkuar nga parimet themelore të fikhut. Menjëherë pas nijetit, ajo shqipton telbijen ose dhikër të ngjashëm me të, e cila përbën jo vetëm një akt shpirtëror të thellë përmes të cilit i përgjigjet thirrjes së Allahut për haxh, por edhe një komponent juridik të domosdoshëm për vlefshmërinë e ihramit. Sipas shumë dijetarëve, veçanërisht në medhhebin hanefi, nijeti i brendshëm nuk mjafton për të hyrë në ihram; shqiptimi i telbijes është kusht për t'i dhënë efekt këtij akti.⁹

Teksti i telbijes, sipas traditës profetike është si vijon:

لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ، إِنَّ
الْحَمْدَ وَالنَّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكَ، لَا شَرِيكَ لَكَ

“Të përgjigjem Ty, o Allah, të përgjigjem! Të përgjigjem, nuk ke shok; të përgjigjem! Pa dyshim, lavdia, begatia dhe sundimi janë për Ty. Nuk ke shok.”¹⁰

Në këtë rast, gratë shqiptojnë telbijën me zë të ulët.

LEHTËSIMI GJATË TAVAFIT

Momenti i pamjes së Qabesë, simbolit të unitetit të ymetit dhe përlësisë para Krijuesit, është ndër përjetimet më të thella të rrugëtimit për haxh. Për gruan myslimane, ky çast nuk përfaqëson vetëm një ndalesë fizike, por një hyrje në hapësirën e shenjtërisë. Ky është çasti kur udhëtimi bëhet takim dhe përpjekja kthehet në qetësi të shpirtit, në vendin ku lutjet ngrihen më pranë dhe më shpejt pranohen.

Gratë që kryejnë haxhin temettu – forma më e përhapur sot – fillimisht e realizojnë umren, e cila përfshin: hyrjen në ihram; kryerjen e tavafit, ecjen rituale (sajin) ndërmjet Safasë dhe Mervas; dhe më pas daljen nga ihrami përkohësisht deri më 8 dhulhixhe, kur ato hyjnë sërish në ihram për të përmbushur pjesën e mbetur të haxhit.

Tavafi, një nga shtyllat kryesore të haxhit, përbëhet nga rrotullimi shtatë herë rreth Qabesë, duke filluar nga Haxherul-Esved (Guri i Zi) dhe duke e mbajtur atë në anën e majtë. Ky rrotullim bëhet në drejtim të kundërt me akrepat e orës, simbolizues i unitetit të krijësive rreth qendrës së adhurimit.

Për gratë, shfaqen një sërë lehtësimesh të rëndësishme gjatë tavafit: Nuk u kërkohet ecje e shpejtë (remel) në tri rrotullimet e para; lutjet dhe përmendja (dhikret) shqiptohen me zë të ulët; shmangin përzjerjen me turma të dendura sa herë që është e mundur edhe nëse kështu nuk arrihet prekja e Gurit të Zi.

Sipas medhhebit hanefi, gruaja që është në gjendje hajzi (me menstruacione) ose nifasi (lehoni) nuk lejohet të kryejë tavafin, por duhet shtyrë patjetër deri pas pastrimit, sepse kjo vepër konsiderohet në nivelin e namazit dhe kërkon pastrim.

Sipas medhhebit hanefi, gruaja që është në gjendje hajzi (me menstruacione) ose nifasi (lehoni) nuk lejohet të kryejë tavafin, por duhet shtyrë patjetër deri pas pastrimit, sepse kjo vepër konsiderohet në nivelin e namazit dhe kërkon pastrim.

Megjithatë, nëse gruaja ndodhet ende në gjendje të papastër (me hajz apo nifas) dhe i afrohet momenti i largimit nga Meka pa mundësi për të qëndruar më gjatë, disa dijetarë e kanë lejuar tavafin në këtë gjendje si një lehtësim, për të shmangur vështirësinë e madhe dhe dëmin që mund të shkaktojë mungesa e riteve. Kjo bazë ligjore e lehtësimit mbështetet në parimin e shmangies së vështirësisë dhe nevojës së ngutshme (darrura), dhe e detyron atë të japë fidje (kompensim ritual) në formën e therjes së një kurbani, që shpërndahet për të varfrit.

Ky lehtësim flet qartë për përkujdesjen e ligjit islam ndaj grave, duke ruajtur ekuilibrin ndërmjet respektimit të riteve dhe ruajtjes së mirëqenies së tyre. Ai reflekton një qasje që nuk është e ngurtë, por e drejtë, praktike dhe mëshirëplotë.

LEHTËSIMI NË SAJIN NDËRMJET SAFASË DHE MERVAS

Ky rit është një nga përjetimet më të gjalla shpirtërore gjatë haxhit, sepse rrjedhë nga përvoja e një gruaje – Haxheres (pagja qoftë mbi të) – që u bë simbol i besimit dhe mbështetjes te Zoti.

Për gruan myslimane, saji nuk është vetëm një ecje fizike, por një nderim dhe përtëritje e gjurmës së një gruaje që u bë simbol i historisë islame, duke vrapuar ndërmjet dy kodrave në kërkim të ujit për birin e saj.

Në aspektin praktik, saji rekomandohet të kryhet menjëherë pas tavafit, si vazhdim i natyrshëm i riteve. Por nëse gruaja nuk ka kryer ende tavafin pasi ka qenë në gjendje hajzi (menstruacione), atëherë ajo duhet të presë derisa të pastrohet dhe më pas të vazhdojë me tavafin dhe sajin, nëse rrethanat kohore e lejojnë.

Megjithatë, ndryshe nga tavafi, për sajin nuk kërkohet pastrim i madh ritual (taharet). Kjo do të thotë se, nëse gruaja ka kryer më parë tavafin në gjendje të pastër, dhe më pas i kanë filluar menstruacionet, lejohet të vazhdojë me sajin, pasi pastërtia nuk është kusht për vlefshmërinë e këtij riti. Ky është një nga lehtësimet e rëndësishme të haxhit për gratë, që u mundëson atyre ta përmbushin adhurimin e tyre pa vështirësi të panevojshme.

Gjatë ecjes ndërmjet Safasë dhe Mervas, gratë nuk bëjnë vrapin e shpejtë (harvele) në pjesën e gjelbër që ndodhet ndërmjet dy shenjave.

LEHTËSIMI NË PRERJEN E FLOKËVE

Pas përfundimit të sajit, pelegrinët përgatiten për daljen nga gjendja e ihramit përmes një veprimi simbolik – prerjes së flokëve. Në këtë rrafsh, Islami ka parashikuar një lehtësim të qartë për gratë, në mënyrën se si ato e kryejnë këtë veprim. Në vend që të rruajnë të gjithë kokën si burrat – një praktikë që për ta është sunet – gratë vetëm i shkurtojnë flokët, duke prerë një pjesë të vogël të tyre, zakonisht sa një majë gishti nga çdo tufë flokësh. Ky veprim i thjeshtë është i mjaftueshëm për të dalë nga ihrami.

Ky rregull është i bazuar në hadithin autentik të Profetit Muhamed a.s., i cili ka thënë: “Gratë nuk e kanë detyrë rruajtjen e flokëve; për to mjafton vetëm shkurtimi i tyre.”¹¹

Ky lehtësim është një shembull i qartë i parimit të përshtatshmërisë në adhurim, duke marrë parasysh dinjitetin estetik dhe shëndetin e gruas, duke shmangur praktika që mund të konsiderohen të tepërta apo të papërshtatshme për to, siç është rruajtja totale e kokës.

LEHTËSIMI NË GJUAJTJEN E GURALECËVE NË MINA

Gjuajtja guralecëve në Xhemerat, gjatë ditëve të Teshrikut (10–13 dhulhixhe), është ndër ritet madhore të haxhit dhe përkujton kundërshtimin e shejtanit nga ana e Ibrahimit a.s.. Kjo praktikë përbëhet nga gjuajtja me shtatë guralecë në secilën nga tri shtyllat simbolike (Xhemre), në vendin e caktuar në Mina.

Nga dita e dhjetë deri në ditën e trembëdhjetë, gruaja duhet të përpiqet të kryejë vetë hedhjen e guralecëve, por në kuadër të parimit të lehtësimit, lejohet që të delegojë dikë tjetër nëse ka frikë nga turma, është e dobët fizikisht, është shtatzënë, ka fëmijë të vegjël, apo ndodhet në një gjendje shëndetësore që e bën të rrezikshme kryerjen personale të këtij riti.

Delegimi i hedhjes së guralecëve nuk e cenon vlefshmërinë e haxhit të gruas, përkundrazi, ai çmohet si kujdes i duhur në rrethana specifike.

PËRFUNDIM

Ky studim ka zbuluar me qartësi se Islami, në dritën e mëshirës dhe urtësisë hyjnore, ka vendosur një sërë lehtësimesh të posaçme për gratë gjatë kryerjes së haxhit. Këto dispozita janë të ndërtuara mbi njohjen e natyrës së tyre dhe sfidave të veçanta që ato përballojnë. Ato pasqyrojnë jo vetëm fleksibilitetin e jurisprudencës islame, por edhe thelbin e saj të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

Roli i mahremit, trajtimi i menstruacioneve, rregullat mbi veshjen gjatë ihramit, shqiptimi i telbijes dhe kujdesi shëndetësor janë elemente që dëshmojnë se lehtësimi në Islam është një formë e kujdesit. Në këtë kontekst, haxhi për gratë

shfaqet si një formë e veçantë xhihadi – një përpjekje e thellë shpirtërore.

Në realitetin bashkëkohor, ku kushtet teknologjike, organizative dhe sociale janë përmirësuar ndjeshëm, është thelbësore që këto lehtësime të aplikohen me mirëkuptim, fleksibilitet dhe vetëdije, për të garantuar që çdo grua muslimane të mund të përmbushë këtë detyrë madhore me besim, siguri dhe qetësi shpirtërore.

Kjo qasje e përqendruar te njeriu dhe mirëqenia e tij, sidomos e grave, është dëshmi e fuqishme e humanizmit që Islami sjell në jetën fetare dhe shoqërore të besimtarëve. Islami, duke ruajtur esencën e adhurimit, njeh dallimet dhe vështirësitë reale që hasin gratë, dhe për këtë arsye i adreson ato me butësi dhe kujdes. Ky përqafim i natyrës njerëzore brenda kornizës së ligjit hyjnor dëshmon se Islami është fe që u drejtohet zemrave, duke i afruar njerëzit me Zotin përmes lehtësimit dhe jo vështirësisë.

Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: “*Allahu dëshiron t’jua lehtësojë (çështjen), e nuk dëshiron t’jua vështirësojë...*” (El Bekare, 185).

- 1 Merginani, Ali bin Ebi Bekr, *El Hidejeh fi Sherhi Bidajeti-l-Mubtedi*, red. Talal Jusuf, Beirut: Daru Ihja Et Turath el Arabi, 1993, 2/123.
- 2 Ibën Maxhe, Muhamed bin Jezid el Kazvini, *Suneni i Ibni Maxhes*, përgatiti Shuajb Arnauti me të tjerë, Beirut: Dar Err-Risale el Alemije, 2009, 4/146 nr. 2901.
- 3 Buhariu, Muhamed bin Ismail, *Sahihu i Buhariut*, red. dr. Mustafa Dib el Buga, Damask: Dar Ibën Kethir dhe Dar El Jeamame, bot. 5, 1993, 2/8, nr. 1520.
- 4 Kasani, Ebu Bekër bin Mesud, *Bedaius sana'i fi tertibish sherai'*, bot. 1, Egjipt: Matbeatush sheriketil metbuatil ilmije, 1327–1328, 2/119.
- 5 Ibën Abidin, Muhamed Emin, *Redd el Muhtar ala ed Durr el Mukhtar Sherh Tenvir el Ebsar*, bot. 2. Kajro: Sheriketu Mektebetu ve Matbeatu Mustafa el Bab el Halebi ue Ebnauhu, 1966, 2/47.
- 6 Shih, Këshilla dhe udhëzime të përgjithshme shëndetësore për pelegrinët: <https://www.emro.who.int/media/news/general-health-advice-and-guidelines-for-pilgrims.html>.
<https://www.emro.who.int/cpi/programmes/umrah-hajj-safety.html#health-messages>.
- 7 Shih Ministry of Health – Saudi Arabia, *Health Guidelines for Hajj Pilgrims*: https://www.moh.gov.sa/HealthAwareness/Pilgrims_Health/Documents/English.pdf
- 8 Buhariu, *Sahihu i Buhariut*, 2/653, nr. 1741.
- 9 Merginani, *El Hidejeh fi Sherhi Bidajeti-l-Mubtedi*, 1/135; Ibën Abidin, *Redd el Muhtar ala ed Durr el Mukhtar Sherh Tenvir el Ebsar*, 2/479.
- 10 Buhariu, *Sahihu i Buhariut*, 2/561, nr. 1474; Muslimi, *Sahihu i Muslimit*, 2/841, nr. 1184.
- 11 Ebu Davudi, Sulejman bin Esh'ath, *Suneni i Ebu Davudit*, red. Shuajb Arnauti me të tjerë, bot. 1, Damask: Darur-Resale el Alemije, 2009, 3/341, nr. 1984–1985.

Flijimi i hz. Ismailit ndërmjet sproves, besnikërisë dhe miqësisë hyjnore

Prof. ass. dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Kurani paraqet modele sjelljeje, paralajmërimet ndaj devijimit dhe shpërblime për qëndrueshmërinë në besim.

Tregimet në Kuran zënë një vend të rëndësishëm në strukturën dhe mesazhin e tij, duke shërbyer jo vetëm si rrëfime historike, por edhe si mësimet morale, shpirtërore dhe edukative për besimtarët. Përmes ngjarjeve nga jeta e pejgamberëve dhe popujve të mëparshëm, Kurani paraqet modele sjelljeje, paralajmërimet ndaj devijimit dhe shpërblime për qëndrueshmërinë në besim. Këto tregime nuk janë të renditura në mënyrë kronologjike, por janë të ndërthurura me ligjëratat dhe urtësi, duke u përshtatur me kontekstin e

shpalljes dhe nevojat shpirtërore të lexuesit. Nëpërmjet tyre, besimtari mëson për vlerën e sinqeritetit, durimit, drejtësisë dhe përkushtimit ndaj Zotit. I këtillë është dhe tregimi mbi urdhrin për hz. Ibrahimin që të flijojë Ismailin, birin e tij, që është një nga tregimet më të veçanta në historinë e njerëzimit. Ibrahim i kishte dhënë një premtim Allahut të Madhëruar dhe, kur erdhi koha, iu kërkuar ta përmbushte këtë premtim. Si një i dërguar që mbante edhe titullin “*miku (i Zotit)*”, ai ndjeu peshën e këtij premtimi në zemrën e tij dhe si





dëshmi e përkushtimit ndaj Krijuesit të tij, pranoi ta flijojë qenien më të dashur për të - djalin e tij. Kjo sjellje është një shprehje e epitetit të tij “*Halilullah*” (miku i singërtë i Allahut).

RITUALI I KURBANIT

Fjala kurban rrjedh nga fjala “kurb”, që do të thotë *afrim, të jesh afër dhe afërsi*, dhe nënkupton “diçka që bëhet mjet për t’u afruar tek Allahu”. Ndërsa si term, nënkupton “therjen në mënyrë të rregullt të një kafshe që plotëson kushte të caktuara, në një kohë të caktuar, me qëllim adhurimi”.¹ Në Islam, rreth statusit të kurbanit janë dhënë sqarime të ndryshme që dalin nga Kurani famëlartë dhe Suneti i Pejgamberit a.s., dhe në këtë kuadër janë formuar dispozita të detajuara në fushën e fikhut. Kurban është gjithashtu një adhurim me karakter pasuror, që ndihmon në mbajtjen gjallë të vetëdijes për robërinë ndaj Allahut. Çdo therje kurban për besimtarët është një kujtim i sprovës që përjetuan hz. Ibrahim dhe djali i tij, përmes të cilit besimtarët duhet të marrin përvojë e mësim, se si duhet të jenë të vendosur në zbatimin e urdhrave të Zotit, dhe si duhet të jenë të qëndrueshëm në raste të sprovave të ndryshme, e si shembull është besimi dhe zbatimi i urdhrit të Ibrahimit a.s., si dhe durimi dhe respekti i Ismailit a.s.. Në lidhje me këtë ngjarje, në Kuran thuhet: “*Zoti im, më dhuro mua (një fëmijë) prej të mirëve! Ne e gëzuam atë me një djalë që do të jetë i butë (i sjellshëm). Dhe kur arriti ai (djali), që së*

Në urdhrin për ta flijuar të birin, përveçse synohej të provohej dorëzimi, durimi dhe sinqeriteti i hz. Ibrahimit dhe i të birit, qëllimi ishte edhe zhdukja e zakonisht të flijimit të njerëzve, që ishte i përhapur në atë kohë.

bashku me të (me Ibrahimin) të angazhohet në punë, ai (Ibrahimi) tha: “O djali im, unë kam parë (jam urdhëruar) në ëndërr të të pres ty. Shiko pra, çka mendon ti?” Ai tha: “O babai im, punojë atë që urdhërohesh, e ti do të më gjesh mua, nëse do Allahu, prej të durueshmëve!” E kur ata të dy iu dorëzuan urdhrit të Zotit dhe e përmbysi atë në fytyrë (në ballë). Ne e thirrëm atë: “O Ibrahim! Ti tashmë e zbatove ëndrrën! Ne kështu i shpërblejmë të mirët! Vërtet, kjo ishte provë e qartë.” Ne e shpaguam atë me një të therur (kurban) të rëndësishëm. Dhe ndaj tij Ne lamë përkujtim të mirë ndër popujt e ardhshëm. Selam (shpëtim e paqe) pastë Ibrahim! Kështu, në këtë mënyrë Ne i shpërblejmë bamirësit.” (Es Safat, 100-110). Në interpretimin e këtyre ajeteve thuhet se Zoti i Madhërishëm ia bëri të qartë hz. Ibrahimit për fëmijën që do t’i lindte e që do të dallohej me tri veçori: do të ishte djalë, do të arrinte moshën për të qenë i vetëdijshëm në sjellje dhe do të ishte i dëgjueshëm. Kur Ismaili u rrit që t’i bashkohet në punë babait të vet, Ibrahim a.s. u frymëzua prej Zotit, se duhej ta therte atë. Ai përveç që i tregoi ëndrrën, kërkoi edhe mendimin e djalit, ashtu që puna t’i vijë më lehtë. Ismaili, një djalë i dëgjueshëm dhe i përkushtuar, i tha babait të tij Ibrahimit: “O babai im, zbato urdhrin e Zotit! Nëse do Allahu, do të jem i durueshëm.” Pastaj Zoti i Madhërishëm i tregoi hz. Ibrahimit a.s. se ai e kishte përmbushur ëndrrën, dhe atëherë i ati dhe i biri përjetuan një gëzim të madh. E kaluan me sukses këtë provë të vështirë dhe Allahu u dërgoi një kurban të madh si zëvendësim.² Andaj Ibrahim, i dashuri i Zotit, mbeti përkujtim i dalluar ndër të gjithë njerëzit që të gjithë e nderojnë, e lavdërojnë dhe i shprehin mirënjohje.

ASPEKTI SIMBOLIK I FLIJIMIT

Një nga çështjet që trajtohet në tregimet e Kuranit dhe që ka rëndësi të veçantë sidomos për lexuesin modern, është dimensionin moral i tregimit të kurbanit, pra pse Zoti i Madhërishëm dëshironte ta sprovonte Ibrahim a.s. përmes flijimit të fëmijës. Në këtë kontekst, në komentimin e ajetit: “*Ne e shpaguam atë me një të therur (kurban) të rëndësishëm*” (Safat, 107), theksohet se, si ndjenjë e natyrshme njerëzore, edhe Ibrahim e donte shumë të birin, Ismailin. Për këtë arsye, Allahu e

urdhëroi ta flijonte atë, me qëllim që zemra e Ibrahimit të pastrohej nga çdo dashuri tjetër përveç dashurisë për Zotin e Madhërishëm. Dhe si rezultat i gatishmërisë së hz. Ibrahimit a.s. për ta flijuar të birin, Allahu ia solli kënaqësinë e Tij dhe e pengoi flijimin e Ismailit.³ Kjo njëkohësisht e bën të qartë faktin se sprovat ekzistojnë për të treguar se ajo që zotërojmë si fuqi, durim, vullnet, besim apo nënshtrim është në të vërtetë më e madhe se sa që mendojmë, dhe në këtë mënyrë na ndihmojnë të zbulojmë kapacitetin tonë të vërtetë. Veçanërisht ndaj sprovave hyjnore, ku nuk duhet të reagojmë me arsyetim, por me një besim të fortë dhe vendosmëri të Krijuesi Fuqiplotë. Ashtu siç shihet në sprovën e Ibrahimit me flijimin e të birit, besimi paraqitet si një përpjekje dhe nismë e thellë që e ngre njeriun mbi atë që është universale, përtej fushës së arsyes dhe etikës. Në këtë kuptim, formimi i besimit shoqërohet pashmangshëm me përjetimin e një dileme, dhimbjeje dhe përvoje sakrifice, ashtu siç e përjetoi Ibrahim a.s.. Pikërisht ky është kuptimi dhe qëllimi i sprovës: të heqësh dorë nga çdo gjë kalimtare për të arritur atë që është e përjetshme.

Taberiu në komentimin e ajetit kuranor: “O babai im, punoje atë që urdhërohes, e ti do të më gjesh mua, nëse do Allahu, prej të durueshmëve!”, thekson se përgjigjja që mori nga i biri, ishte përgjigjja që Ibrahim a.s. kishte shpresuar. Ishte një përgjigje aq e mbushur me dorëzim dhe pjekuri, sa i përshtatej vetëm gojës së një fëmije që ishte i destinuar të bëhej i dërguar në të ardhmen. Por edhe hz. Ibrahim a.s., përveç që ishte i dërguar i Zotit, në të njëjtën kohë, ai ishte edhe një baba i mëshirshëm, zemra e të cilit rrihte nga dashuria për të birin. Babai, duke i mbajtur dorën të birit, nisi të ecte drejt vendit ku do të përmbushte urdhrin hyjnor. Kurse shejtani, duke e parë këtë skenë nga larg, pa një mundësi të artë. A mund të kishte një rast më të përshtatshëm për ta larguar një baba, një fëmijë apo një nënë nga bindja ndaj urdhrit të Allahut? Por hz. Ibrahim, me largpamësinë e një të dërguari e kuptoi menjëherë çfarë po ndodhte. I hodhi shejtanit shtatë gurë. Por ai nuk hoqi dorë, fliste për ta penguar, përpiquej t'i priste rrugën. Pas pak u shfaq sërish përpara tyre. Por hz. Ibrahim nuk i dha hapësirë, i hodhi edhe shtatë gurë të tjerë. Dhe më pas, kur shejtani nuk tregoi asnjë shenjë tërheqjeje, i hodhi edhe shtatë gurë të fundit. Edhe sot, gjuajtja e shejtanit nga ana e haxhilerëve dhe vendet e njohura si “xhemrë” janë një ripërjetim i kësaj ngjarjeje historike.⁴ Ajo që e bën flijimin e Ibrahimit të çmuar, nuk është akti i mbajtjes së mjetit për të flijuar të birin, por pikërisht dilema që ai përjetoi gjatë atij udhëtimi dhe besimi i lartë e nënshtrimi i thellë që arriti si rezultat i saj. Sipas këtij këndvështrimi, sprovat janë mundësi që, përmes heqjes dorë, na japin mundësinë të shfaqim vetveten. Prandaj ato janë çështje të besimit, jo të arsyes apo të etikës; për këtë arsye,



është e pashmangshme që të bien ndesh me normat e arsyes dhe të moralit, madje edhe të i sfidojnë ato.

Në urdhrin për ta flijuar të birin, përveçse synohej të provohej dorëzimi, durimi dhe sinqeriteti i hz. Ibrahimit dhe i të birit, qëllimi ishte edhe zhdukja e zakonit të flijimit të njerëzve, që ishte i përhapur në atë kohë. Allahu i Lartësuar, përmes kësaj sprove të madhe, e rrëzoi plotësisht mitin e flijimit të fëmijëve, një praktikë e trilluar nga njeriu në rrjedhën e historisë, si pasojë e largimit nga udhëzimi hyjnor. Kjo ngjarje nuk kishte për qëllim vetëm arritjen e kënaqësisë së Zotit, por edhe vendosjen e hz. Ibrahimit si një model shembullor për brezat që do të vinin më pas. Ai do të përmendej gjithmonë me paqe dhe dashuri, ndërsa plotësia e besimit të tij do të mbetej një pikë referimi për të gjithë besimtarët. Megjithatë, tek Ibrahim mbeti gjithmonë e njëjta përlulesi dhe e njëjta lutje e sinqertë: “O Zoti im! Më bëj mua nga ata që falin namazin, e edhe prej pasardhësve të mi dhe pranoje lutjen time, o Zoti ynë! Zoti ynë! Më fal (gabimet) mua dhe prindërve të mi, fali edhe të gjithë besimtarët ditën kur jepet llogaria.” (Ibrahim, 40-41).

1 El Ferahidi, *Kitabu'l-Ajn*, V/152.

2 Razi, *Mefatihul-Gajb*, XXIV/154; Ibën Kethiri, *Kisasul-Enbija*, I/110.

3 Tusteri, *Tefsirul-Kurani'l-Adhim*, 229.

4 Taberi, *Xhamiu'l-Bejan*, XXI/81.

Bajrami që bie në ditën e premte (e xhuma)

Myfti Ibrahim Desai el Hanefi

Sipas hanefive, shafive dhe malikive, nëse Bajrami bie në ditën e xhuma, atëherë namazi dhe hytbeja e Bajramit nuk mjaftojnë edhe për xhumanë. Juristët kanë lëshuar fetva se këto janë dy urdhra të ndryshëm dhe nuk mund të kombinohen në asnjë rrethanë.¹

Sipas hanbelive, konkretisht po përmendim mendimin e Imam Ahmedit, r.h., i cili thotë se namazi i Bajramit mjafton edhe për xhumanë, që këtej, pas namazit të Bajramit, namazi tjetër që myslimani duhet ta falë në ditën e xhuma, është namazi i ikindisë.² Hadithet që janë përmendur nga Imami në fjalë janë po të njëjtat që hanbelitë i përdorin për ta mbështetur mendimin e medhhebit të vet. Përpara se të përgjigjemi rreth këtyre haditheve, ne duhet t'i kuptojmë disa gjëra që kanë shumë rëndësi.

Ekzistojnë katër burime autentike në fe, prej të cilave meseletë (rregullat e normat)

duhet të vendosen. Këto janë: Kurani, hadithi, ixhmai (konsensusi) dhe kijasi (analogjia). Përderisa një mesele vendoset përmes njëres nga këto burime, ajo konsiderohet pjesë e fesë. Kurani dhe hadithi përmbajnë ligje udhëzuese dhe fundamentale, prej të cilave juristët ekspertë nxjerrin dhe përftojnë mesele të ndryshme. Prandaj, nuk është punë për personin e zakonshëm që t'i "shikojë" ajetet kuranore dhe hadithet, dhe vetë të vijë te konkluzioni. Kjo punë u takon ekspertëve. Katër imamët e mëdhenj kishin njohuri të shumta për çdo fushë të fesë, gjë e cila i kualifikoi të nxirrnin mesele të ndryshme pas një studimi dhe kërkimi të thellë në Kuran dhe hadith. Kështu që, është vaxhib dhe e domosdoshme për ne që t'i pasojmë ata që ta kuptojmë fenë. Ngjashëm, një person nuk lejohet që t'i pasojë dëshirat e tij duke e pasuar nganjëherë një imam dhe nganjëherë një

Sipas hanefive, shafive dhe malikive, nëse Bajrami bie në ditën e xhuma, atëherë namazi dhe hytbeja e Bajramit nuk mjaftojnë edhe për xhumanë.



imam tjetër. Është vaxhib që ta pasojmë një imam (pra, medhhebin e tij) për të gjitha verdiktet.

Tani që e kuptuam të lartpërmendurën, subjekti jonë është se “a mjafton namazi i Bajramit për xhumanë”? Ne duhet të kuptojmë atë se obligueshmëria e xhumasë në mënyrë eksplicite është e përmendur dhe e vendosur nga vetë Kurani, e Kurani është dëshmia më e fuqishme nga të gjitha. Ai që e mohon ndonjë ajet të Kuranit llogaritet kafir (jobesimtar). Në anën tjetër, obligueshmëria e namazit të Bajramit është e provuar dhe e vendosur përmes hadithit. Duke pasur këtë parasysh, edhe një person me të kuptuar të paktë madje do të jetë në gjendje të vijë te ky konkluzion i thjeshtë se si mundet diçka që është e provuar nga hadithi të ketë kaq shumë fuqi të pezullojë totalisht diçka që në mënyrë të qartë dhe eksplicite provohet nga Kurani? Si ka mundësi që namazi i Bajramit ta abrogojë obligueshmërinë e xhumasë?!

Gjithsesi, ekzistojnë disa hadithe (të përmendura nga Imam Ahmedi, r.h.), të cilat nga shikimi i jashtëm tregojnë se lejohet lënia e xhumasë nëse Bajrami bie të premten. Këto hadithe kanë variacione të lehta, por kanë esencë të ngjashme. Një shembull, për ta kuptuar këtë mesele në mënyrë të duhur, le ta shikojmë këtë transmetim: Ebu Hurejre r.a., transmeton se (të premten, ditën e Bajramit), Pejgamberi, a.s., iu drejtua të gjithë sahabëve të tij duke iu thënë: “Sot janë bashkuar dy festa (Bajrami dhe xhumaja). Secili që dëshiron nga ju, atëherë, ky namaz (i Bajramit) do t’i mjaftojë për xhumanë. Ne, së shpejti, do të tubohemi sërisht, inshallah!”³

Së pari, muhadithinët (ekspertët e hadithit) kanë përmendur se autenciteti i këtyre transmetimeve është i diskutueshëm. Megjithatë, edhe nëse ne do ta prananim autencitetin e këtyre transmetimeve, atëherë përgjigjja tjetër është se gjatë kohës së Pejgamberit a.s., myslimanë nga vende jashtë Medinës, që jetonin në fshatra e katunde, vinin në Medine për ta falur namazin e Bajramit. Këtu theksojmë se sikurse që namazi i Bajramit nuk është vaxhib (i domosdoshëm) për njerëzit që jetojnë jashtë qytetit, pra në fshatra e katunde, etj., (kuptohet që nuk kanë xhami e kushte për xhuma – shën. i përkth.), ngjashëm edhe xhumaja nuk është vaxhib për ta.⁴

Këta beduinë dhe të ngjashmit me ta vinin në Medine nga dëshira e tyre, prej gëzimit e lumturisë, ngaqë ishte Bajram. Namazi i Bajramit, siç e dimë, falet pak pas lindjes së diellit në mëngjes. Për këtë arsye, për këta njerëz – myslimanë, ishte vështirë që të rrinin në qytet pas namazit të Bajramit dhe ta prisnin xhumanë. Kjo është mu ajo gjë që në këto transmetime i referohet. Nëse i shikojmë të gjitha këto transmetime, me variacione të lehta, një transmetim tjetër thotë se Pejgamberi

“Secili nga fshatarët që dëshiron të rrijë për xhuma, mund të rrijë, dhe secili që dëshiron të kthehet, unë i kam dhënë leje.”

Uthmani r.a

a.s., tha: “Secili që dëshiron mund ta falë xhumanë dhe secili që dëshiron të kthehet, mund të kthehet.” Pejgamberi a.s., iu adresua beduinëve e fshatarëve në këtë rast, ngaqë për ta ishte gjatë e vështirë të prisnin deri në namazin e xhumasë. Meqë xhumaja nuk ishte vaxhib për ta, Pejgamberi a.s., u tha se nëse dëshironin të ktheheshin në vendet e tyre, mund ta bënin. Dëshmia se ky ligj vlente vetëm për beduinët është transmetimi i Ebu Hurejres r.a., që e përmendëm më lart, pra kur Pejgamberi, a.s., tha: “Së shpejti do të tubohemi përsëri, inshallah!”, d.m.th. Pejgamberi a.s., iu adresua njerëzve (banorëve) të Medinës që së shpejti do të tubohemi për namazin e xhumasë. Për këtë arsye, përgjigjja standarde ndaj këtyre transmetimeve është ajo se Pejgamberi a.s. dha leje që të mos falet xhumaja nëse Bajrami bie në

ditën e premte, por kjo leje ishte vetëm për beduinët e fshatarët, nga shkak se për ta nuk ishte fare vaxhib xhumaja pikësepari. Për ta provuar më tej këtë gjë, le ta shikojmë një transmetim tjetër. Uthmani r.a., kur ishte kalif iu drejtua njëherë xhematit pas namazit të Bajramit që kishte rënë ditën e premte. Ai u tha: “Secili nga fshatarët që dëshiron të rrijë për xhuma, mund të rrijë, dhe secili që dëshiron të kthehet (në vendin e tij), atëherë unë i kam dhënë leje.”⁵

Shikojmë në këtë transmetim! Është e qartë si drita e diellit se kjo leje ishte vetëm për fshatarët. Më tej, në këtë transmetim, Uthmani r.a., e bëri këtë deklaratë përpara një mase të madhe sahabësh r.a.. Nëse kjo leje do të ishte e përgjithshme dhe përfshinte edhe banorët e qytetit (Medinës), atëherë sahabët r.a., do ta kundërshtonin Uthmanin r.a., për deklaratën e tij, se pse u dha leje të veçantë vetëm beduinëve e jo edhe banorëve të qytetit. Duke pasur parasysh të lartshënuarën, si dhe shkurtazi, ne themi se nëse ne i pranojmë këto transmetime si autentike, atëherë gjithashtu duhet ta pranojmë se leja për mos faljen e namazit të xhumasë dhe mjaftimi vetëm me namazin e Bajramit, ishte vetëm për beduinët dhe fshatarët, thjesht ngaqë xhumaja për ta nuk ishte vaxhib.

E Allahu i Gjithëdijshtëm e di më së miri!

*Fetva e kontrolluar dhe e pranuar nga myfti Ebrahim Desai el Hanefi,
Allahu i Madhërishtëm e mëshiroftë!*

Shqipëroi: Daim Abazi

1 Shih I’lau’s Sunen, vol. 8, f. 92.

2 Tahtaviu, f. 288.

3 Ibni Maxhe, f. 93.

4 Tahtaviu, f. 288.

5 Muvetta, f. 165.

Miliona ndjenja, një zemër – rrugëtimi im në tokën e shenjtë

Mihana Goga

Nuk e kisha imagjinuar kurrë se një ditë do të isha mes atyre miliona besimtarëve që me lot në sy ia mësyjnë rrugës për vizitë shtëpisë së Zotit – Qabesë. Sa herë që familjarët e mi flisnin për haxhin, rrëfimi i tyre mbetej përgjysmë – përplot mallëngjim. Kujtoja se kjo ëndërr e përjetshme kishte zanafillën tek Ibrahim i a.s., kur arriti në atë vend të zbrazët dhe iu lut Zotit: “O Zoti ynë..., bëj që zemrat e njerëzve të mallëngjehen për ta!” (Ibrahim, 37).

Aty fillova të kërkoj, të lexoj dhe ta kuptoj se haxhi nuk është thjesht një udhëtim trupor, është një thirrje e zemrës, një përgjigje e shpirtit. Jo mosha, por zemra është ajo që ftohet, dhe kur ajo dëshiron sinqerisht, Zoti hap rrugët në mënyrat më të pabesueshme.

Zoti xh.sh. e bëri obligim vizitën e Qabesë, shtëpisë së shenjtë, dhe e vendosi atë si një nga pesë shtyllat e Islamit. Në shumë ajete të Kuranit na rikujton: “Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo.” (Ali Imran, 97).

Qëndrimi në Mekë të jep një ndjenjë sigurie të papërshkueshme, një qetësi që nuk e gjen askund tjetër. Kujtoja Ibrahimin a.s., i cili u lut:

“O Zoti im, bëje këtë qytet të sigurt!”

(El Bekare, 126).





Jeta është e përbërë nga momente të vogla, por disa prej tyre mbeten të pashlyeshme. Një nga këto ishte dita e 29 dhjetorit 2023, kur mora vesh se isha e përzgjedhur nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës që të rrugëtojë bashkë me karvanin e haxhilerëve drejt Shtëpisë së Zotit e vendeve të shenjta. Në ato çaste ku ëndrrat bëhen realitet, syri loton dhe zemra e goja thonë njëzëri: “Faleminderit, o Zot!” Përgatitjet nisën gjashtë muaj më parë – shpirtërore dhe fizike – teksa numëroja ditët me emocion dhe entuziazëm që vetëm rritej.

Erdhi çasti i shumëpritur – udhëtimi drejt tokës së bekuar, vendi i profetëve. Udhëtimi me aeroplan ishte i qetë, por më shumë më preku momenti kur bëmë nijetin për umre. Pastaj filluam me *“Lebbejke Allahume lebbejk. Lebbejke la sherike leke lebbejk. Innel hamde ven-ni’mete, leke vel mulk, la sherike lek”*. “Të përgjigjem Ty, o Zot! Të përgjigjem Ty që nuk ke shok në sundim! Falënderimi, të mirat dhe sundimi të takojnë vetëm Ty, i pashoq je o Zot!” një thirrje që ushqen shpirtin dhe e mbush zemrën me dritë sa herë që përsëritet.

Qëndrimi në Mekë të jep një ndjenjë sigurie të papërshtueshme, një qetësi që nuk e gjen askund tjetër. Kujtoja Ibrahimin a.s., i cili u lut: *“O Zoti im, bëje këtë qytet të sigurt!”* (El Bekare, 126). E dija që po afrohesha, po ecja drejt Qabesë. Kur e pashë për herë të parë, ndjeva një mall të thellë, një përlulje që të pushton gjithë qenien. Të qëndroja para saj, drejt së cilës jemi kthyer gjithë jetën në namaz, ishte një përjetim i papërshtueshëm. Duke u falur, ndjeja Zotin afër – thellë, brenda shpirtit tim.

Tavafi dhe saji nuk ishin vetëm rituale, ishin udhëtime të brendshme, hapja drejt vetes sime. Çdo hap rreth Qabesë më

jepte paqe, më largonte shqetësimet, më mbushte me dritë dhe shpresë.

“Mysafirët e Zotit”, kështu na quajti Profeti Muhamed a.s.. Ai tha: “Nëse luten, Zoti u përgjigjet; nëse kërkojnë, Ai ua jep; dhe nëse kërkojnë falje, Ai ua fal.” Këto fjalë më shoqëronin çdo ditë.

Pastaj erdhi dita e Arafatit – zemra e haxhit. Të qëndrosh në mesin e mijëra haxhilerëve, të gjithë njësoj, të përlulur, me duar të ngritura drejt qiellit ishte si një pasqyrim i Ditës së Gjykimit. Ndjeva se haxhi nuk është thjesht një udhëtim fizik, por një rrugëtim i thellë shpirtëror, një rikthim te vetja, një dorëzim i plotë ndaj Krijuesit, një ditë pendese, lutjeje, qartësie.

Ka vende që i arrin me këmbë, por Medina është ndryshe, atje shkon me shpirt. Aty prehet i Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s., ai që e ndriçoi njerëzimin me dritën e shpalljes, me mëshirën e karakterit dhe me forcën e shembullit të tij. Të qëndroja para varrit të tij, ishte kulmi i përvojës sime. Ai na mësoi të duam Zotin, të përballojmë sprovat, të falim, të lutemi, të jetojmë me dinjitet dhe të vdesim me shpresë.

Ky udhëtim nuk ishte thjesht një rrugë fizike drejt një vendi të shenjtë, ishte një kthim drejt vetes, një lidhje e fortë me Zotin dhe një ri zgjim i shpirtit. Çdo hap, çdo lutje, çdo lot i derdhur përpara Qabesë dhe në Arafat, më kujtoi se përvoja e haxhit nuk përmbyllet me kthimin në shtëpi, ajo vazhdon në çdo ditë të jetës, në çdo lutje që bëjmë, në çdo vepër të mirë që zgjedhim të bëjmë. Tashmë e di se haxhi nuk është vetëm një kujtim i bukur, por një përgjegjësi e re shpirtërore, një dritë që duhet mbajtur gjallë, sepse zemra që ka prekur Qabenë nuk mund të jetë më kurrë e njëjtë.

Kurbani – normat dhe synimet e tij fisnike në Islam

Enes Koshi

Kurbani përbën një nga aktet më të rëndësishme të adhurimit në fenë islame, i cili është i lidhur ngushtë me ndjenjat e devotshmërisë, sakrificës dhe përkushtimit ndaj Allahut. Ai rrjedh nga një traditë e lashtë profetike, që kulmon me ngjarjen madhështore të Profetit Ibrahim a.s., i cili pranoi të sakrifikonte të birin si shenjë e bindjes së plotë ndaj urdhrit hyjnor. Ky akt simbolik është bërë një shembull i përjetshëm i nënshtrimit dhe besimit të palëkundur në vullnetin e Zotit. Në këtë trajtesë do të shqyrtojmë shkurtimisht rregullat e kurbanit në Islam, dispozitat që lidhen me të dhe synimet e tij fisnike.

PËRKUFIZIMI I KURBANIT

Fjala *kurban* nënkupton therjen e një kafshe të caktuar nga bagëtitë, si: dele, dhi, lopë ose deve, gjatë ditëve të Kurban Bajramit, me qëllim afrimi tek Allahu i Lartësuar. Ky veprim bazohet në argumente të qarta nga Kurani, Suneti dhe konsensusi i dijetarëve.

Disa ajete që e mbështesin këtë praktikë: “*Andaj ti falu dhe ther kurban për hir të Zotit tënd.*” (El Keuther, 2); “*Thuaj: Vërtet, namazi im, kurban im, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm Allahun, Zotin e botëve.*” (El En’am, 162); “*Devetë dhe gjedhët i kemi bërë për ju si një nga ritet e Allahut për flijim, dhe ju përfitoni prej tyre. Prandaj, përmendeni emrin e Allahut mbi to, kur t’i radhisni në këmbë për*

“Andaj ti falu dhe ther kurban për hir të Zotit tënd.” (El Keuther, 2)





therje. Pasi të bien në tokë (të therura), hani prej (mishit të) tyre dhe ushqeni edhe atë që lyp, edhe atë që nuk lyp. Kështu Ne i kemi vënë ato në shërbimin tuaj, që ju të tregoheni mirënjohës.” (El Haxh, 36).

Disa hadithe mbi kurbanin: “Pejgamberi a.s. ka therur me dorën e tij dy desh të bardhë me brirë, Ai tha ‘Bismilah’ dhe mori tek bir, duke e vendosur këmbën mbi anën e tyre gjatë therjes.”¹ “Njeriu nuk bën ndonjë vepër më të dashur për Allahun në ditën e kurbanit sesa derdhja e gjakut (të kurbanit). Vërtet, ajo (kafsha e therur) do të vijë në Ditën e Kiametit me brirët, leshin dhe thundrat e saj. Dhe me të vërtetë, gjaku i saj arrin një vend të lartë tek Allahu para se të bjerë në tokë. Prandaj, bëjeni kurbanin me zemër të kënaqur.”² Kur shokët e të Dërguarit të Allahut a.s., e pyetën: “O i Dërguari i Allahut, çfarë janë këto kurbane?”, ai u përgjigj: “Janë tradita e babait tuaj, Ibrahimit.” Ata thanë: “Çfarë përfitojmë ne prej tyre?” Pejgamberi a.s., iu tha: “Për çdo qime (të kafshës së kurbanit), ju fitoni nga një të mirë.” Ata e pyetën: “Edhe për qimet, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: “Po, për çdo qime të leshit – nga një të mirë.”³

Dijetarët myslimanë janë pajtuar unanimisht (ixhma) se therja e kurbanit gjatë ditëve të Kurban Bajramit është një veprim i ligjësuar në Islam dhe përbën një nga ritet madhështore të kësaj feje.⁴

DISPOZITA E KURBANIT

Sipas medhehebit hanefi, kurbanin është *vaxhib* (i detyrueshëm) për çdo mysliman të lirë, të rritur, me shëndet të plotë mendor, që është banor vendas (mukim) dhe zotëron pasuri të mjaftueshme që arrin vlerën e nisabit (njësor si për zekatin). Sa i përket therjes së kurbanit për të vdekurin, ajo nuk është e detyrueshme, përveç nëse i ndjeri e ka lënë amanet para vdekjes. Në një rast të tillë, përmbushja e këtij amaneti bëhet e domosdoshme.⁵

KUSHTET E KURBANIT

Kurbani duhet të jetë nga kafshët shtëpiake: deve, lopë ose dele.

Kafsha duhet të jetë e shëndoshë dhe pa të meta të dukshme. Nuk lejohet të jetë e verbër, e sëmurë rëndë, e çalë apo jashtëzakonisht e dobët.

Duhet të ketë arritur moshën e përcaktuar nga Sheriati: deveja - pesë vjeç, lopa - dy vjeç, delet - një vjeç. Përgjithësisht, lejohet therja e një qengji gjashtëmuajsh, nëse është aq i zhvilluar sa nga pamja i ngjan një deleje njëvjeçare.

Therja e kurbanit duhet të bëhet brenda kohës së caktuar fetarisht: nga përfundimi i namazit të Kurban Bajramit (më 10 dhulhixhe), e deri në përfundimin e diellit të ditës së 13 dhulhixhe.⁶

RREGULLAT E THERJES

Sipas Sheriatit, këto janë kushtet që kërkohen për therje:

Kafsha duhet të theret me një mjet të mprehtë, në mënyrë që gjaku të rrjedhë nga damarët e saj.

Duhet të prehet gryka ose të shpohet zgavra e saj. Mënyra më e plotë e therjes është prerja e kanalit të frymëmarrjes, ezofagut (gabzherri) dhe dy damarëve kryesorë të qafës.

Gjatë therjes, duhet të përmendet emri i Allahut, duke thënë “*Bismilahi, Allahu ekber*”.⁷

SHPËRNDARJA E MISHIT TË KURBANIT

Sipas medhehebit hanefi, është e pëlqyeshme (*mustehab*) që mishi i kurbanit të ndahet në tri pjesë:

Një pjesë për vetën dhe familjen – për konsum personal.

Një pjesë për të afërmit dhe miqtë – si shenjë solidariteti dhe afrimiteti.

Një pjesë për të varfrit dhe nevojtarët – si akt bamirësie dhe ndihme.⁸

SYNIMET DHE URTËSITË FISNIKE TË KURBANIT

Kurbani nuk është vetëm një akt i jashtëm, por përmban një sërë synimesh dhe urtësish që e bëjnë atë një nga format më domethënëse të adhurimit në Islam. Ja disa prej tyre:

PËRKUSHTIMI DHE BINDJA NDAJ ZOTIT

Prerja e kurbanit është një shprehje e përkushtimit dhe bindjes ndaj Allahut. Ajo tregon se besimtari është i përgatitur të zbatojë urdhrat e Zotit, edhe nëse është në pyetje pasuria dhe jeta e tij, ashtu siç bëri Profeti Ibrahim a.s., i cili ishte i gatshëm të sakrifikonte më të dashurin e tij për Allahun. Ky është kulmi i përkushtimit. Allahu i Madhërishëm në Kuran thotë: *“Thuaj: Vërtet, namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve.”* (El En’am, 162).

ARRITJA E DEVOTSHMËRISË – TAKVAJA

Qëllimin i vërtetë i kurbanit na tregohet qartë nga Zoti në Kuran, kur thotë: *“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre (kurbaneve), por arrin përkushtimi juaj...”* (El Haxh, 37). Ky ajet madhështor i drejtohet besimtarëve për t’u bërë të qartë se Allahu nuk ka nevojë për asgjë materiale nga krijesat e Tij. Thërja e kurbanit, e shoqëruar me derdhjen e gjakut dhe ndarjen e mishit, është një akt simbolik. Megjithatë, ajo që ka vlerë tek Allahu është qëllimi i pastër i besimtarit (nijeti) dhe devotshmëria.⁹ Zoti nuk pranon nga robërit e Tij veprat që nuk bëhen me sinqeritet dhe për hir të Tij.¹⁰

MBËSHTETJA PËR TË VARFRIT

Një nga qëllimet kryesore të therjes së kurbanit është ndarja e të mirave materiale me të tjerët, veçanërisht me shtresat që janë në nevojë. Kjo shpërndarje nuk është vetëm një akt bujarie, por një pjesë përbërëse e adhurimit dhe shprehje e solidaritetit islam. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: *“...hani nga ato (kurbanet) dhe ushqeni nevojtarin e varfër.”* (El Haxh, 28).

PASTRIM I SHPIRTIT NGA EGOIZMI

Në të vërtetë, kurbanit është një ritual që na mëson të ndajmë, të dorëzohemi dhe të pastrohemi nga egoizmi, duke jetuar me më shumë dashuri për Allahun dhe për njerëzit. Me sakrifikimin e diçkaje me vlerë, njeriu mëson të largohet nga lakmia dhe materializmi.

FORCIMI I LIDHJEVE FAMILJARE DHE SHOQËRORE

Një prej synimeve dhe urtësive të kurbanit është forcimi i lidhjeve familjare, farestnove dhe shoqërore. Shpërndarja e mishit i gëzon dhe i afron njerëzit. Fëmijët, prindërit, gjyshërit dhe fqinjët përjetojnë së bashku atmosferën e sakrificës dhe falënderimit.

PËRKUJTIM I SAKRIFICËS DHE DURIMIT

Kurbani na kujton se besimi kërkon durim dhe sakrificë në jetë për hir të Zotit. Sa herë që besimtari kujton sakrificën dhe durimin e Profetit Ibrahim dhe Profetit Ismail a.s., kjo e nxit të ketë mendim të mirë për Allahun dhe ta kuptojë se durimi është shkak për dhunti dhe largimin e fatkeqësive.

PËRMBYLLJE

Kurbani është më shumë se një veprim i jashtëm adhurimi, ai është një shprehje e fortë e nënshtrimit ndaj Allahut, e mirënjohjes për begatitë që na janë dhënë dhe një thirrje për të qenë më të mëshirshëm, më bujarë dhe më afër njëri-tjetrit. Normat që rregullojnë kurbanin e bëjnë atë një adhurim të qartë dhe të drejtë, ndërsa synimet e tij fisnike e ngjisin në një shkallë më të lartë morale e shpirtërore. Përmes kurbanit, mësojmë se feja islame nuk është një ritual i thjeshtë, por edukim i zemrës dhe ndërtim i shoqërisë, përmes vlerash të qëndrueshme, si: sakrificë, solidariteti, falja dhe dashuria për Zotin dhe krijesat e Tij.

Sot, më shumë se kurrë, kur njerëzit po përballen me vetmi shpirtërore dhe ndarje shoqërore, mesazhi i kurbanit na kujton nevojën për lidhje të sinqerta me Zotin dhe me njëri-tjetrin. Le të jetë kurbanit një mundësi për të pastruar zemrat, për të afruar njerëzit dhe për të forcuar lidhjet e familjes, shoqërisë dhe të kombit tonë. Amin!

“...hani nga ato
(kurbanet)
dhe ushqeni
nevojtarin e
varfër.”

(El Haxh, 28)

1 Transmetojnë Buhariu me numër 5565 dhe Muslimi me numër 1966.

2 Transmeton Tirmidhiu në Sunenin e tij, në kapitullin e kurbanit, hadithin nr. 1493.

3 Transmeton Ibën Maxheh me numër 3127.

4 En-Neveviu, El Mexhmu’ (Bejrut: Dar al Fikr, n.d). Ibën Kudamah, El Mugni (Kajro: Maktabat al Kahira, n.d).

5 Muhamed ibën Ahmed al Sarakhsi, El Mabsut, vol. 12 (Bejrut: Dar al Ma’rifah, n.d), 11.

6 Burhan el Din el Marghinani, El Hidaje, vol. 4 (Bejrut: Dar al Kutub al Ilmiyyah, n.d), 357.

7 Jusuf el Karadawi, Hallalli dhe harami në Islam, përkthyes: Muhamed Mustafa (Shkup: Logos-A, 1988).

8 Imam el Kudur, Muhtasar el Kuduri (Medinë: Dar al Siraj, 2014), 419.

9 Fakhr el Din el Razi, Mefatih el Gayb (*Tesiri i madh*), në www.altafsir.com, qasur më 13 maj 2025.

10 Abd el Rahman el Sa’di, *Tefsiri i Sadiut*, komenti mbi suren El Haxh, ajeti 37, në Quran.com, qasur më 13 maj 2025. <https://quran.com/al-hajj37>.

Ndikimi i hytbes dhe i vazit si mediume të edukimit islam (2)

Muhamed Sytari

Hatibi duhet të jetë i sigurt në dijen e tij, i kujdesshëm dhe i matur në të, sepse ndikimi i fjalës së tij është i paimagj-nueshëm, sidomos kur pasohet në mënyrë kolektive.

Hytbeja e xhumasë duhet të mbledhë në të njëjtën kohë tri elemente të rëndësishme, garantuese të suksesit të saj: diturinë e saktë dhe të pastër, shpirtin e madh e të dëlirë dhe interpretimin korrekt dhe me mjeshtri.

DITURIA

Pa dyshim, elementi dituror, është ndër më kryesorët në përgatitjen dhe paraqitjen e një hytbeje xhumaje. Kjo do të thotë se hatibi duhet të dijë mirë dhe të ketë parasysh që në çdo hytbe, duhet t'i servirë xhematit të tij njohuri dhe dituri të re, për të cilën kanë nevojë në edukimin e tyre islam, para duarve të tij.

Mirëpo për të servirur dituri, pikësëpari ai duhet ta ketë atë, ta kërkojë në vazhdimësi, duke ndjekur thirrjen kuranore: “*Zoti im, më shto dituri!*” (Ta Ha, 114), ta kuptojë e të dijë ta interpretojë si duhet. Nuk mjafton të jesh i ditur, por edhe të dish se për çfarë shërben dituria me të cilën prezantohesh para të tjerëve.

Në këtë kontekst, tregohet se një herë, një njëri që hiqej si i ditur, u thoshte njerëzve se, kur të hyni në xhami, duhet patjetër të keni me vete nga një thikë. Njerëzit nisën të





vepronin sipas thënies së tij, pa e ditur shkakun, thjesht sepse ai ishte njeri që edhe lexonte dhe mbahej si i ditur në mesin e tyre.

Kur në atë vend kaloi një dijetar dhe pa çudinë e atij xhemi, pyeti dhe, kur i treguan për burimin e këtij veprimi, shkoi ta takonte urdhëruesin e kësaj shfaqjeje. Ai, duke i shpjeguar dijetarit për veprimin e tij, i tha: “Kam lexuar se i Dërguari i Allahut a.s., ka urdhëruar e ka thënë: “Kur të hyni në xhami mbani thika...”, duke përdorur fjalën “*sikkine*”, në gjuhën arabe.

I habitur, dijetari vuri buzën në gaz dhe ia ktheu: “Zotëri, i Dërguari i Allahut ka urdhëruar që: “Kur të hyni në xhami të mbani qetësi...”, duke përdorur fjalën “*sekine*”, jo “*sikkine*”. Ju keni ngatërruar vokalet e fjalës, asgjë më tepër!

Pra, hatibi duhet të jetë i sigurt në dijen e tij, i kujdesshëm dhe i matur në të, sepse ndikimi i fjalës së tij është i paimagjinueshëm, sidomos kur pasohet në mënyrë kolektive.

Hatibi duhet të jetë në koherencë me zhvillimet e ndryshme politike, kulturore, ekonomike, sociale e intelektuale të vendit të tij. Për asnjë arsye, ai nuk duhet ta neglizhojë marrjen e informacionit. Arsyeja është shumë e thjeshtë, hatibi duhet të jetë bashkëkohor, në marrëdhënie të ngushtë me zhvillimet e vazhdueshme në shoqërinë e tij.

Imagjinoni një hatib që në një moment kur vendi i tij është “uzurpuar” nga sistemi i fajdeve, nga korrupsioni, nga hemorragjia e emigrimit, nga degradimi i sistemit të drejtësisë, nga deformimi i konceptit të drejtimit dhe menaxhimit të pasurive kombëtare, nga shtimi i pasigurisë, nga prishja e ekuilibrave në trajtimin e njerëzve përballë ligjit, nga prishja e moralit, nga përhapja e drogës, imoralitetit, nga tendenca e

prishjes së ekuilibrave të harmonisë në shoqëri, etj.; ai t’iu flasë njerëzve për tematika të ngurta, që nuk kanë asnjë lidhje as me zgjimin e vetëdijes, as me ndërgjegjësimin, as me lutjen për të ndryshuar drejt më të mirës, as shfaqjes së vizioneve të fesë islame në drejtim të zgjidhjes së ngërceve dhe situatave të krijuara,

“Predikues (nasih) i vërtetë është ajo, i cili ká një dijeni të mjaftë, zotnon virtyte të mirë, është i përunjtë e fytyrë-qeshun; ká aftësinë e duhur me provue me argument mëndore e gojdhânore fjalët e vetëthانيت e tija... E krejt për kundra, nuk e meriton atë ëmën të bukur “predikues” ajo qi shpënzon frymen e tij më kot tue derdhë prej goje fjalë të shprazta (boshe) e tue përhapë mendime e idhëna të dobta e pá kurrfarë vlere, të huajtuna prej historís mythologjike”¹, shkruan H. Ismet Dibra.

Vendosni për pak në peshore mesazhin e hafëz Sheuqet Borçit në vitin 1940, në krahasim me shumë predikime të një niveli që lë për të dëshiruar, në ditët e sotme: “Feja e jonë kërkon punë prej nesh, kërkon që myslimani të jetë i shtrënjtë dhe hije-rëndë dhe jo parazit mbi të tjerët, i poshtër dhe i ofenduëm. Kushdo qi e len punën dhe mërzhitet për me punuë dhe me fituë shùjtën e tij, ai e ka humbë shpresën, kështu qi gjendja dhe fund ii tij është rrënim, humbje e zhdukje.”²

Një hatib i mirë duhet të njohë si duhet traditat e një populli ku shërben dhe ligjëron. Nuk duhet të injorojë baballarët e të shkuarit, në asnjë mënyrë! Me anë të dijes, urtësisë dhe kulturës së tij, ai duhet të përpiqet dita-ditës të rregullojë gabimet e të injektojë me sa të ketë mundësi frymën e duhur të besimit e të udhëzimit drejt Krijuesit, me butësi, durim dhe përpjekje.

“Nuk ka vlerë ajo kur ne besojmë në diçka e nuk dimë ç’është ajo, sepse virtyt është njohja e asaj që e besojmë. Ne besojmë në Islamin. Prandaj jemi të obliguar që ta njohim mirë atë.”³

Nga këtu them se, një hatib i formuar mirë, me nivel të lartë dituror e kulturor, me përvojë e urtësi që e karakterizon, largpamës e vizionar, mbetet përherë një edukator i vlefshëm, një udhëzues i urtë dhe mësues i dashur, që merr për dore bashkësinë, të cilës i shërben me përkushtim, drejt lartësimit në nivelet më të larta të shembullit islam në jetën e përditshme.

Dhe, siç na mësojnë më të diturit e shkuar: “Poh, nuk ká dyshim se për m’u zhvilluem në mëndie, për m’u pajuem me dijtuní e për m’u gdhenë mà së fundi në shpirtë, duhet me domosdo qi të ndihmohemi prej mà të dijshtëmvet. Ç’do sëmundje në kët botë ka nevojë për m’u mjekuem. Kështu dhe mjekët e sëmundjevet morale e shoqnore janë ylemât, qi përpqen me përmirësue moralin e popullit dhe më ngritë këtë shpirtnisht në një shkallë t’epër.”⁴

SHPIRTI

Hatibi, sikurse e theksova edhe më sipër, duhet të ketë një praktikë të përditshme dhikri, e cila është elementi kryesor në forcimin e personalitetit dhe ndjesive të tij shpirtërore. Një hytbe pa shpirt, është si një kasetë magnetofoni që flet në një dhomë të zbrazur a të mbushur me njerëz të shurdhër. Që do të se një hatib që mban një hytbe, rutinë, nuk duhet të presë reagime pozitive e ndikime esenciale në zemrën e dëgjuesit a sjelljen e tij.

Hatibi duhet të bashkojë në hytben e tij ndjeshmërinë personale të fituar, me atë të tekstit të dëshmuar, për t’i dhënë dëgjuesit një përzjerje të mrekullueshme ndjenjash dhe emocionesh, që nuk mund të fitohen përveçse në një ditë të xhuma, në një hytbe të suksesshme.

Kujtoj një rast, ku nëpërmjet një cikli prej shtatë hytbesh në vijimësi u trajtua hixhreti i Resulullahut a.s. nga Meka në Medine.

Dhe në një moment të caktuar të hixhres profetike, në skenën e kësaj ngjarjeje historike del në skenë një grua beduine, e quajtur Umu

Hatibi duhet të bashkojë në hytben e tij ndjeshmërinë personale të fituar, me atë të tekstit të dëshmuar, për t’i dhënë dëgjuesit një përzjerje të mrekullueshme ndjenjash dhe emocionesh, që nuk mund të fitohen përveçse në një ditë të xhuma, në një hytbe të suksesshme.

Mabed, e cila e përshkruan kështu të Dërguarin a.s.: “Ishte një njeri me shkëlqim të dukshëm, me fytyrë të ndritshme, me moral të lartë... Me fytyrë të bukur, shumë të bukur, me sy të zinj... Me flokë të zinj, me qafë të dukshme e mjekër të dendur. Kur heshte, kishte prezencë e kur fliste, bukur... Fliste ëmbël e qartë... Më i bukur i njerëzve nga larg, më i ëmbli dhe më i miri i tyre nga afër... Mesatar, jo i gjatë, as i shkurtër, si degë në mes dy degësh... Kur fliste e dëgjonin, e kur urdhëronte vraponin për ta zbatuar...”⁵

Fare mirë i kujtoj fytyrat e ndezura e të emocionuara të xhematit të xhamisë së Tophanës në Shkodër, që shikonin njëri-tjetrin dhe, me siguri u dukej se po e shihnin të gjallë, para syve të tyre, të dashurin e Zotit të botëve.

Një hytbe e ftohtë, sado e mbushur me argumente dhe interpretime që të jetë, nuk arrin të depërtojë në zemrën dhe qenien e tjetrit, që është ulur përpara hatibit për të dëgjuar.

Arabët, në urtësitë e tyre thonë: “Ajo që del nga zemra hyn në zemër, e ajo që del nga goja nuk i kalon as veshët.” Për këtë nuk duhet të habitemi kur dëgjojmë ankesa të ndryshme për hatibë e ligjërues, që nuk dhurojnë emocion e ngrohtësi përpara xhematit të etur për të marrë më të mirën e ditës së xhuma.

Arsyeja është shumë e thjeshtë, mungon edukata shpirtërore, ushqimi shpirtëror “Prandej vend i predikuesit nuk duhet t’i lihet i lirë do kujdo; por atij qi zotnon të gjitha cilësinat e meritueshme të një predikuesi.”⁶

INTERPRETIMI

Prej mënyrës së interpretimit të hytbes, varet edhe suksesi i saj. Kjo do të thotë se hatibi duhet të jetë i vëmendshëm dhe të mësohet ta interpretojë hytben e xhumasë. Në një farë mënyre, hatibi duhet të njohë mirë artin e aktrimit, për ta bërë xhematin ta shijojë në maksimum tekstin kuranor, hadithin profetik, interpretimin e ngjarjeve dhe ndodhive të shumta me të cilat zbukurohet dhe plotësohet hytbeja e xhumasë.

Kujtoj, dikur student i gjuhës arabe në Damask të Sirisë, të xhumave, në shoqërinë e shokëve, shkonim xhami më xhami, për të parë e për të shijuar hytbet e mbajtura nga dijetarët e shquar të Damaskut, si: dr. Muha-

med Said Ramadan el Buti, shejkh Naim el Arksusi, shejkh Abdulhadi el Kharsa, shejkh Ebu Nur Khorshid, shejkh Abdulkadir el Arnauti, shejkh Ratib en Nabulsi, shejkh Nedhir el Mektebi, ehejkh Abdullah Rabih, ehejkh Usama ebu Sha'r etj..

Secili prej tyre kishte stilin dhe karakteristikat e ligjërimit. Secili prej tyre ishte shkollë më vete. Secili prej tyre ishte mahnitës në atë që jepte, në atë që interpretonte, në atë që të dhuronte.

Fjala bie, dr. Buti, në xhaminë e tij bri Kasijunit, kishte një hapje karakteristike të hytbes, e cila fillonte me një pyetje a një konstatim mbi të cilin bazohej dhe sillej krejt hytbeja e xhumasë. Dominonte qetësia, emocioni sufist dhe forca argumentuese e një teologu të thelluar.

Dr. Nabulsin, nga minberi i xhamisë që mbante emrin e gjyshit të tij (shejkh Abdulgani en Nabulsi), e karakterizonte zëri i ëmbël, i ulët, por një tematikë mjaft e pasur me argumentime teologjike, gërshetuar me interpretime shkencore, që bënte për vete shtresën e intelektualëve të rinj të qytetit. Ishte veçori e tij.

Shejkh Abdullah Rabih, i cili ndërroi jetë në fund vitin 2007, në Mekë (në sezonin e haxhit), kishte një zë të fortë e kumbues. Interpretonte me duar dhe sillej nga një anë në tjetrën, sikur përqafohej me çdonjërin nga të pranishmit e panumërt në xhaminë "Salahuddin" e më pas në atë "Osman".

Shejkh Ebu Nur Khorshid, me mjekrën e tij të bardhë (shpesh më kujtonte hoxhën tim, H. Vehbi S. Gavoçi), ndonëse në moshë të thyer, kishte një zë të qartë e një gjuhë letrare të pastër. Në minberin e xhamisë së Shejkh Ereslanit, në lagjen "Bab Tuma" (ndër lagjet e të krishterëve të Damaskut), ai ngjitej si një djalosh i ri, plot energji. Kur hynte në xhami, distancën nga dera te minberi e bënte me një ecje karakteristike, që përngjante më shumë me një vrapim të lehtë sesa me një ecje normale. Atë e shoqëronte edhe me një buzëqeshje të ëmbël, paqësore, të cilën e shpërndante deri në kufijtë e vështrimeve të tij prindërore.

Shejkh Abdulkadir Arnauti, nga ballkoni i hytbes (kështu ishte minberi i xhamisë "Muhammedijj"), si nga kati i dytë, dukej sikur do të binte e do të kthehej në një shpirt fluturues, nga mënyra se si e interpretonte hadithin sherifë. Të bëhej se po e dëgjon nga goja e sahabiut transmetues. Shumë gjëra i kuptoj nga mënyra e interpretimit, sesa nga aftësia për të kuptuar vetë gjuhën.



Shejkh Nedhir Mektebiu, ishte "babai" i gjuhës arabe. Në ligjëratën e tij kishte dije të pafund të rregullave gramatikore të gjuhës arabe. Komentonte çdo tekst të përmendur në hytben e tij. Ishte mahnitës!

Në xhaminë e lagjes Ibën Nefis, predikuesi i saj shejkh Abdulhadi Kharsa, kishte aftësi të bashkonte dijet e teuhidit me sirtet e sufizmit të pastër islam.

Ishte shumë atraktiv, sidomos për mënyrën se si e kompozonte hyrjen dhe mbylljen e ligjëratës së tij, të mbushur me dije, shpirt dhe dritë sinqeriteti.

Kështu, hatibët e Damaskut, kishin aftësi, secili sipas shkollës së vet, të ta injektonin hisen e xhumasë, cilësdo xhuma, si me dorë çudibërëse. Dhe kjo falë interpretimit dhe karakteristikave të tyre individuale.

I përmenda këto shembuj, shkollat e mëdha të *hatabetit* damasken, prej të cilit pata mirësinë e madhe të marr e të mbledh. Ato shkolla u shndërruan për mua në burime të pashtershme, prej të cilave pihet vetëm ujë i pastër, i kulluar.

PËR FUND

"Fjala e mirë ndërton parime, gjallëron shpirtin, vë në lëvizje breza, ndërton popuj. Fjala e mirë ndreq një gabim, vendos drejtësi, zhvleftëson një kotësi, eliminon një mashtrim. Fjala e mirë është rruga e veprës, përfitim nga e shkuara, thirrje entuziazmi për të sotmen, shpresë premtuese për të ardhmen. Dhe, më e fortë se kudo, fjala është në minber..."⁷

- 1 H. I. Dibra, *Predku e predikuesat*, në revistën "Zani i Naltë", nr. 4, marc, 1930, viti VI, Shkodër, 1930, f. 953.
- 2 H. Sheuqet, *Përmbi mundimin, përmbi punën*, në revistën "Kultura Islame", viti 1, fruer-mars, 1940-XVIII, (Muh.-Safer, 1358), nr. 6-7, f. 270-271.
- 3 Dr. Ali Sheriati, *Kultura dhe ideologjia*, Tetovë, 1992, f. 9.
- 4 I. I. Dibra, *Predku e predikuesat*, në revistën "Zani i Naltë", nr. 4, marc, 1930, viti VI, Shkodër, 1930, f. 952.
- 5 Dr. Mervan Shejkhulerd, *Es sirretun-nebevijje*, botimi i parë, Damask, 2003, f. 310, nga "Et Tabakat" të Ibni Sadit, 1/231.
- 6 H. I. Dibra, *Predku e predikuesat*, në revistën "Zani i Naltë", nr. 4, marc, 1930, viti VI, Shkodër, 1930, f. 954.
- 7 Dr. Aid el Karni, *El misku vel-anber fi khutabil minber*, botimi i parë, Egjipt, 2005, f. 11.

Fëmija i fundit që u ngjit në një pemë

(PËR FËMIJËT QË PËRBALLEN ME DHUNËN, PUNËN E DETYRUESHME DHE PËRGJITHËSISHT MOHIMIN E LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË TYRE)

Imer Topanica

Fëmijët kanë vijuar të mbeten viktimë të “lojërave” të të rriturve. Vetëm në këto dekadat e fundit, bota është futur në një valë luftërash dhe konfliktesh, fundi i të cilave nuk mund të parashikohet. Ky kontekst brutal, i tëri gjak e lot, zbeh vullnetin për të reflektuar në drejtim të problemeve me të cilat përballen fëmijët në vendet e zhvilluara, ndërsa me qindra e mijëra vriten në pjesën tjetër të globit. Megjithatë...

Që Richard Louv ai i cili prej të parëve e ngriti shqetësimin për mënyrën se si shoqëritë

bashkëkohore i trajtojnë fëmijët në aspektin edukativo-arsimor. Louv,¹ te libri i tij i famshëm “Last Child in the Woods” (fëmija i fundit në pyll), arrin ta shtrojë një problem shumë të rëndësishëm – siç është ai i arsimimit dhe edukimit të vogëlushëve, në një mënyrë krejt origjinale. Nëpërmjet një observimi vetjak, ai arrin të konstatojë se shkëputja gjithnjë e më e madhe e fëmijëve me natyrën, po i kthen ata në persona me më pak aftësi të përqendrimit. Për rrjedhojë, sipas tij, brezat e rinj janë të destinuar për t’u përballur me

Thelbi i problemit mbetet mungesa e komunikimit ndërmjet prindërve dhe fëmijëve.



“sëmundjet” e kohëve moderne si: ankthi, bullizmi, izolimi, depresioni etj..

Louv na e kujton vetëm njërin anë të panoramës me të cilën përballemi çdo ditë. Në kontekstin e shoqërisë sonë, shtresa e mesme dhe ajo më e kamur, ka nisur t’i jap simptomat të cilat i identifikon Louv në procesin e tij observues: siç është kriza e fëmijëve, depresioni në rritje, mungesa e vullnetit për aktivitete, mungesa e kontakteve me natyrën, mungesa e përqendrimit të vëmendjes etj..

Thelbi i problemit mbetet mungesa e komunikimit ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Krahas ngritjes së standardeve të jetesës, është shtuar edhe presioni mbi çiftet bashkëshortore, të cilët në përpjekje për t’i përmbushur kërkesat dhe nevojat e familjes, në të shumtën e kohës janë të zënë dhe të mbingarkuar me detyrime, e për rrjedhojë, u mbetet shumë pak kohë për ta ndarë me pjesën tjetër të familjes. Për këtë arsye, ata vetë vuajnë nga stresi, mungesa e kohës së lirë, lodhja e ndonjëherë edhe depresioni. Në këto rrethana, ata nuk mund të zhvillojnë një komunikim të shëndoshë me anëtarët e familjes dhe sidomos fëmijët e tyre. Këta të fundit, të lënë pas dore, përkatësisht nën mëshirën e fatit, edukatorë të vetëm kanë rrjetet sociale dhe pajisjet teknologjike.

Te pjesa e varfër pastaj, ka fëmijë që detyrohen të punojnë bashkë me anëtarët e tjerë të familjes për ta siguruar mbijetesën. Lypja dhe punë të tjera të rënda, nuk përjashtohen si opsione. Me një fjalë, rrethanat socio-kulturore aktuale nuk janë fare në favor të tyre.

Por edhe te këto bashkësi familjare me kushte të vështira ekonomike, qasja në teknologjinë e mençur nuk mungon. Është vështirë të gjendet një familje e cila nuk posedon të paktën një telefon të mençur.

Në anën tjetër, trendi i përdorimit të rrjeteve sociale, është tejet i lartë. Fëmijët, në këto kushte, janë duke u shkëputur nga “habitati” i tyre i natyrshëm: familja. Kjo shkëputje, nuk po ndodh vetëm për shkak të faktorit ekonomik, por edhe për shkak të ndikimit të teknologjisë.

Në literaturën shkollorë kanë filluar të shtresëzohen doktrina ideologjike që moralin, respektin prindëror (ashtu siç e kuptojmë ne brezat më të vjetër) dhe vlera të tjera universale që burojnë nga besimi, i cilësojnë më pak të vlefshme, për të mos thënë tërësisht jashtë “mode”.

Për pasojat e kësaj të fundit, përdorimit të pakontrolluar të pajisjeve të avancuara, është folur shumë.

“Studimet tregojnë se fëmijët që kalojnë më shumë kohë në rrjete sociale gjatë ditës kanë treguar mirëqenie më të ulët psikologjike, duke përfshirë nivele më të ulëta të kuriozitetit, vetëkontrollit, vështirësi në përqendrim, stabilitet të ulët emocional si dhe paaftësi për të përfunduar detyrat shkollorë” – konstaton në një vështrim të saj të paradokshëm dr. Violeta Zefi.

Në vijim, analiza e këtij konteksti do të përqendrohet te dy anë të një panorame shoqërore.

FËMIJËT NUK DINË TË QESHIN

Deri vonë, hulumtimet e ndryshme kanë vënë në dukje që numri i fëmijëve që detyrohen të punojnë, mbetet një shqetësim global. Raport i organizatës ndërkombëtare ILO (International Labor Organization²), i titulluar “Global Estimates of Child Labour” që përfshinë periudhën 2012 – 2016, bënë të ditur se në nivel global janë regjistruar 152 milionë fëmijë që janë detyruar të punojnë, e prej tyre 73 milionë punë të rënda.

Prej kontinenteve, Afrika shquhet për numrin më të lartë të tyre 19.6%, ndërsa shtetet arabe qëndrojnë më së miri në këtë drejtim, me vetëm 2.9%.

Grup moshat prej 5 deri në 11 vjeç përbëjnë 48% të fëmijëve që detyrohen të punojnë; 12 deri në 14 vjeç 28%; ndërsa 15 deri në 17 vjeç 24%.

Ballkani, përkatësisht Kosova, nuk përbën përjashtim nga këta trendë globalë negativë. Për më keq, vendi ynë duket se nuk i ka ngritur kapacitetet as për adresimin e problemeve që kanë të bëjnë me fëmijët. KOMF (Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve) fjala vjen, në vitin 2024³ publikoi raportin “Cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve”, sipas së cilit “Kosova vazhdon të mos ketë shërbime të specializuara për të adresuar mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda.”⁴

Në anën tjetër, rastet e delikuencës janë shtuar, duke depërtuar edhe në ambientet

edukativo arsimore. Pirja e cigareve, sidomos elektronike, bartja e armëve, abuzimi me substanca të ndaluara etj., është shndërruar në dukuri. Kësisoj, puna e detyrueshme, është një në dhjetë problemet e mëdha me të cilat përballen sot fëmijët e Kosovës.

FËMIJËT QË NUK DINË TË QAJNË

Ngarendja ndaj bollëkut, siç e theksuam më sipër, ka bërë që radhitja e prioriteteve të mos nisë nga familja, por nga përfitimi material, fuqizimi ekonomik dhe shtimi i luksit. Te një shtresë, amortizimi i kërkesave të fëmijëve dhe nevojës së tyre për prani prindërore, ka filluar të zëvendësohet me disa ndërmjetës: teknologji të mençur, apo institucione private edukativo-arsimore. Këto të fundit, në rastin më ideal, edhe sikur të ofrojnë infrastrukturë dhe kuadër të përgatitur, nuk mund ta zëvendësojnë kohën të cilën fëmijët kanë nevojë ta kalojnë me prindërit, sidomos kur bëhet fjalë për grupmoshat më të ulëta. Shtoja këtu faktin që në mënyrë shumë fine në literaturën shkollërore kanë filluar të shtresëzohen doktrina ideologjike që moralin, respektin prindëror (ashtu siç e kuptojmë ne brezat më të vjetër) dhe vlera të tjera universale që burojnë nga besimi, i cilësojnë më pak të vlefshme, për të mos thënë tërësisht jashtë “mode”.

Kjo erë e përmbysjeve vlerore në rrafshin kulturor, po e manifeston edhe një fenomen tjetër: shtresat më të për-vuajtura të shoqërisë, mbeten thjesht imituese të standardit të të kamurve. Kësisoj për disa dekada brenda vendit ka pasur një zhvendosje të popullsisë nga zonat rurale në ato urbane. Siç e theksuam më sipër, pothuajse çdo bashkësi familjare posedon një smartphone, ose një pajisje teknologjike të avancuar që është e aftë të lidhet me internet. Andaj sot mund të pajtohem se simptomat të cilat i identifikon Louv te studimi i tij i famshëm, i vërejmë te shumica e fëmijëve, pavarësisht shtresës shoqërore prej nga vijnë.

Çrregullimi i deficitit të natyrës (Nature-Deficit Disorder), term i krijuar nga Louv për të përshkruar pasojat negative të mungesës së përvojës natyrore në zhvillimin e fëmijëve, është më se evident te shumica e fëmijëve tanë.

Aktivitetet e pa strukturuara, loja e lirë në natyrë, i ndih fëmijët në zhvillimin e imagjinatës, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë sociale. Rekomandimet që dalin nga libri i tij, janë të qëndrueshme edhe sot e kësaj dite.

“PERSPEKTIVA” E VARFËRISË

Thellimi i krizës ekonomike ka ndikuar keq edhe në ekonominë familjare. Sipas Bankës Botërore (BB), ne mbesim vendi me të ardhurat më të ulëta për kokë banori në Ballkan dhe Bashkimin Evropian. Shkalla e varfërisë, mbetet po ashtu e lartë 19.2%, po sipas këtyre burimeve. BPV-ja (Bruto



Produkti Vendor), për kokë banori mbetet 5.889, që i bie më pak se në cilindo vend fqinj.

Nevojat bazike të qytetarëve janë rritur, ndërsa inflacioni enorm, përkundrejt të ardhurave që kanë mbetur të njëjta, po e rëndon edhe më tej situatën. Vetëm paralajmërimi për shtrenjtimin e energjisë elektrike ka pasuar me një valë rritjesh të çmimeve të produkteve bazë. Me këtë trend negativ në aspektin e zhvillimit ekonomik, varfëria ekstreme do ta zgjeroj terrenin e saj edhe më tej.

Një tjetër indikator i drejtpërdrejtë i mirëmbajtjes së varfërisë është sistemi i arsimit, përkatësisht paaftësia e këtij sistemi të nxjerr breza të gatshëm për tregun e punës. Sot veprimtaritë që sjellin më së shumti të ardhura janë ato që ofrojnë shërbime nëpërmjet internetit, si fjala vjen Call Center. Zotësitë që duhet t'i kenë të rinjtë për t'u përshtatur me këto lloj kërkesash që i shtron tregu i punës në këta sektorë, nuk përvetësohen nga një sistem arsimor gjysmë i shkallmuar.

E gjithë kjo ka krijuar një vazhdimësi të pasigurisë. Për këtë, mungesa e perspektivës për të rinjtë, vijon të na e shkaktoj humbjen e resursit më qenësor, resursin human. Tkurrja e popullsisë, sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit, tregon që pakënaqësia e qytetarëve është artikuluar në formën më të dëmshme: braktisjen e vendit.

Emergjencat që i shtron koha, siç është përmirësimi i kushteve të jetesës, respektimi i të drejtave dhe lirive, në këtë rast të fëmijëve; na duhet edhe një vizion afatgjatë që ua garanton carrokëve tanë një të ardhme më të ndritur. Për këtë, na duhet punë dhe angazhim më të madh.

1 https://en.wikipedia.org/wiki/Richard_Louv

2 https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@dgreports/@dcomm/documents/publication/wcms_575541.pdf

3 https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2024/03/Raporti_Karta-e-vleresimit_FINAL.pdf

4 Po aty.

“Tëhuajësimi i Islamit” në epokën e teknologjisë

Abdullah el Amadi

A është normale të shohësh të rinj myslimanë të të dy agjinive në vendet e myslimanëve, t'i pyesësh ata për numrin e rekateve të namazit të akshamit, dhe disa të ngatërrohen, disa të tjerë të hezitojnë, kurse disa të tjerë të gabojnë?

A është normale që shumë myslimanë, veçanërisht brezi i ri, të mos e dinë numrin e shtyllave të Islamit?

A është normale që njerëzit të mos i njohin emrat e pejgamberëve?

A është normale që shumë myslimanë të mos ndiejnë asnjë shqetësim për vuajtjet e myslimanëve të tjerë në Lindje e Perëndim?

A është normale që një brez i ri mysliman të jetojë mbi gjëra të kota dhe prioritete në një kaos të plotë?

A kemi arritur në një fazë të “tëhuajësimit të Islamit”, apo mos ndoshta Islami është bërë i huaj?

A po jetojmë në kohën e zhdukjes së Islamit, saqë nuk do të mbetet prej tij veçse fjala e monoteizmit (*tevhidit*)?

PYETJET NUK MARRIN FUND...

Po, pyetjet nuk marrin fund, por pa dyshim se kjo gjendje së pari është e dhimbshme; së dyti njëkohësisht është edhe frikësuese dhe dëshpëruese; së treti, fton në përsiatje dhe reflektim të madh; kurse së katërti dhe së fundmi, është e rëndësishme që kjo përsiatje dhe ky reflektim të shndërrohet me programe dhe plane konkrete e reale, të cilat do t'i korrigjojnë ato pamje dhe do t'i kthejnë gjërat në gjendjen e tyre të natyrshme përmes mekanizmave, mjeteve dhe institucioneve zyrtare që i zbatojnë ato, si dhe përmes përkrahjes së iniciativave popullore që i ndihmojnë.

Unë personalisht, as nuk dua dhe as nuk uroj që kjo kohë në të cilën po jetojmë të jetë ajo për të cilën ka folur sahabiu i nderuar, Hudhejfe bin Jemani r.a., kur përshkruante nga i Dërguari i Allahut a.s. një skenë të dhimbshme dhe të çuditshme, të cilën myslimanët patjetër se do ta arrijnë në njëfarë kohe, kohë kur njerëzit atëherë nuk do ta dinë më se çështje Islami, e lere më t'i njohin dispozitat, ligjet dhe detajet e tjera të tij.



ÇFARË KA THËNË HUDHEJFE NË NJË TRANSMETIM TË TIJ NGA I DËRGUARI I ALLAHUT A.S.?

Ai ka thënë: “Islami do të fshihet (vjetërsohet) ashtu siç fshihet (vjetërsohet) shkëlqimi i rrobave, derisa njerëzit të mos dinë se çështje agjërimi, as namazi, as ritet e haxhillëkut, as sadakaja; dhe do të zhduket Kurani brenda një nate, e nuk do të mbetet në Tokë asnjë ajet prej tij; do të mbeten disa grupe njerëzish, pleq e plaka, të cilët do të thonë: “Ne i kemi gjetur etërit tanë duke i thënë këto fjalë: “La ilahe il Allah” (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut), prandaj edhe ne po i themi ato” – deri në fund të hadithit.

Do të thotë se Islami do të fshihet-vjetërsohet ashtu siç fshihen zbukurimet e rrobës, që nënkupton se gjurmët dhe mësimet e Islamit do të fshihen, ashtu siç fshihen dhe zhduken me kohë zbukurimet e rrobës.

Ajo që mund të nxirret si përfundim nga ky shkrim është se pyetjet e parashtruara në hyrje të artikullit, nuk ka asgjë që i pengon të lidhen me këtë hadith, dhe të konsiderohen si tregues se ndoshta ne vërtet po e jetojmë atë kohë për të cilën ka folur i Dërguari i Allahut a.s., ose ndoshta jemi në fillimet e formimit të asaj kohe apo epoke, në të cilën do të fshihen gjurmët dhe mësimet e Islamit.

TEKNOLOGJIA NË SHËRBIM TË ISLAMIT

Fjalë për fjalë, asgjë nuk e pengon që kjo kohë të jetë ajo që përmendet në hadith, por do të ishte disi e çuditshme. Ajo që e bën të çuditshme është mënyra se si një mysliman mund të arrijë në një nivel aq të ulët njohurie, saqë të mos dijë asgjë për fenë përveç “La ilahe il Allah”, madje ndoshta as që e di nëse është mysliman, apo çfarë do të thotë të jesh mysliman – në një kohë kur jemi dëshmitarë të një zhvillimi të jashtëzakonshëm në shkencë, dije dhe teknologji, që nuk ka ndodhur më parë në historinë e njerëzimit, dhe që pritet të zhvillohet me shpejtësi të madhe në dekadat e ardhshme, e jo në shekuj, dhe në një mënyrë që vetëm Allahu e di deri ku mund të arrijë.

Sot, për shembull, pas dy revolucioneve – të teknologjisë dhe të informacionit – që kanë filluar më shumë se njëzet vjet më parë, procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është

Ajo që mund të nxirret si përfundim nga ky shkrim është se pyetjet e parashtruara në hyrje të artikullit, nuk ka asgjë që i pengon të lidhen me këtë hadith, dhe të konsiderohen si tregues se ndoshta ne vërtet po e jetojmë atë kohë për të cilën ka folur i Dërguari i Allahut a.s., ose ndoshta jemi në fillimet e formimit të asaj kohe apo epoke, në të cilën do të fshihen gjurmët dhe mësimet e Islamit.

bërë shumë më i lehtë dhe më i qasshëm. Kërkimi i një informacioni nuk kërkon më aq shumë përpjekje siç kërkonte para tri apo katër dekadave, kurse aplikacionet e inteligjencës artificiale janë ndër treguesit më të spikatur të këtij zhvillimi të përshpejtuar. Atëherë, si është e mundur që në një realitet të tillë njohurie dhe teknologjie, myslimanët të jenë kaq të paditur për fenë, të vërtetat dhe bazat e saj?

Si është e mundur që një mysliman të arrijë në një varfëri kaq të thellë njohurish lidhur me fenë e tij, kur sot, falë Allahut e pastaj falë teknologjive të informacionit dhe komunikimit, pothuajse e gjithë bota di më shumë për Islamin dhe myslimanët se më parë? Dhe kur kërkimi apo arritja të njohuritë për Islamin është bërë jashtëzakonisht e lehtë, dhe kërkuesi mund të arrijë tek ajo që kërkon në çdo kohë dhe në çdo vend?

Me mijëra njerëz kanë gjetur udhëzimin drejt kësaj feje falë përparimit të shkencës dhe të njohurive që po jetojmë tani. Pastaj ata filluan të mësojnë dhe të thellohen vetë në fenë islame përmes këtyre mjeteve, pa pasur nevojë që menjëherë të lidhen drejtpërdrejt me mësues, dijetarë, juristë apo të tjerë që kanë njohuri të thella rreth fesë dhe hollësive të saj – përveçse pas njëfarë kohe.

MYSLIMANËT NUK E NJOHIN FENË E TYRE

A është e mundur që pas gjithë kësaj dhe nën dritën e këtij zhvillimi të mahnitshëm në dije, myslimani të mos i dijë as gjërat më të thjeshta dhe më themelore të fesë së tij?

Po, është e mundur që myslimanët të arrijnë në këtë nivel të ulët të njohjes së fesë së tyre, sepse i Dërguari i Allahut a.s., nuk foli nga dëshira e tij, ajo nuk është tjetër veçse shpallje që i shpallet. Nuk ka asgjë që e pengon të ngjarët e asaj që na ka treguar ai a.s., megjithëse mendoj se, pavarësisht kësaj, kjo çështje ende kërkon pak kohë për t’u realizuar plotësisht, por nuk mendoj se do të zgjasë shumë!

Po të reflektosh dhe t’i vësh re me vëmendje përpjekjet e vazhdueshme dhe aktive, si dhe planet e mirë organizuara që po bëhen këtu e atje për t’i shkëputur myslimanët nga feja, besimi dhe kultura e tij në vende të ndryshme gjeografike, veçanërisht në ato arabe, dhe për



t'i zhytur ata në lloj-lloj epshesh dhe argëtimesh, apo në shqetësime dhe probleme të shumta, do ta kuptojë se ajo që po shohim sot është realitet: myslimanë që nuk dinë për fenë e tyre asgjë tjetër përveç *La ilahe il Allah*, në një kohë të tillë të përparimit të jashtëzakonshëm të shkencës, njohurive dhe teknologjisë së njerëzimit, dhe do ta kuptojë se, ata që dikur ne i konsideronim si njerëzit e përmendur në hadithet për kohën e fundit që do të vinin pas shumë shekujsh ose mijëra vjetësh, në të vërtetë, nuk janë askush tjetër veçse ne, myslimanët e sotëm.

ÇFARË DO TË THOTË KJO?

Kjo do të thotë se duhet të jemi të vëmendshëm ndaj rrezikut të një skenari që synohet të shndërrohet në realitet konkret, efektet e të cilit tashmë kanë filluar të shfaqen në mënyrë të dukshme, me shumë gjasë ato do të thellohen gjithnjë e më shumë nëse nuk e kuptojmë me kohë këtë realitet dhe nëse nuk e korrigjojmë këtë skenar. Ne sot jemi në rrezik të zgjerimit të rrethit të injorancës ndaj fesë, pavarësisht zhvillimit të madh të shkencës, njohurive dhe teknologjisë, e që në fakt do të duhej t'u shtonte përdoruesve të tij dije, dritë dhe kuptim, por realiteti aktual i myslimanëve e tregon të kundërtën.

Dijetarët dhe juristët e fesë janë ndarë në rrugë të ndryshme: disa zgjedhën të izolojnë

Ne sot jemi në rrezik të zgjerimit të rrethit të injorancës ndaj fesë, pavarësisht zhvillimit të madh të shkencës, njohurive dhe teknologjisë, e që në fakt do të duhej t'u shtonte përdoruesve të tij dije, dritë dhe kuptim, por realiteti aktual i myslimanëve e tregon të kundërtën.

dhe të kërkojnë siguri, disa të tjerë u përfshinë në pallatet dhe divanet e sulltanëve, një grup i tretë dëshiroi të reformonte, por e gjeti veten në errësirën e burgjeve dhe kampeve të të burgosurve, ndërsa një grup i katërt dhe i fundit, bëri më shumë dëm sesa dobi. Në ndërkohë, predikuesit që thërrasin drejt dyerve të Xhehenemit po përhapen; idetë e prishura, filozofit dhe argëtimet po përhapen dhe grumbullohen kudo, nga e djathta dhe e majta jonë, nga lart dhe poshtë, madje nga të gjitha drejtimet e tokës sonë.

O Allah, na ruaj nga e keqja e sprovave, si nga ato që janë të dukshme ashtu edhe nga ato që janë të fshehta. Na mëso atë që na sjell dobi, na bëj të dobishëm me atë që na ke mësuar, dhe na shto diturinë!

Përktheu nga gjuha arabe: Miftar Ajdini

Burimi: <https://islamonline.net/> "في عصر التقنية" غربة الإسلام

* Abdullah el Amadi është gazetar dhe autor me titullin doktor shkencash në media. Ka disa vepra në fushat e mediave, menaxhimit dhe zhvillimit personal. Aktualisht mban postin e nënkryetarit të Bordit të Drejtorëve të Shoqatës Kulturore "El Belag" dhe ka punuar më parë si kryeredaktor i faqes "Islam Online". Nga eksperiencat e tij të mëparshme përfshihen: zëvendëskryeredaktor i gazetës katariane "El Shark" dhe këshilltar për media i ish-ministrit të Arsimit. Disa nga veprat e tij janë: "Munarat", "Eshja" jef'aluha es Su'ada" dhe "Ve darebe Allahu methelen". Ai ka shkruar 194 artikuj.

Çorientimi edukativ i fëmijëve dhe mungesa e shembullit të prindërit

Hatixhe Sefa

Fëmijët nuk ndjekin vetëm fjalët, por imitojnë sjelljet. Kur prindërit thonë një gjë dhe bëjnë një tjetër, fëmijët çorientohet. Shembulli personal është forma më e fuqishme e edukimit.

Edukimi i fëmijëve është një proces i cili fillon me lindjen e fëmijës, e që në fakt për secilin prind është i ndryshëm dhe për secilin fëmijë është i veçantë. Secili fëmijë vjen me cilësi të ndryshme fizike apo psikologjike, me aftësi dhe zhvillim të ndryshëm, në kushte dhe situata të ndryshme, në familje dhe kultura të ndryshme, prandaj dhe kjo për secilin fëmijë është fat i ndryshëm dhe mundësi e ndryshme.

Në edukimin e fëmijëve ndikojnë faktorë të ndryshëm, nga të cilët me rëndësi të veçantë janë familja (si institucioni i parë dhe themelor edukativ), institucionet parashkollore dhe shkollore, rrethi ku jetojnë dhe shoqëria, mediat dhe rrjetet sociale dhe shumë faktorë të tjerë.

Jo rrallë, vështirësinë dhe peshën e procesit të edukimit e krahasojmë me periudhën kohore në të cilën një individ bëhet prind, edhe pse në çdo periudhë ka qenë po ashtu i rëndësishëm ky proces. Gjithmonë prindërit janë këshilluar dhe kanë mësuar për metodat e prindërimit, të cilat shpesh praktikisht i kanë trashëguar dhe bartur brez pas brezi, ndërsa sot, për të njëjtat organizohen edhe trajnime të ndryshme të prindërimit dhe shkolla të nënave të bazuara në teori dhe studime të ndryshme për prindërim pozitiv, të cilat organizohen për të lehtësuar këtë proces, i cili së fundmi po bëhet gjithmonë e më i vështirë.

Përkaj përpjekjeve për orientim edukativ të fëmijëve, i cili siç e theksuam më lartë fillon nga familja, më saktë nga prindërit, në



përditshmëri jo pak janë rastet e çorientimit edukativ të fëmijëve dhe mungesa e shembullit të prindërit. Ky çorientim shpesh ndërlihet me sfidat që përballen familjet në rritjen dhe edukimin e fëmijëve sot, më saktë ky çorientim edukativ ndodh kur fëmija përballlet me mesazhe kontradiktore nga mjedisi ku jeton. Këto mesazhe që vijnë në forma të ndryshme të fëmija qoftë nëpërmjet fjalëve apo veprimeve, shpesh e vendosin fëmijën përballë një hutimi të pranimit apo refuzimit të shembujve që i shërbejnë, p.sh. prindërit thonë një gjë, por bëjnë një tjetër, apo mësuesi këshillon një gjë, ndërsa vetë nuk i përmbahet asaj që e thotë.

Fëmijët mësojnë më shumë nga sjellja dhe veprimet e prindërve sesa nga fjalët apo këshillat e tyre. Për këtë Albert Bandura (një nga psikologët më të njohur të shekullit XX), i cili në teorinë e tij, *Teoria e të mësuarit social*, theks të veçantë vendos në rëndësinë e modelimit prindëror në zhvillimin e sjelljeve dhe vlerave të fëmijët. Sipas tij, shumica e sjelljeve njerëzore mësohen përmes vëzhgimit të tjerëve: duke parë, duke dëgjuar dhe më pas duke imituar atë që shohim. Kjo do të thotë se njerëzit, në veçanti fëmijët, mësojnë sjellje të reja jo vetëm nga përvojat direkte, por edhe nga vëzhgimi i sjelljes së të tjerëve, që Bandura i quajti “modele”.

Këto modele kur fëmija është i vogël janë prindërit dhe anëtarët e familjes, ndërsa si rritet fëmija këto modele merren edhe jashtë gjirit familjar, nga kopshtet, shkollat, moshatarët, shoqëria, rrethi dhe në veçanti vlen të theksohen rrjetet sociale dhe interneti. Model edukimi përveç prindërve dhe personave të njohur për familjen, në periudhën e “internetit” shpesh për fëmijët tanë bëhen edhe personazhet e ndryshme nga ekranet të cilat pa ndonjë kontroll prindëror, fëmijët përcjellin, shohin, vëzhgojnë dhe mësojnë prej tyre. Këto modele në shumicën e rasteve janë të papranueshme për prindërit, mirëpo këto modele jo rrallë janë të rastësishëm në edukimin e fëmijëve. Sfidat e prindërimit sot bëhen edhe më të ndërlikuara kur hapësirën e tyre të edukimit, prindërit me ose pa vetëdije, e lënë të përmbushet nga personazhe të panjohura për ta dhe pa ndonjë përzgjedhje të tyre, por që fatkeqësisht me ndikim thelbësor në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve të tyre.

Prandaj, roli i prindërve si shembull pozitiv dhe i qëndrueshëm është thelbësor për edukimin e fëmijëve. Prindi në vetvete është pikë reference për sjelljet e fëmijës së tij. Ai me

Fëmija formon karakterin dhe vetëbesimin duke parë prindin. Mungesa e një modeli të qëndrueshëm sjell pasiguri, çorientim dhe ndikim negativ nga jashtë. Dashuria, qëndrueshmëria dhe disiplina janë themeli i prindërimit të suksesshëm.

qëndrimin e tij, sjelljen e tij, fjalën e tij dhe mbështetjen e tij bëhet një model i qëndrueshëm dhe i qartë për zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe formimin e vlerave të fëmija. Mungesa e këtij modeli lë fëmijën të pa orientuar dhe zhvillon pasiguri në sjellje dhe vlera; fëmija nuk ka kujt t'i referohet për të kuptuar se çfarë është e drejtë apo e gabuar; ndikon në ndërtimin e karakterit të fëmijës dhe vetëbesimit të tij; hap rrugë për ndikime të jashtme (modele nga shoqëria, rrjetet sociale, rrethi) pa filtra dhe përshtatje me nivelin kulturor edhe edukativ ku fëmija rritet dhe jeton.

Nëse fëmija mbetet i çorientuar dhe pa model adekuat, që duhet të jetë prindi apo anëtar i familjes apo kujdestar (në mungesë të prindit), ai mbetet i hutuar me sjellje impulsive dhe mungesë kontrolli; probleme në shkollë dhe mungesë disipline, si dhe me vështirësi në formimin e mendimit dhe qëndrimeve të tij dhe vetëbesim të ulët.

Prandaj secili prind lind me lindjen e fëmijës së tij, nëna dhe babai bëhen figurat kryesore në formimin e një individi të ri në shoqëri, i cili në fëmijëri

përgjatë zhvillimit të tij ka nevojë për një model të vetëdijshëm për ndikimin e tij në formimin e identitetit dhe cilësive të karakterit të fëmijës së tij, të cilat do t'i vesh si këmbë të përjetshme. Prindi si model në vete fillimisht duhet të përvetëson gatishmërinë dhe durimin për një rrugëtim të prindërimit i cili ka nevojë për dashuri, qëndrueshmëri dhe disiplinë. Prindi fillimisht duhet të falë dashuri me respekt për fëmijën e tij dhe të tjerët që fëmija të bëhet i dashur dhe i respektueshëm, të jetë i pajisur me vendosmëri për qëndrueshmëri me këto cilësi përgjatë viteve dhe ndryshimeve që e shoqërojnë fëmijën përgjatë rritjes dhe zhvillimit të tij si dhe disiplinë duke qenë vetë i përmbajtur në rregullat që vendos që më pas fëmija të ndjek shembullin e tij.

Fëmijët para nevojave për veshmbathje të bukur, të re dhe të pastër, kanë nevojë për kujdes me dashuri, edukim me përkushtim dhe mbështetje nga prindi apo kujdestari i tyre model i cili luan rolin kyç në formimin e tyre.

* Autorja është Magjistres e Psikologjisë së arsimit dhe kryetare e Qendrës “Savant” (Qendër për shërbime psikologjike, logopedike dhe edukim special për fëmijë, adoleshentë dhe të rritur në Shkup).

Islami burimor, një urë ndërlidhëse midis islamofobisë dhe westofobisë

Prof. Fadil Maloku

Ringjallja e vlerave, e sidomos e aspekteve të organizimit të jetës sociale, asaj politike, ekonomike, e sidomos vlerave kulturore islame në një nivel atraktiv e joshës edhe për qytetërimin perëndimor, aq sa është kompleks, është edhe aq shumëdimensional e tejet sfidues. Themi kështu, edhe për shkakun se bota e gjendur ende në kthetrat e “*melting pot*” të ideologëve globalist, e ka shumë problematike të fillojë të imponojë vlera alternative. Por, me ardhjen e antiglobalistëve në krye të administratës amerikane, duket që shanset për të hulumtuar, por edhe imponuar alternativa të reja qytetëruese ndaj materializmit perëndimor, janë duke u rritur në perspektivë. Mirëpo, këtë shprese alternative mund ta vonojnë, po edhe përmbysin sidomos përçarjet brenda botës myslimane, konfliktet brenda vendeve islamike (p.sh. Libi, Jemen); ekstremizmi (si ISIS ose Al Kaida), që e ka dëmtuar rëndë imazhin e Islamit; presioni i shteteve Perëndimore përmes embargove ekonomike; sanksionet ekonomike që administrata e re amerikane po i fuqizon përmes taksave të larta; shekullarizimi dhe nacionalizmi; rritja e ateizmit dhe agnosticizmit (veçanërisht në mesin e të rinjve urbanë në vendet islamike). Zhvillimet e fundit pas agresionit në Siri, e sidomos reprezaljet kundër popullatës palestineze me pretekstin e kundër mbrojtjes, së bashku me zhvillimet e proceset që ende po vazhdojnë të zhvillohen në Lindje (që mund të cilësohen edhe si përplasje kulturore), pa

asnjë dyshim paralajmërojnë për thellimin dhe krijimin e një hendeku të pa parë ndonjëherë midis Perëndimit dhe Lindjes.

Islamofobia, si diskurs nismëtar për krijimin e valës dhe pozicionimit të ri anti-perëndimor, përgatiti antipodin e tij të munguar që nuk ishte aq evident deri në fund të dekadës së dytë të shek. XXI, e kjo bëri që westofobia të rritet me





shpejtësi drite. Dhe çka është më interesant, (për mendimin tim edhe tejet shqetësues!) ky disponim anti-perëndimor është duke u rritur edhe në vetë vendet perëndimore, sidomos në Evropë. Por, a thua ka ardhur koha për t'u përballur jo vetëm me islamofobinë, por edhe me westofobinë, apo, do të vazhdojë edhe më tej konfrontimi improvizues (*për mendimin tim*) midis këtyre dy skemave apo dy kampeve frustruese globale? Për pikëpamjen time sociologjike, ky lloj tensionimi midis islamofobisë dhe westofobisë, pra, ky lloj ashpërsimi dhe vrazhdësimi i raporteve që e rriti gjenocidi i Gazës, nuk do vinte në këtë nivel sikur islamofobët perëndimor të bënin sadopak përpjekje të kuptojnë anën qytetëruese të Islamit. Anë kjo të cilën ata e nënçmuan maksimalisht e më pastaj e injoruan pa i analizuar fare as pasojat e as reperkusionet eventuale që i “prodhoj” keqkuptimi apo paragjykimi e stigmatizimi i qëllimshëm i vlerave të dëshmuara civilizuese islame. Në anën tjetër, edhe dukuria e westofobisë nuk do të merrte këto përmasa e dimensione sikur westofobët mes myslimanëve të rishikonin anën racionale të qytetërimit perëndimor. Qytetërim ky që në dioptrinë e tyre kualifikohet dhe perceptohet si degjenerues, si konkurrent, e madje edhe si kërcënues ndaj sistemit vleror e kulturor islam. Rritja dhe aversioni ndaj vlerave dhe

sistemit perëndimor që kryesisht tentohet të “promovohet” kryesisht përmes shekullarizimit skeptik, ateizmit të vrazhdë, përvojës dhe trashëgimisë së neokolonializmit imperialist, stereotipive negative dhe stigmatizimit të myslimanëve në nivel global, rritën valën e westofobisë. Islamofobia dhe westofobia, si fenomene komplekse të kohës në të cilën po jetojmë, që dosido pasqyrojnë edhe një veçim kulturor, politike e fetar midis tyre, janë duke u rritur me shpejtësi drite. Arsyet dhe shkaqet duhet kërkuar në ca faktorë nxitës, si p.sh. në injorancën e atyre që e shpërndajnë, ashtu edhe në stereotipitë e licencuara dhe dizajnuara nga grupet marginale. Këtyre faktorëve nxitës, kur u shtohen edhe (dez)informacionet që vijnë nga mediat e ndryshme sociale dhe ca politike bërës me fuqi e kompetencë enorme politike, atëherë, kuptojmë se marginalizimi i komuniteteve të tilla bëhet skemë aktive për të ushtruar ndikimin dhe stigmatizimin midis komuniteteve fetare.

Mendoj se zgjidhja për një formë të këtillë komunikimi, duhet kërkuar tek edukimi dhe emancipimi i masave të gjera, si edhe te ndërkombëtarizimi i tematikave të përbashkëta, siç ndodh p.sh. me luftën kundër varfërisë. Të dy këto fenomene “prodhojnë” reaksione emocionale që fuqizohen përmes paditursisë. Si islamofobia, ashtu edhe westofobia janë të rrezikshme. Islamofobia veçohet në rrafshin individual (p.sh., sulmet kundër myslimanëve), ndërsa, westofobia në rrafshin politik-institucional. Nëse i adresohemi historisë së imponimit të këtyre dy fenomeneve, kuptojmë se islamofobia për dallim nga westofobia ka një histori të qenësimit më të gjatë. Derisa islamofobia themi se ka bashkëlindur me Islamin, westofobia ka lindur bashkë me kolonializmin evropian. Shkakun e këtij raporti asimetrik duhet kërkuar tek origjina e këtyre fenomeneve. Vonesa e westofobisë duhet të ndërlidhet me argumentin se kolonializmit që në kohën tonë ka marrë si dimensione (më të ashpra) ashtu edhe qasje e natyrë më komplekse edhe me faktin e rilindjes së kapitalizmit apo neoimperializmit. Duhet cekur se neoimperializmi i sotëm përmbysi çdo mundësi të bashkëjetesës me islamofobinë.

Shikuar nga kjo perspektivë jo edhe aq të volitshme për dyja këto dukuri të përhapura në gjithë globin, shtrohet pyetja kryesore: A thua mund të gjendet fija e pajtimit po edhe e mirëkuptimit dhe bashkëjetesës midis tyre në një të ardhme të afërt? Kujtoj që mundësitë janë reale, në rast se hulumtohen pikat e përbashkëta të monoteizmit dhe frymës së tolerancës që historia në të kaluarën i ka dëshmuar si të mundshme. Mirëpo, paraprakisht për një gjendje të këtillë nevojitet një vetëdijesim permanent që arrihet vetëm përmes emancipimit civil. Emancipim ky që myslimanët janë duke munduar ta promovojnë përmes sferës së arsimit kualitativ dhe koherent me kohën dhe ambientet ku mosmarrëveshjet dhe stereotipitë bëhen pengesa serioze për bashkëjetesë

midis etnive, religjioneve dhe kulturave. Ndërkaq, koha në të cilën po jetojmë, padyshim që me ekskomunikimet, mosmarrëveshjet evidente, pastaj konfliktet periferike në Lindjen e Mesme, bashkë me ashpërsinë e paragjykimeve për njëri-tjetrin, janë pa asnjë dyshim ai momenti i futjes në veprim të konceptit civil. Koncept ky paqësor, që si ofertë sociale ka jo konfrontimin, e as ballafaqimin fizik, por tolerancën e mirëkuptimit midis popujve, kombeve dhe shteteve kundërthënëse. Dështimi i modeleve laike perëndimore për të promovuar demokracinë dhe konceptin e drejtësisë dhe deri diku të barazisë, në “dioptrinë” e westofobistëve, u bë një alibi e fortë dhe një argument fleksibil e legjitim për të kontestuar e kundërshtuar si sistemin, ashtu edhe vlerat që kultivonte vetë qytetërimi perëndimorë. Bota e sotme me proceset dhe zhvillimet aktuale globale po hyn në një epokë të identifikuar nga shumica e sociologeve dhe sidomos politologëve si post-liberale. Mirëpo, kjo epokë çka është me interesant, nuk ka gjasa të zhvillohet në pritshmërinë komuniste dhe ato neokomuniste. Arsyeja e thjeshtë është se idetë e egalitarizmit (ideologji ose doktrinë që përkrah barazinë mes njerëzve në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, politike dhe ekonomike) përfundimisht u varrosen me dështimin e projektit bolshevik. Këto ide sot askund në botë nuk preferohen dhe rekomandohen si zgjidhje ndaj sfidave dhe problemeve që i ka sot bota bashkëkohore.

Në fakt, faktorët kryesorë nxitës që shemben si idetë komuniste ashtu edhe ato liberale, ishin vlerat tradicionale që i mbijetuan tufaneve komuniste dhe neoliberale. Këto vlera dhe identitete tradicionale që ishin “strehuar” në thellësitë qytetëruese të monoteizmit islam me një “ofertë” të përgatitur mirë dhe të akomoduar me kulturën, traditën mentalitetin dhe etnopsikologjinë e kohës sonë, pra, me një ambalazhim të ri social, edukativ, arsimor e emancipues, ka gjasa që të futen në një konkurrence serioze në sistemin e ri vleror dhe të ngritën e të pranohen si vlera universale.

Problemi qëndron se në horizont nuk ka asnjë “ofertë” të kësaj natyre dhe me këto tendenca e përmasa globale. Fragmentarizmi i sistemeve, lakmia për pushtete, devijimi nga

Në fakt, faktorët kryesorë nxitës që shemben si idetë komuniste ashtu edhe ato liberale, ishin vlerat tradicionale që i mbijetuan tufaneve komuniste dhe neoliberale.

vlerat e vërteta tradicionale islame, si edhe pranimi *ad hoc* i sistemit dhe vlerave perëndimore, ka bërë që Islami si program tejkohor që mund të ushtrohet e praktikohet në të gjitha sferat e jetës, ta filloj implementimin e vetë në këtë periudhën postliberale e postkomuniste. Procesit të “shkurorëzimit” me vlerat neoliberale, përveç qytetërimit perëndimor kanë filluar t’i bashkëngjiten ngadalë por sigurt edhe qytetërimi kinez (i bazuar që moti në vlerat tradicionale konfucianiste), ai japonez (po ashtu në vlerat e trashëgimisë së vet kulturore) evropian etj.. Edhe qytetërimi islam pa mëdyshje do të ndjek rrugëtimin e rikthimit ka vlerat e dëshmuara vetanake dhe të qëndrueshme që i bënë rezistencë erozionit të kohës. Sidomos ato vlera që i mirëmbajtën dinamikat e katër kalifateve, kur mirëqenia ishte në kulmim bashkë me vlerat e solidaritetit dhe tolerancës ndërfaqetare, ndërqytetëruese e ndërkulturore. Por, cilat janë gjasat e rritjes së shanseve për procesin e “shkurorëzimit” apo zbehjes së vlerave perëndimore në “dioptrinë” e Lindjes së Mesme, po edhe asaj të Lartë?

Përgjigjen në këtë dilemë “*hamletiane*” deri diku e kam dhënë tërthorazi. Duke mos dashur ta përsëris, po e ripotencoj se: fenomeni i zbehjes, ngopjes, apo shprehur me terma sociologjik, i aversionit e madje edhe paragjykimit e stereotipizimit që e “prodhuan” fenomenin tjetër të identifikuar si westofobi, janë: kriza shpirtërore që e shkaktoj hipokrizia e super konzumerizmit të pa kontrolluar që u “mirëmbajtë” në emër të korpusit të lirive të njeriut. Liri këto që në Lindjen e Mesme u konsumuan dhe u kultivuan në mënyrë tejet selektive. Këtë fakt sociologjik e dëshmon më së miri konflikti izraelo-palestinez, ku vlerat perëndimore ranë në provim historik edhe për shkakun se u lejuan masakrat ndaj civilëve (thuhet mbi 20.000 fëmijë janë viktime të kësaj indiference!?) palestinez.

Pastaj, përshtypja artificiale për dominimin absolut kulturor e qytetërues, mbi vlerat dhe sistemin vleror të Lindjes që identifikoheshin me Islamin. Këtë perceptim mbi vogëlsinë dhe pa ndikimin thelbësor të Islamit në rrjedhat dhe proceset kontinentale, e sidomos ato globale, e ushtroi pa mëshirë tendenca e globalizimit. Tendencë, kjo që në kulturat



lokale islame, amputoi kompleksin e inferioritetit ndaj vlerave fetare, atyre tradicionale e kombëtare. Gjithë këtij perceptimi antiperëndimor, kur i shtohen edhe agentët e tjerë mediatik jo perëndimor (Kina përmes konkurrencës pa pardon dhe Rusia përmes luftës hibride në sferat politike, ushtarake e ekonomike), kuptojmë shumë më qartë rritjen e fenomenit të westofobisë në botën islame. Kësaj “odisejade” paragjyquese me përplot stereotipi ndaj vlerave dhe qytetërimit perëndimor i kanë fryrë dhe ende i “fryjnë” pa ndalur edhe diskutet e gjera publike politike (që plasohen kryesisht përmes islamit politik), ku fajësia për prapambetje ekonomike që krijoi; pabarazinë dhe punësimin e kontingjenteve të të rinjve të gatshëm për tregun e punës, i adresohet kryesisht sistemit vleror perëndimor. Krijimi i pandamit të islamofobisë, i njohur si westofobi ka gjasa të bëjë dëme të pariparueshme në raportet nder qytetëruese. Mirëpo, në raportet ndërkulturore përvoja nga historia na dëshmon e na mëson se ndikimet ndërkulturore edhe gjatë kohërave të krizave të herëpashershme kanë gjetur hapësirë për t’u “mirëmbajtur” me mirëkuptim e me vigjilencë interesante sociale. Në ndërkohë, duhet potencuar, se koha jonë me specifikat zhvillimore e sidomos me projeksionet për të ardhmen (gjithsesi të pasigurt!), ka gjasa reale ta zgjeroj edhe më tej frustrimin dhe frikën e pa arsyeshme (westofobinë) ndaj vlerave dhe sistemit ende dominues perëndimor.

Andaj, mendoj dhe jam më se i bindur që këtë raport ende acarues midis islamofobisë dhe westofobisë, mund ta shërojë emancipimi i masave të gjëra popullore, ku edukimi dhe arsimimi koherent dhe në përputhje me kohën në të cilën gjendemi, një lëvizje civile islame do të mund përkohësisht të projektojë, kultivojë e madje edhe t’i manifestojë këto

dallime fundamentale midis islamofobisë dhe westofobisë. Arsyeja e vetme është se kjo lëvizje tashmë me përmasa globale i neutralizon paragjykimet, i zbut stereotipitë ndërkombëtare, e preferon tolerancën dhe solidaritetin ndërqytetërues e ndërkulturore. Një lëvizje civile islame, do të dëshmonte se vlerat perëndimore që kritikohen më së shumti tej westofobët e Lindjes së Mesme dhe asaj të Largët, siç janë ato që kanë të bëjnë me korpusin e lirive të shprehjes, mendimit e qarkullimit, pastaj ato të shekullarizimit, barazive gjinore dhe sferën e afirmimit të individualizmit, mund të “bashkëjetojnë” edhe në të ardhmen e afërt, e pse jo edhe atë të largët.

Një lëvizje civile islame po ashtu mund të ndihmojë shumë në zbutjen e westofobisë. Westofobia, si “mall ideologjik” islam me premisa e pretendime populiste, që kërkon çlirimin nga “prangat” e vlerave perëndimore, duhet ta ketë të qartë se pluralizmi i ideve, laramania etnike fetare, klasore, racore e kulturore nuk janë shpikje e mendjes dhe e përvojës njerëzore, por, referencë hyjnore e Krijuesit të Madhërishëm, në të cilin thuhet “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete...” (El Huxhurat, 13).

Së këndejmi, pasojat që i prodhon westofobia (*lindore*), së bashku me islamofobinë (*perëndimore*), përveç se do të ri afirmojnë regjimet autokratike nëpër botë, ato po ashtu edhe do i ri aktivizojnë “vijat ndarëse” midis qytetërimeve dhe kulturave aktuale.

Kontributi i El Vezzanit (Leo Africanus) (1485/94–1554) në zhvillimin e shkencave të gjeografisë dhe historisë

M.sc. Artan S. Mehmeti

El Vezzani, një dijetar i rritur dhe i arsimuar në qytetin Fez të Marokut, me anë të shërbimeve diplomatike, informohej rreth shumë vendeve islame veçanërisht në Afrikën Veriore, duke pasur si interes fushat e gjeografisë dhe hartografisë.

El Hasan ibën Muhamad el Vezzan el Fasi (Joannes Leo Africanus), lindi në qytetin e Grënadës. Me pushtimin e Grënadës nga spanjollët, ai bashkë me prindërit e tij dhe mijëra myslimanë të tjerë u dëbuan nga mbreti Ferdinand, duke u vendosur në Marok. Ai është i njohur për kontributin e dhënë në gjeografi dhe histori.

El Vezzani, një dijetar i rritur dhe i arsimuar në qytetin Fez të Marokut, me anë të shërbimeve diplomatike, informohej rreth shumë vendeve islame veçanërisht në Afrikën Veriore, duke pasur si interes fushat e gjeografisë dhe hartografisë. Në moshën e re, ai duke u kthye nga Stambolli që ishte me mision diplomatik, aferë ishullit të Kretës u kap nga piratët e krishterë sicilian dhe pasi shitet prej tyre fillimisht në Napoli dhe më pas në Romë i dhurohet Papa Leonit X. Në vitin 1520, Papa e pagëzon *El Vezzanin*, më emrin e vetë papës Johannes Leo de Medic-is (Giovanni Leone, në gjuhën italiane), duke e konvertuar në fenë e krishtere dhe më pas e liron atë. Në gjuhën arabe ai preferoi që këtë emër ta përkthej si Juhanna el Asad el Gharnati (John Lion of Granada–Xhon Luani i Grënadës).



El Vezzani

Gjatë qëndrimit të tij në Itali ai mësoi gjuhën italiane dhe ua mësoi të tjerëve gjuhën arabe. Si shkrimtar, El Vezzani vazhdoi aktivitetet e tij në Romë dhe Bolonia. Përveç gjeografisë së Afrikës, ai shkroi një vepër që përfshin



biografin e tridhjetë dijetarëve nga Afrika Veriore. El Vezzani u kthye në Tunizi në vitin 1529 dhe atje ndërroi jetë si mysliman.

Më urdhër të Papa Leoni X, El Vezzani filloi studimin e detajuar të kontinentit Afrikanë. Gjatë studimit të Afrikës, ai vizitoi qytetin Timbuktu (qytet që në këtë kohë i takon shteti të Malit, por në kohën e El Vazzanit i takonte Mbretërisë Songhai), i cili qytet po kalonte kulmin e lulëzimit të tij, por ishte ende një qytet i fuqishëm mysliman, e që njihej edhe për shkollat dhe universitetin e tij. Shtëpi e shumë dijetareve dhe burrave të ditur, Timbuktu posedonte një xhami të madhe, që njihej për bibliotekën e saj të gjerë. Në kohën që Timbuktu vizitohet nga El Vezzani, ky qytet ishte qendër tregtare, i mbushur nga tregtarët e produkteve afrikane si: ari, pulla të shtypura, sklevër dhe libra fetar islame.

Pas kthimit të tij në Romë më 10 mars 1526, ai përfundoi përshkrimin gjeografik të Afrikës. Ky përshkrim u botua në gjuhën

Në kohën që Timbuktu vizitohet nga El Vezzani, ky qytet ishte qendër tregtare, i mbushur nga tregtarët e produkteve afrikane si: ari, pulla të shtypura, sklevër dhe libra fetar islame.

italiane me titullin “Della descrizione dell’Africa et delle cose notabili cheui sono”, në vitin 1550 nga Giovanni Battista Ramusio. Ky botim është vepra më e famshme e El Vezzanit. Hipoteza se përshkrimi gjeografik i Afrikës përfundoi më 10 mars 1526, bazohet në pohimin e Giovanni Battista Ramusio në parathënien e tij në versionin e botuar më 1550, si dhe transmetohet edhe nga shkrimtarë të tjerë duke e përmendur El Vezzanin.

Kjo enciklopedi madhështore e Afrikës është shkruar në nëntë vëllime. Në hyrjen e këtij libri, El Vezzani jep një përshkrim të përgjithshme të gjeografisë së Afrikës, si klimën dhe karakteristikat e popullsisë dhe mënyrën e të jetuarit. Shtatë vëllimet e ardhshme përqendrohen në shtatë rajone, secili me vëllimin (librin) përkatës, siç janë: Mbretëria e Marrakeshit, Mbretëria e Fezit, Mbretëria e Tlemcen, Mbretëria e Tunisit, rajoni i Numidisë, Afrika Sub-Sahariane dhe Sudani, si dhe Egjipti. Vëllimi i nëntë i librit i kushtohet lumenjve, florës dhe faunës së Afrikës. Në këtë libër, në total prezantohen



katërqind vende. Në të, autori ka shënuar se shumica e të dhënave është bazuar në vëzhgimet e tij personale, ndërsa në raste kur ai nuk ka pasur vetë mundësi të vëzhgoj, është përpjekur që t'i mbledhë të dhënat nga njerëz të besueshëm.

Sipas disa studiuesve, nuk ka gjasa që El Vezzani t'i këtë vizituar të gjitha vendet që ai i ka përshkruar në librin e tij, por sipas tyre El Vezzani është mbështetur në informacionet e marruara nga udhëtarët e tjerë. Në veçanti, është e dyshimtë nëse ai i ka vizituar ndonjëherë regjionet Hausaland dhe Bornu, por është shumë e mundur që El Vezzani kurrë nuk e ka kaluar as Saharën, por përshkrimin e tij e mbështet në informacionet e udhëtarëve të tjerë që ai i ka takuar në Marok. Historiani Pekka Masonen e ka argumentuar se dogma e udhëtimeve të tij, ishte bazuar në keqinterpretimet e studiuesve modernë, të cilët e interpretuan librin e tij si itinerar. Sido që të jetë, të gjithë pajtohen se përshkrimi që El Vezzani i bënë Afrikës ka pasur dhe vazhdon të këtë vlerë të madhe shkencore, si dhe për shumë vite, nga evropianet kjo vepër ka qenë bazë për të njohur kontinentin afrikan.

Përveç veprës së El Idrisit më titull “Kitab nuz’hat’ul-mushtak fi Ihtirak ‘il-afak”, përshkrimi që El Vezzani i ka bërë Afrikës, është një nga burimet më të rëndësishme që është përdorur në Evropë që nga gjysma e shekullit të XVI në zhvillimin dhe zgjerimin e gjeografisë humane të Afrikës. Rëndësia e këtij libri rrjedh edhe nga saktësia e tij, në një kohë kur kontinenti i Afrikës ishte pak i njohur për evropianët, si dhe botimi i tij pikërisht në momentin kur fuqia evropiane

ishte në një kurs përplasjeje me Perandorinë Osmane në Mesdheun Lindor, si dhe Evropën Lindore, kohë kur fuqitë evropiane filluan të forcohen në Mesdheun Perëndimor dhe në Afrikën Perëndimore.

Në 50 vjetët e ardhshme, libri i El Vezzanit është përkthyer në shumë gjuhë, si në frëngjisht, latinisht dhe në anglisht. Për fat të keq përkthimi në gjuhën latine përmban shumë gabime e keqkuptime, e ky përkthim është përdorur si burim për përkthimin e saj edhe në gjuhën angleze. Përveçse është përkthyer në shumë gjuhë, ky libër u trajtua nga e para pas një periudhe shumë të shkurtër nga botimi i tij, në vitin 1550 nga ana e Giovanni Battista Ramusio. Në parathënien e përkthimit në frëngjisht të kësaj vepre, ka treguar me mjeshtëri se me çfarë stili dhe forme ishin të lidhur mbas kësaj vepre të El Vezzanit shkrimtarët evropianë nga shekulli i XVI e deri në shekullin e XVIII. Ka shumë mundësi që harta e Afrikës dhe Azisë Juglindore që El Vezzani parashtrroi në Itali, të këtë ndikuar shumë thellë në zhvillimin e hartografisë në Evropë. Harta e kopjuar nga Ramusio dhe e shfaqura në qarkullim, sipas stilit arab kanë pamje nga Jugu dhe me shkallët e gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike, në mënyrë shumë të qartë tregojnë se origjina e tyre janë vendet arabe. Këto janë bërë shkak për të shpëputur lidhjet me hartat që kanë nisur të shfaqen shumë pak pas botimit të Gjeografisë së Ptolomeut duke nisur që nga fillimi i shekullit XVI.

Ka mendime se El Vezzani shërbeu si model për personazhin kryesor të vepra “Othello” e Uilliam Shekspir, botuar në 1603.

Burimet:

Prof. dr. Fuat Sezgin, *Epoka e madhe e panjohur. Nga historia e shkencës dhe e teknologjisë islame*, përktheu nga turqishtja: Altin Qefaliu, LOGOS-A, Shkup 2015. <https://baheyeldin.com/history/leo-africanus.html> (12.08. 2022). <http://www.leoafrianus.com/pictures/bibliography/Masonen/Masonen.pdf> (14.08. 2022). <https://web.archive.org/web/20070102071140/http://www.said-hajji.com/en/book-leo.html> (12.08. 2022).

<http://www.alrahalah.com/2012/04/leo-africanus-16th-century-ce-10th-century-ah-man-between-two-worlds/> (15.08. 2022).

https://www.maggs.com/a-geographical-historie-of-africa_225784.htm (14.08. 2022). [https://en.wikipedia.org/wiki/Description_of_Africa_\(1550_book\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Description_of_Africa_(1550_book)) (13.08. 2022). <https://www.nytimes.com/1989/03/12/books/on-a-camel-moving-forward-in-time.html> (13.08. 2022).

<http://lospreteritosimperfectos.blogspot.com/2010/07/juan-leon-el-africano-la-geografia-del.html> (15.08. 2022).

Kur fjala e një shqiptari ndryshon historinë – Beteja e Fushë Kosovës

Xhafer Sadiku

Në histori, ndonjëherë një betejë vendoset jo vetëm nga fuqia e armëve, por edhe nga një fjalë, një vendim, apo një urdhër në kohën e duhur. Kështu ndodhi më 28 qershor 1389, në betejën e Fushë Kosovës, betejë që ka lënë gjurmë në një nga përplasjet më vendimtare të Mesjetës Ballkanike. Në një kohë kur kombet nuk ishin ende të formuara dhe feja e politika përziheshin në mënyrë të pandashme, historia na kujton se shqiptarët nuk qenë vetëm viktimë të pushtimeve, por edhe aktorë të heshtur në skenën e madhe të historisë.

Beteja e Fushë Kosovës, për nga jehona politike, ushtarake dhe pasojat që la pas, mbetet një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Ballkanit Mesjetar. Për të njohur zhvillimet në tërë përmasat, si dhe pasojat dhe ndikimin e saj për shqiptarët, po hedhim një vështrim të shkurtër në kontekstin historik të rajonit para dhe pas zhvillimit të saj.

SHQIPTARËT PËRPARA BETEJËS SË FUSHË KOSOVËS

Në mesin e shekullit XIV, vendet e Ballkanit po përjetonin një kohë trazirash dhe përplasjesh. Në sfondin e rivalitetit serbo-grek

Beteja e Fushë Kosovës, për nga jehona politike, ushtarake dhe pasojat që la pas, mbetet një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Ballkanit Mesjetar.

për të sunduar Bizantin, Gjenova që zotëronte Egjeun mbështeste Greqinë, ndërsa Venediku mbështeti carin serb Stefan Dushani.

Në periudhën 1331-1355, nën udhëheqjen e Stefan Dushanit, shteti serb përfshiu Bosnjën, Maqedoninë, Thesalinë dhe një pjesë të madhe të territorit të Shqipërisë së sotme. Dushani u shpall “Car i serbëve, grekëve, bullgarëve dhe shqiptarëve.”¹

Serbët, nën udhëheqjen e Stefan Dushanit, kishin filluar marshimin mbi Kostandinopojë, me synimin për të përzënë grekët dhe për të vënë nën kontrollin e tyre territore të rëndësishme të Perandorisë.² Për të frenuar avancimin serb drejt Kostandinopojës, perandori bizantin vendosi të kërkonte aleancë me fuqinë në rritje në Lindje, me osmanët. Aleanca bizantino-osmane i dha osmanëve një hapësirë të re ndikimi në punët e Ballkanit.

Durrësi me një pjesë të konsiderueshme të bregdetit u sundua për më shumë se një shekull nga Anzhuinët, të cilët e kishin marrë nën kontroll që më 1272, kur Karli i Anzhuinëve u shpall Mbret i Shqipërisë. Sundimi i tyre mbështetej në dy shtylla kryesore: në Kishën Katolike dhe në Francën,



e cila e shihte Shqipërinë si një urë drejt Lindjes.³ Feudalët anzhuinë, të etur për pasuri, ushtruan një pushtet të pamëshirshëm mbi qytetet dhe fshatrat shqiptare, duke grabitur pasuritë e banorëve, madje edhe pronat e kishave.⁴ Funksionet administrative u mbushën me të huaj - francezë, italianë, gjermanë etj., - të cilët jo vetëm ushtronin pushtet civil e ushtarak, por shpesh silleshin si grabitqarë. Shqiptarët që kundërshtonin anzhuinët, katolikë apo ortodoksë, shpesh përfundonin si skllavër dhe shiteshin jashtë vendit.⁵

Në aspektin fetar, shumica e shqiptarëve ishin në shumicë të krishterë ortodoksë, ndërsa sundimi anzhuin bëri përpjekje t'i konvertonte në katolikë. Anzhuinët i konsideronin katolikët si shqiptarë, ndërsa shqiptarët ortodoksë si grekë, për shkak të ritit kishtar. Më 1274, në territorin e Barit, Itali, mbaheshin si skllavër shqiptarë, katolikë dhe ortodoksë, meshkuj e femra.⁶ Por shpejt në vend filluan trazirat, të shkaktuara si nga konfliktet politike, ashtu edhe nga përplasjet fetare.⁷ Sundimi anzhuin në Shqipëri zgjati 107 vjet dhe la pas një trashëgimi të dhimbshme. Me rënien e Anzhuinëve, pushteti kaloi në duart e zotërinjve vendas, si Topiajt⁸ që patën mosmarrëveshje me feudalë të tjerë shqiptarë, madje edhe midis tyre.

SHQIPTARËT NË BETEJËN E FUSHË KOSOVËS

Në vitin 1387 qyteti i Selanikut iu dorëzua osmanëve pa luftë. Manol Paleologu, sundimtari i qytetit, kërkoi të rezistonte, por popullsia e detyroi të largohej për t'ia mundësuar dorëzimin pa gjakderdhje. Në një kthesë simbolike, ai vetë nderoi sulltanin dhe madje mori pjesë në luftëra në shërbim të tij, përpara se të kurorëzohej perandor.⁹ Pra, në atë periudhë ishte ravijëzuar një lloj aleance

geopolitike; osmanët me grekët kundër sllavëve, kryesisht serbëve dhe bullgarëve.

Rivaliteti për fronin serb u ashpërsua në vitin 1374, kur princi Llazar rrëzoi nga fronti i Rashës Markon, birin e vogël të Vukashinit. Marko u arratis dhe gjeti strehim pranë osmanëve, duke kaluar edhe në fenë myslimane. Për të siguruar pozitat e tij në fron, mbreti Llazar u detyrua të njihte sovranitetin e sulltanit dhe të nënshkruante një traktat në prill të vitit 1375, sipas të cilit Serbia do të paguante çdo vit njëmijë lira argjendi dhe do të dërgonte njëmijë kalorës në shërbim të sulltanit. Në këtë mënyrë, Serbia kaloi formalisht nën varësinë osmane.

Fisnikëria serbe u përpoq të kapërcente përçarjet dhe të bashkohej rreth Llazarit për të organizuar një rezistencë të re ndaj osmanëve. Vuk Brankoviçi, dhëndër i Llazarit, informoi Sulltan Muratin për planet e luftës. Ky i fundit grumbulloi një ushtri të madhe nën drejtimin e Ali Pashës dhe e urdhëroi të pushtonte Bullgarinë dhe Serbinë.¹⁰ Bullgarinë e mori me lehtësi pasi njëri nga vëllezërit Shishman, për të siguruar pushtetin, i ofroi sulltanit për grua bijën e tij dhe u bë vasal i tij. Kjo aleancë e re nxiti një tjetër valë rivaliteti serbo-bullgar.

Në Ballkanin që po ndryshonte me shpejtësi, shqiptarët u gjendën të përfshirë në betejën vendimtare të Fushë Kosovës më 28 qershor 1389, ku u përballën aleanca sllavo-hungareze dhe ushtria osmane e Sulltan Muratit I.

Revista "Albania", në numrin 7 të vitit 1898 shkruante se në Fushë të Kosovës, Gjon Marku, një burrë trim e i mençur, bashkë me disa ushtarë vajti e ndihmoi Sulltan Muradin I në luftën që ai bëri me serbët. Nuk dihej se për çarsye u bashkua me mbretin e Turqisë pa i pasur ndonjë detyrim, duke qenë se kombi ynë në atë kohë s'ishte nën pushtet të huaj. Arsyeja ishte se Serbia kishte pushtuar zonat e Shqipërisë së Sipërme



dhe Gjon Marku ishte vendosur në qytetin e Gjakovës. Duke qenë të pakët në numër, nuk mund të fitonin dot mbi serbët, pritën rastin dhe u bashkuan me osmanët kundër serbëve.

Revista shkruante se sulltani, duke menduar të fillonte sulmin, pyeti të parët e ushtrisë dhe kërkoi t'i jepnin këshilla. Të gjithë iu përgjigjën se nuk ishte ajo dita e mirë për t'u ndeshur me armiq të për disa shenja që dukeshin jo të mira. Vetëm Gjon Marku i tha se e mirë dita për trimin ishte kurdo dhe se duhej pa vonesë të fillonin luftën sa kishte në ushtri dëshirën për të luftuar. Pas këshillës së Gjon Markut, Sulltani dha urdhër të fillonin sulmin dhe fjalët e Gjon Markut dolën të vërteta: me gjithë trimërinë e serbëve, ushtria e Sulltanit fitoi.

Mbas asaj fitore, sulltani ia njohu Gjon Markut përsëri titullin që kishte më parë si kapitan, duke i gdhendur në një pllakë metalike një ferman me emrin e tij dhe ushtarëve që kishte me vete, Mirditë, me të cilën që atëherë u thirrën populli që ishte nën sundimin e kapitanit. Fermani metalik ruhej në mbretërinë osmane.¹¹

Në ferman, sulltani njihte Gjon Markun si të parë të krahinës; njihte të drejtën zakonore dhe kanunin që kishte pasur krahina deri para pushtimit serb. Kapiteni dhe Mirdita ishin të lirë në ushtrimin e fesë së tyre dhe nuk

Mirdita u bë një nga ato zona shqiptare që, ndonëse brenda kufijve të Perandorisë, ruajti një autonomi të veçantë përmes një marrëveshjeje nderi.

mund të shtrëngoheshin e të braktisnin fenë e të parëve. Kapitani, nga ana e tij, e njihte Sulltanin, merrte përsipër të jepte disa ushtarë me armët e kuajt e tyre, nëpër luftëra që do të bënte mbretëria.¹² Mirdita kishte detyrim vetëm të paguante dy grosh e gjysmë për shtëpi në vit, shumë kjo simbolike.

Revista "Hylli i Dritës", e klerit katolik dhe autoritet i dorës së parë i shtypit të viteve 1930, shkruante se sulltanët e hershëm, Mirditës ia kishin njohur lirinë e plotë. I vetmi kusht ka qenë sigurimi i një kontingjentit fiks luftëtarësh në kohë lufte. Ishte një traditë që Sulltani, i kënaqur prej trimërisë së mirditasve që treguan në luftën e Kosovës, më 1389, kishte urdhëruar të shkruhej një ferman mbi tablet-bronxi (fletë metali), me privilegie trashëguese dhe ia kishte dhuruar kryetarit të tyre. Në 1690, Sulltan Sulejmani II u dha dhuratë 100 barrë misër duke u shënjuar edhe ajo si dhuratë përkujtuese. Ky zakon vazhdoi deri në rënien e Perandorisë Osmane dhe, për çdo vit, sulltani i jepte shtatëdhjetë barrë misër krye sundimtarit, si dhe tridhjetë të tjera pleqve të pesë bajraqeve.¹³

Sulltan Muradi u vra pas betejës, por fitorja ishte vendimtare. Fjalët e Gjon Markut u kujtuan si një ogur që ndryshoi rrjedhën e historisë. Qysh atëherë nuk u fol më për rolin e Gjon Markut derisa e nxori përsëri në dritë revista "Albania", më 1898, që e botonte Faik Konica.

Kështu, Mirdita u bë një nga ato zona shqiptare që, ndonëse brenda kufijve të Perandorisë, ruajti një autonomi të veçantë përmes një marrëveshjeje nderi.

FUNDI I NJË EPOKE, SHQIPTARËT NË EPOKËN E RE

Pas betejës së Fushë Kosovës, Serbia, nën sundimin e Stefanit, birit të princit Lazar, ra në vasalitetin e Sulltan Bajazitit.¹⁴ Ndërkohë, Perandoria Bullgare u shpërbë përfundimisht. Kështu, përplasja shumëvjeçare për hegjemoni në Ballkan midis serbëve dhe bullgarëve përfundoi në favor të fuqisë së re që po ngjitej pa u ndalur, osmanëve.

Beteja e Fushë Kosovës e vitit 1389 pati rëndësi të madhe për shqiptarët, si pjesë e një periudhe historike kyçe që ndikoi drejtpërdrejt në zhvillimin e mëtejshëm të popujve dhe



territoreve të Ballkanit. Ajo solli ndryshime në strukturën politike, shoqërore dhe fetare të rajonit. Mund të theksohet se kjo është një nga herët e para ku shqiptarët përmenden si subjekt me peshë në vendimmarrjet e mëdha të rajonit.

Për shqiptarët, periudha pas betejës së Fushë Kosovës përfaqësoi një kalim nga sundimi i disa shteteve të ndryshme, si serbët, bullgarët dhe bizantinët, në një administratë të re, atë osmane.

Perandoria Osmane kishte një qasje të veçantë në organizimin e territoreve që i përkisnin popujve të ndryshëm, duke zbatuar sistemin e mileteve, që garantonte një farë autonomie territoriale dhe administrative për grupe të ndryshme etnike dhe fetare.

Për shqiptarët, ky organizim pati një ndikim të dukshëm, sidomos për klerin dhe fisnikërinë shqiptare që ruajtën privilegjet e tyre. Dëshmia e tolerancës osmane dukej edhe në krijimin e institucioneve fetare, si manastiri në Janinë, i themeluar nga një prej gjeneralëve të Sulltan Muradit, një akt që ilustronte hapjen e Perandorisë Osmane ndaj praktikave fetare dhe kulturave të ndryshme.¹⁵

Trimëria e shqiptarëve në betejën e Fushë Kosovës, ndikoi që ata të vendosnin marrëdhënie të privileguara me osmanët. Krerë feudale shqiptarë kërkonin ndihmën e osmanëve kur u rrezikoheshin zotërimet nga të tjerët. Kështu, Karl Topia, me ndihmën e osmanëve, arriti ta rimarrë Durrësin. Po me ndihmën e osmanëve, familja e Dukagjinëve rimori fushën e Zadrimës.¹⁶

Shumë shqiptarë u bënë pjesë e ushtrisë osmane dhe ngjiten shkallët e karrierës ku treguan trimëri të madhe. Rasti i Bajazit Pashës, një shqiptar trim dhe besnik, i cili

shpëtoi Çelepi Sulltan Mehmetin nga rrethimi, ishte tregues i besnikërisë dhe trimërisë së shqiptarëve, të cilët kontribuan në ushtrinë osmane edhe para se Shqipëria të merrej nga osmanët. Bajazit Pasha ishte edhe kryeministri i parë i huaj i Perandorisë Osmane, ndërsa disa dekada më vonë administrata civile dhe ushtria osmane do të mbusheshin me shqiptarë.

Periudha e re, ndonëse pati sfida dhe ndryshime, u ofroi shqiptarëve mundësi për ruajtjen e identitetit dhe traditave të tyre në një periudhë të trazuar. Ajo u mundësoi një zhvillim të veçantë të kulturës dhe shoqërisë shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane.

1 Enciclopedia italiana, v. 5, f. 923.

2 Ildebrando Bencivenni, La Guerra degli stati balcanici conto la Turchia. f. 20.

3 Francesco Carabellese, Carlo D'Angio, Bari 1911, f. 7.

4 Histori e Shqipërisë, Tiranë, 1964, v. I, f. 99.

5 Pio Bandiolo, Albania, f. 54.

6 Xhafer Sadiku, Midis perandorive dhe religjioneve, Tiranë 2021, f. 87.

7 Carlo D'Angio, nei rapporti politici e commerciali con Venezia e l'Oriente, Bari 1911 f. 52.

8 Pio Bandiolo, Albania, f. 54.

9 Mark Mazower, Selaniku, qyteti i fantazmave, f. 48.

10 Delle relazioni fra la Chiesa Cattolica e gli slavi della Bulgaria, Bosnia, Serbia, Erzegovina; Saggi del Prof. D. Pietro Balan, Roma 1880, f. 176-179.

11 Albania, viti 1898, nr. 7, f. 109-110; Dera e Gjon Markut, e kapitanit të Mirditës.

12 Po aty.

13 Hylli i Dritës, viti 1940, korrik-shtator, nr. 7-9, f. 368.

14 Po aty, f. 181.

15 Mark Mazower, vepër e cituar, f. 48.

16 Pio Bandiolo, Albania, f. 54.

Kosova shkëlqeu në arenën ndërkombëtare – Garat e Kuranit me organizimin më të mirë deri më tani

HAPJA SOLEMNE

Për herë të parë në historinë e saj, Kosova ishte nikoqire e një prej ngjarjeve më të rëndësishme fetare në rajon – Garave Ndërkombëtare të Kuranit, të cilat u zhvilluan përgjatë katër ditëve në Prishtinë. Kjo ngjarje madhore u realizua nën organizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Islame, Thirrjes dhe Udhëzimit të Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Në këto gara morën pjesë 146 garues nga 22 vende të Ballkanit dhe Evropës, teksa nga Kosova garuan 41 kandidatë.

Në hapjen solemne, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, theksoi vlerën dhe rëndësinë e mësimit të Kuranit, duke e cilësuar këtë ngjarje si një ndër format më të bukura të adhurimit dhe ruajtjes së fjalës së Zotit.



“Të garosh në leximin dhe mësimin përmendsh të Kuranit famëlartë nuk është vetëm një nder i madh, por edhe një përgjegjësi e shenjtë. Është një rrugë që kërkon përkushtim, sinqeritet dhe dashuri ndaj fjalës së Zotit. Sot, ne jemi këtu për të nderuar jo vetëm garuesit, por edhe vetë mesazhin e Kuranit që na udhëzon drejt dritës, drejt moralit dhe paqes. Le të jetë kjo garë frymëzim për të gjithë ne, që ta mbajmë Kuranin në zemrat tona në jetën tonë të përditshme.”

Nga ana tjetër, këshilltari për Çështje Fetare i Arabisë Saudite në Sarajevë, Amir el Unejzi, theksoi se qëllimi i këtyre garave është të nxisin garën e shëndoshë ndërmjet myslimanëve në memorizimin, recitimin dhe interpretimin e Kuranit të shenjtë, për të sjellë përfitime shpirtërore për Islamin dhe komunitetin mysliman në tërësi.

VLERËSIMI I JURISË PËR ORGANIZIMIN E GARAVE

Në këtë edicion të Garave Ndërkombëtare numri i pjesëmarrësve ishte më i madh se vitet e kaluara dhe niveli i garuesve sipas jurisë ishte shumë më i lartë. Kryetari i jurisë dr. Nasir el Matrafij, për këtë garë tha se ishte një ndër më të mirat të organizuara deri më tani.

“Kjo garë ka qenë prej garave që ka pasur organizimin më të mirë nga të gjitha garat deri më tani. Pavarësisht mungesës së të shprehurit në arabisht nga nxënësit, niveli i tyre në shqiptimin dhe leximin e Kuranit ka qenë shumë i lartë dhe për këtë arsye kjo garë mund të llogaritet në shkallën më të lartë të organizimit, po ashtu edhe të garuesve.”

Edhe anëtarët e tjerë të jurisë u shprehën të mahnitur me nivelin dhe përkushtimin e garuesve.

“Ne si komision vlerësues jemi duke kaluar çaste shumë të lumtura. Gjëja që më së shumti më gëzon është prania e fëmijëve të vegjël që mësojnë 5 xhuze apo më shumë. Kjo gjë ma gëzon zemrën”, tha Sabahudin Jerebićanin, njëri nga anëtarët e jurisë.

“Në këto gara ka një rregull, një specifikë e cila nuk ka qenë në të kaluarën. Është qetësi e madhe, dëgjimi i Kuranit bëhet në nivel, janë duke e vlerësuar vetë garuesit por edhe anëtarët e familjes së tyre.”



“Këto gara tregojnë se Kosova është shtet ku gjenden njerëz të dijes së Islamit që e duan Kuranin. Të rinjtë tanë e duan Kuranin dhe kanë filluar ta mësojnë me të madhe.”

Për të arritur këtë nivel të lartë, juria ka aplikuar kritere të qarta dhe të rrepta në vlerësim. Hifzi, apo mësimi përmendsh i Kuranit, qëndronte në qendër të vlerësimit. Edhe pse kriteret këtë vit ishin më të larta, përgatitja e garuesve ishte më e thellë sipas jurisë.

“Kapuni fort pas librit të Zotit – është dritë, është udhëzim, është litar i fortë që zbriti nga qielli në tokë.” Sabahudin Jerebićanin

“Këto gara tregojnë se Kosova është shtet ku gjenden njerëz të dijes së Islamit që e duan Kuranin. Të rinjtë tanë e duan Kuranin dhe kanë filluar ta mësojnë me të madhe.” Shafi Osmani

EMOCIONET E GARUESVE

41 garues nga Kosova morën pjesë në Garat Ndërkombëtare të Kuranit, të cilat u zhvilluan në Prishtinë. Nxënës e studentë mes emocioneve, përkushtimit dhe ndjenjës së krenarisë, ndanë përshtypjet e tyre për pjesëmarrjen në këto gara të cilat u mbanë për herë të parë në vendin tonë.

Daria Smajli tha se ndihet e privilegjuar që për herë të parë po iu bashkohet një gare kaq të madhe dhe të rëndësishme fetare.

“Ndihej shumë e privilegjuar që më ka ardhur rasti të marrë pjesë në këto gara, është hera e parë që marrë pjesë. Përgatitjet i kanë vështirësitë dhe sfidat e veta, mirëpo dëshira



dhe dashuria e madhe për Kuranin e ka bërë më të lehtë këtë rrugëtim.”

“Kjo rrugë është përplot sfida dhe kërkon durim, mirëpo sfida më e madhe për një hafëz besoj është kur ta mbërrin këtë titull ta mbrojë atë për gjithë jetën edhe me praktiku fjalën e Allahut”, u shpreh hafëzja Selma Myrta.

Aliu, një tjetër garues nga Belgjika ishte një prej shumë zërave që dëshmojnë se përkushtimi ndaj Kuranit është një rrugëtim që tejkalon kufijtë gjeografikë.

“Prej mirësisë së Zotit është që më ka zgjedhur mua të marrë pjesë në këto gara, që t'i shërbej librit të Zotit. Në fillim memorizimi ka qene i vështirë, por me kohë, duke përsëritur gjithçka bëhej më e lehtë. Në fillim kam mësuar me nënën time, pastaj ajo më dërgoi te një mësues dhe kështu vazhdova edhe te mësues të tjerë derisa i memorizova 10 xhuza nga Libri i Zotit. Nuk më ka marrë kohë hifzi, kam filluar qysh si i vogël. Hifzi në vegjëli është i shpejtë”, u shpreh Ali Cherradi.

CEREMONIA E NDARJES SË ÇMIMEVE

Garat Ndërkombëtare të Kuranit u përmbyllën me ceremoninë e ndarjes së çmimeve për të gjitha kategoritë pjesëmarrëse.

Në këtë ngjarje kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, shprehu mirënjohjen e thellë për bashkëpunimin me Ministrinë për Çështje Fetare të Arabisë Saudite, duke e vlerësuar lart çdo pjesë të organizimit të kësaj ngjarje.

“Kosova, vend i plagëve, por edhe i krenarisë, ka pasur ndërin të jetë nikoqire e një ngjarjeje me përmasa ndërkombëtare, që nuk i flet vetëm mendjes, por që troket thellë në zemrën e

çdo besimtar. Jemi thellësisht mirënjohës për bashkëpunimin e vyer mes Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Ministrisë për Çështje Fetare të Arabisë Saudite, të cilat përmes këtij organizimi madhështor e kanë rikonfirmuar se vëllazëria në besim nuk njeh kufij, se drita e Kuranit ndriçon nga Meka deri në Prishtinë, nga Qabeja deri në çdo zemër që rrah me iman në atdheun tonë të lirë.”

Këtë ceremoni solemne e nderoi me pjesëmarrjen e tij imami i Qabesë, shejh dr. Bandar Beleela, i cili iu drejtua të pranishmëve me një fjalim të fuqishëm.

“Kurani është fjalë e Zotit, nga Ai erdhi dhe tek Ai do të kthehet. Kurani i bashkoi njerëzit edhe pse nuk flasin të njëjtën gjuhë. Në çdo mosmarrëveshje myslimanët kthehen tek ai dhe gjejnë zgjidhje në të.”

Kurse ambasadori i Mbretërisë Saudite në Tiranë, z. Feisal Hevzi, tha se bashkimi i gjithë këtyre garuesve në një vend dëshmon një pamje të ndritshme të unitetit të ymetit rreth Librit të Zotit. Ai po ashtu vlerësoi lart përkushtimin e Mbretërisë së Arabisë Saudite në përkrahje të këtyre iniciativave si dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për partneritetin e frytshëm me Arabinë Saudite.

Në fund të kësaj ceremonie u ndanë edhe çmimet për tri vendet e para nga 5 kategoritë pjesëmarrëse për të dy gjinitë.

Vendin e parë për memorizimin e plotë të Kuranit e zuri Numan Selami nga Shkupi, kurse në këtë kategori nga gjinia femërore vendin e parë e fitoi Ola Behiry nga Italia.

Ngjarja u përmbyll me një recitim të mahnitshëm të ajeteve të Kuranit nga imami i Qabesë.

Shota Krasniqi

Imami i Qabesë, shejh dr. Bandar Baleela, vizitoi Kosovën

Me ftesë të kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë, njëri prej imamëve të Qabesë, shejh dr. Bandar Baleela, qëndroi për një vizitë katër ditore në Kosovë. Ai u prit ngrohtësisht nga besimtarët myslimanë kosovarë, si dhe zhvilloi një sërë aktivitete fetare e kulturore. Vizita përkoi me Garat Ndërkombëtare të Kuranit që u mbajtën në Prishtinë, në të cilat morën pjesë 146 garues nga 22 vende.

Të enjten mbrëma, më 8 maj 2025, imami u prit në aeroport nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe stafi i tij, ndërsa të premten vizitoi selinë e Kryesisë së BIK-ut, ku u njoh me organizimin e jetës fetare islame në Kosovë dhe për vetë historinë e shtetit të Kosovës.

Imami i Qabesë, shejh dr. Bandar Baleela, shprehu kënaqësinë për vizitën, mikpritjen dhe bashkëpunimin ndërmjet Arabisë Saudite dhe Bashkësisë Islame të Kosovës.

XHUMAJA NË XHAMINË E MADHE

Shejh dr. Baleela mbajti hytben dhe i priu namazit të xhumasë në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, ku përcolli mesazhet e Islamit për unitetit, barazi dhe solidaritet. Ai theksoi se të gjithë besimtarët janë vëllezër, pavarësisht racës apo kombësisë, duke iu referuar ajeteve të ndryshme kuranore dhe haditheve që ftojnë për unitet dhe sjellje të mirë.

Pas namazit të xhumasë, imami i Qabesë, vizitoi pjesëmarrësit e Garave Ndërkombëtare të Kuranit.





VIZITAT NË XHAMITË E PRISHTINËS

Të premten në mbrëmje, imami vizitoi xhaminë në lagjen Mati 1, ku i priu namazit të akshamit, dhe më pas vizitoi xhaminë në lagjen Veternik, në të cilën i priu namazit të jacisë. Prania e tij tërhoqi një numër të madh besimtarësh. Ai gjatë këtyre vizitave, u shoqërua nga Myftiu Tërnavë dhe zyrtarë të tjerë të BIK-ut.

Gjatë qëndrimit në Kosovë, shejh Baleela vizitoi ekspozitën “Urat” në qendër të Prishtinës, të organizuar nga Ministria e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite në bashkëpunim me BIK-un. Ekspozita prezantonte kulturën dhe trashëgiminë islame të Arabisë Saudite.

VIZITA NË XHAMINË “PAVARËSIA” DHE ATË TË HAJVALISË

Të shtunën, imami i Qabesë vizitoi xhaminë “Pavarësia” në Kodrën e Trimave dhe më pas xhaminë e Hajvalisë. Në të dy xhamitë iu priu namazit, teksa krijoi atmosferë të vendeve të

shenjtë me këndimin e bukur të Kuranit. Ai po ashtu mbajti ligjërata që përqendroheshin në rëndësinë e unitetit mes besimtarëve. Ai theksoi se përçarja është një nga të sfidat më të mëdha që e godet ymetin dhe se besimtarët duhet të jenë të bashkuar si një trup i vetëm.

Në fund të vizitës, shejh dr. Bandar Baleela, mori pjesë në përmbylljen e Garave Ndërkombëtare të Kuranit ku u shpallën fituesit. Ai u shpreh se një nga mirësitë më të mëdha që Zoti u ka dhënë besimtarëve është dashuria dhe uniteti për hir të Tij, duke shtuar se edhe vuajtjet e Kosovës gjatë luftës janë ndjerë edhe në vendet islame.

Kjo nuk është hera e parë që një imam i Qabesë viziton Kosovën. Tre vjet më parë, vendin e vizitoi imami tjetër, Abdullah Avad el Xhuheni.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFIN E RI TË MISIONIT TË OSBE-SË NË KOSOVË, Z. GERARD MCGURK

Më 16 maj 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kurtuazie ambasadorin e ri të misionit të OSBE-së në Kosovë, z. Gerard McGurk.

Fillimisht gjatë këtij takimi Myftiu Tërnavë e uroi ambasadorin për marrjen e detyrës së re, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai më pas e njohu mysafirin me punët, angazhimet dhe të arriturat e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Myftiu më pas vlerësoi lart bashkëpunimin e deritanishëm me misionin e OSBE-së, duke potencuar kështu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton për një vazhdim edhe të mëtejshme të një bashkëpunimi të tillë.



Nga ana e tij, ambasadori McGurk, falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen dhe për bashkëpunimin e institucionit të BIK-ut me misionin e OSBE-së, duke thënë se mbetemi të përkushtuar që të vazhdojmë një

bashkëpunim të tillë edhe në të ardhmen. Ai vlerësoi lart rolin dhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në ruajtjen e paqes, harmonisë dhe tolerancës ndërfetare në vend.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM MYFTIUN E BURSËS, YAVUZ SELIM KARABAYIR



Më 8 maj 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim myftiun e Bursës, Yavuz Selim Karabayır, i cili shoqërohej nga bashkëpunëtorët e tij. Gjatë këtij takimi u diskutua rreth thellimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve fetare të të dyja vendeve, me theks të veçantë në fushat e edukimit fetar, shkëmbimeve të

përvojave institucionale dhe projekteve humanitare.

Myftiu Tërnavë shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që DIJANET-i i ka ofruar Bashkësisë Islame të Kosovës ndër vite. Ai vlerësoi kontributin e Bursës si një qendër e rëndësishme fetare dhe kulturore në Turqi, dhe shprehu gatishmërinë për intensifikimin e bashkëpunimit.

Nga ana e tij, myftiu Karabayır falënderoi Myftiun për mikpritjen dhe theksoi rëndësinë e ruajtjes së lidhjeve të forta vëllazërore ndërmjet myslimanëve të Kosovës dhe Turqisë. Ai theksoi se vizita në Kosovë ka për qëllim forcimin e lidhjeve të ndërsjella dhe mbështetjen e mëtejshme në zhvillimin e kapaciteteve fetare dhe arsimore në vend.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA QENDRA E MBRETIT SELMAN E ARABISË SAUDITE

Më 28 maj 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion nga Qendra e Mbretit Selman e Arabisë Saudite, në përbërje të z. Muhamed Shumeri, z. Abdulaziz Othman dhe znj. Fanar al Shihri.

Fillimisht Myftiu Tërnavë iu uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i njohu ata me punët dhe angazhimet e Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë për aktivitetet humanitare që zhvillon ky institucion përmes shoqatës “Bereqeti”.

Ai falënderoi mysafirët dhe nëpërmes tyre Qendrën e Mbretit Selman për ndihmat e vazhdueshme që kanë dhënë për institucionin e Bashkësisë



Islame të Kosovës, e në veçanti për ndihmat e fundit që kanë të bëjnë me shpërndarjen e mjeteve financiare për jetimët anekënd Kosovës. Ai tha se kjo ndihmesë është tejet e mirëseardhur për ta.

Nga ana e tyre, mysafirët nga Qendra, u shprehën tejet të kënaqur me organizimin, ekzekutimin dhe implementimin e këtij projekti nga ana e Bashkësisë Islame të Kosovës.

U HAP EKSPOZITA “URAT”



Më 2 maj 2025, tradita, kultura dhe trashëgimia e pasur e Mbretërisë së Arabisë Saudite janë prezantuar për herë të parë në Prishtinë përmes ekspozitës ndërkombëtare “Urat”. Nën organizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite, kjo ngjarje kulturore unike, përmes kësaj ekspozite, solli një pasqyrë të jetës, zakoneve dhe trashëgimisë së këtij vendi.

Në këtë ekspozitë, përmes seksioneve të veçanta dhe përmbajtjes unike, vizitorët mësuuan më shumë për Ara-

binë Saudite, historinë e Mekës, dorëshkrimet e çmuara të Bibliotekës së Mekës, botimet e Kuranit, Garat Ndërkombëtare të leximit të Kuranit, artin e kaligrafisë arabe, si dhe të përjetuan nga afër ndjesinë e të qenit pranë Qabesë së bekuar përmes teknologjisë së realitetit virtual.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, në hapje të kësaj ekspozite, tha se bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Arabisë Saudite është i një domethënie të veçantë, kjo edhe për faktin e promovimit vlerave sublime të Isla-

mit. Ndërkaq, kryeministri në detyrë i Kosovës, z. Albin Kurti, tha se përmes kësaj ekspozite po ndërtohen ura bashkëpunimi mes dy vendeve. Në hapje të kësaj ekspozite i pranimë që edhe kryetari i Prishtinës, z. Përparim Rama, i cili tha se ekspozitat e tilla, më shumë se artistike, janë ftesa për reflektim mbi vlerat që na bashkojnë. Zëvendësambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, Ahmed el Harabi, tha se ekspozita ndërkombëtare “Urat” ka për qëllim që të zgjerojë rrugët komunikuese me të gjithë botën.

U MBAJT TAKIM ME UDHËHEQËSIT E HAXHIT



Më 6 maj 2025, në ambientet e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, u mbajt një takim i rëndësishëm ndërmjet udhëheqësve të Haxhit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe udhëheqësve të haxhilerëve nga Këshillat lokale të BIK-ut. Në këtë takim mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili përshëndeti të pranishmit dhe shprehu falënderim për punën dhe angazhimin e derita-

nishëm të të gjithë të përfshirëve në organizimin e haxhit.

Myftiu Tërnavë porositi udhëheqësit që të rrisin edhe më tej përkushtimin e tyre në shërbim të haxhilerëve dhe të jenë të gatshëm që t'u përgjigjen me përgjegjësi të gjitha kërkesave dhe nevojave që ata mund të kenë gjatë këtij rrugëtimi të rëndësishëm shpirtëror. Ai theksoi rëndësinë e koordinimit të mirë ndërmjet Kryesisë dhe Këshillave lokale për të

siguruar një organizim sa më të suksesshëm dhe një përvojë të dinjitetshme për haxhilerët tanë në vendet e shenjta.

Gjatë takimit u diskutuan edhe çështje të rëndësishme që lidhen me përgatitjet logjistike, udhëzimet fetare dhe kujdesin ndaj haxhilerëve, duke theksuar rolin qendror të udhëheqësve lokalë në këtë proces.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E UNIONIT TË QENDRAVE ISLAME SHQIPTARE NË GJERMANI, MENSUR EF. HALILI

Më 7 maj 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Unionit të Qendrave Islame Shqiptare në Gjermani, Mensur ef. Halili.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Unionit të Qendrave Islame Shqiptare në Gjermani, me theks të veçantë në forcimin e lidhjeve institucionale dhe intensifikimin e aktiviteteve të përbashkëta në shërbim të komunitetit shqiptar në diasporë.

Myftiu Tërnavë vlerësoi punën dhe angazhimin e Unionit në ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar të



shqiptarëve në Gjermani, duke shprehur gatishtësinë e BIK-ut për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit. Në fund të takimit, kryetari Halili i dhuroi Myftiut numrin e parë të revistës së sapo botuar të Qendrës,

me titull “Perspektiva”, duke e cilësuar atë si një platformë të rëndësishme për komunikim dhe informim të komunitetit.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 15 maj 2025, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e rregullt të saj, nën kryesimin e kryetarit të saj, Myftiut Naim ef. Tërnavë.

Në këtë mbledhje u diskutua raporti i aktiviteteve të realizuara gjatë muajit Ramazan 2025 në Kosovë dhe në mërgatë, si dhe u diskutua për para-përgatitjet e Haxhit 2025.



BESIMTARËT NGA KOSOVA NISEN PËR HAXH

Më 24 maj 2025, nga Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë, është nisur grupi i parë i besimtarëve nga Kosova drejt vendeve të shenjta për ta kryer haxhin. Në këtë grup u nisën 297 besimtarë, ndërkohë që të dielën në mëngjes është nisur edhe grupi i dytë në përbërje të 292 besimtarëve. Grupi i tretë dhe i katërt janë nisur të hënën, respektivisht të martën dhe në këto dy grupe kanë qenë gjithsej 976 besimtarë, për ta kompletuar kështu numrin prej 1576 besimtarëve që këtë vit morën rrugën për ta kryer haxhin.

Të gjithë besimtarët që kanë marrë rrugën drejt Mekës dhe Medinës për



ta kryer haxhin kanë arritur shëndosh dhe mirë në Meke, dhe menjëherë kanë filluar me ritet e kryerjes së umres. Haxhiu më i ri për këtë vit

është një 15-vjeçar nga Prishtina, kurse më e vjetra është një 84-vjeçare po ashtu nga Prishtina.

U MBAJTI TRYEZA SHKENCORE KUSHTUAR JETËS DHE VEPRËS SË ALI EF. JAKUPIT

Më 27 maj 2025, në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, u mbajt Tryeza Shkencore kushtuar personalitetit të shquar shqiptar, Ali ef. Jakupi. Tryeza u organizua nga Drejtoria për Kulturë dhe Veprimtari Botuese pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, dhe për qëllim kishte ndriçimin e jetës dhe veprës së Ali ef. Jakupit, i cili la gjurmë të pashlyera në historinë fetare dhe kulturore shqiptare.

Drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra, theksoi se kjo Tryezë vjen si një përpjekje për



të vlerësuar kontributin e dijetarëve që shërbyen me përkushtim në kohë të vështira.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, e vlerësoi Ali ef. Jakupin si një dijetar të

madh të shekullit të kaluar, i çmuar dhe i vlerësuar nga e gjithë bota, por i harruar nga vendi i tij.

Roli dhe kontributi i Ali ef. Jakupit u vlerësua lart edhe nga ish-kryediplomati i Kosovës, z. Enver Hoxhaj, i cili gjatë fjalës së tij dha shembuj interesant kur diplomacia e huaj mburrej me veprën e Ali ef. Jakupit.

Atashehu për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë në Kosovë, z. Bunjamin Albajrak, kujtoi punën e

jashtëzakonshme të Ali Jakupit si profesor i gjuhës arabe, ku shumë imamë, profesorë të sotëm në Turqi, madje edhe vetë kryetari i Dijanetit të Turqisë ishin nxënës të Ali ef. Jakupit.

Sabri Bajgora, Hysen Matoshi, Sadik Mehmeti, Ferid Piku, Elez Osmani, Besir Neziri, Valon Shkodra, janë studiuesit e tjerë të cilët përmes kumtesave të tyre prezantuan jetën, veprën dhe kontributin e Ali ef. Jakupit.

Ali ef. Jakupi nga Desivojca e Kamenicës, u shkollua në Medresetë e Gjilanit dhe Shkupit për të vijuar më pas studimet e larta në Universitetin e “Al Az’harit” në Kajro. Një pjesë të jetës së tij e kaloi në Egjipt, ndërsa pjesën tjetër në Turqi. E gjitha jeta e tij ishte një shembull i mirë i një besimtari, dijetari, alimi dhe profesori të përkushtuar ndaj dijes.

DREJTORI SIMNICA VIZITOI QENDRËN ISLAME “DITURIA” NË ANTWERPEN TË BELGJIKËS

Më 2 maj 2025, gjatë vizitës në Belgjikë, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, vizitoi Qendrën Islame “Dituria” në Antwerpen, ku u prit nga kryetari Hyzri Vllasaliu dhe anëtarët e Kryesisë së xhamisë.

Drejtori Simnica përcolli urimet e Myftiut Tërnava dhe prezantoi aktivitetet e BIK-ut, me theks te medresetë, Fakulteti i Studimeve Islame dhe institucionet e hifzit. Kryetari Vllasaliu e falënderoi për vizitën dhe e informoi për angazhimet e qendrës, blerjen e objektit të ri të xhamisë dhe procesin e renovimit.

Gjatë vizitës në objektin e ri, drejtori Simnica uroi Kryesinë dhe xhematin



për punën dhe theksoi gatishmërinë e BIK-ut për bashkëpunim të vazhdueshëm me qendrat e diasporës.

Në fund, ai i dorëzoi një mirënjohje kryetarit Vllasaliu për kontributin e dhënë në ndërtimin e kësaj xhamie.

DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMIN ABEDIN IBRAHIMI

Më 12 maj 2025, drejtori i Drejtorisë për Diasporë në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti në takim imamin Abedin Ibrahim, i cili shërben në xhaminë “Abdush Qizmolli e V” në Zulpich të Gjermanisë.

Drejtori e njohu imamin me vlerësimin për bashkëpunimin e tij të rregullt me qendrat islame shqiptare në diasporë, duke shprehur gatishmërinë e BIK-ut që ky bashkëpunim të vazhdojë. Nga ana e tij, imami Ibrahim shprehu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme dhe për mundësinë e pjesëmarrjes në Garat



Ndërkombëtare të Kuranit të mbajtura së fundmi në Prishtinë. Të dyja palët konfirmuan vullnetin për thelli-

min e bashkëpunimit në të mirë të komunitetit shqiptar mysliman në Gjermani.

**MOMENTE
NGA VIZITA
E IMAMIT
TË QABESË,
SHEJH
BANDAR
BALEELA**





Shtëpia Botuese "Dituria Islame" sjell titullin më të ri:

"Shkrimtarët shqiptarë në gjuhët orientale – Roli dhe vendi i tyre në letërsinë islame të Divanit". Ky libër ndriçon një segment të rëndësishëm të trashëgimisë sonë letrare – krijimtarinë e autorëve shqiptarë në gjuhët arabe, perse dhe turke gjatë periudhës osmane. I mbështetur në studime të publikuara në "Edukata Islame", libri prezanton figura të njohura si Mesihi Prishtina, Suzi Prizreni, Jahja Bej Dukagjini, Lutfi Pasha e të tjerë.

DITURIA ISLAME • Nr. 415 QERSHOR 2025